

Modul trajnimi

Për avokatët mbi “Drejtësinë miqësore për të miturit dhe veçanërisht rolin e avokatit në përdorimin e programeve të drejtësisë restauruese dhe masave të shmangies nga procesi penal për fëmijët në konflikt me ligjin”



Modul trajnimi

Për avokatët mbi “Drejtësinë miqësore për të miturit dhe veçanërisht rolin e avokatit në përdorimin e programeve të drejtësisë restauruese dhe masave të shmangies nga procesi penal për fëmijët në konflikt me ligjin”

Autorë

**Av. Rezarta Abdiu, LLM
Naureda Bajraktari**



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Ky udhëzues u prodhua në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë



Kërkesa për drejtësi në sistemin e drejtësisë penale për të mitur është më e fortë se në çdo fushë tjetër. Dënimet joadekuate apo të papërshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin ose në kontakt me sistemin e drejtësisë, dëmtojnë ndonjëherë përgjithmonë të ardhmen e tyre. Sistemi i drejtësisë penale për të mitur duhet t'i përgjigjet nivelit të kërkesave që burojnë nga të drejtat themelore, t'i përshtatet nevojave të fëmijëve dhe të jetë në proporcion të drejtë si me rrethanat ashtu edhe me shkeljen penale përkatëse. Pavarësisht kësaj, nevojitet të shkojmë përtej të drejtave, të cilat janë të domosdoshme, por përsëri mbeten një kusht i pamjaftueshëm për ngritjen e një sistemi drejtësie miqësore për të miturit në konflikt me ligjin. Në vend të ndëshkimit dhe të qëllimit shpagues të tij, për këta fëmijë, është e domosdoshme të përdoren alternativa të tjera në zgjidhjen e konflikteve, me qëllim parandalimin e hyrjes së tyre në rrethin vicioz të procedimeve penale. Avokatët duhet të jenë të parët në advokimin e këtij qëllimi, duke kundërshtuar izolimin dhe dënimin me heqje lirie të të miturve, duke përdorur masa të tjera ekzistuese, duke u fokusuar në riintegrimin e fëmijëve me qëllim pjesëmarrjen e tyre në jetën sociale, duke marrë masa social-ekonomike për familjet e tyre, duke favorizuar arsimin për të gjithë, formimin profesional, etj.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Mbi reformën në sistemin e drejtësisë”¹ në Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë,² parashikoi në objektivin 8, reformimin e sistemit të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin duke theksuar forcimin e sistemit të drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të të drejtave procedurale të fëmijëve.³ Pavarësisht problematikave të mëdha që kanë ekzistuar, dhe me shumë gjasa do të vazhdojnë të ekzistojnë për një kohë të caktuar në sistemin e drejtësisë penale për të mitur, duhen vlerësuar hapat pozitivë në përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare të garantuara në aktet ndërkombëtare, si p.sh. miratimi i Ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM), si dhe Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe Planit të saj të Veprimit 2018 – 2021. Zbatimi i këtyre ligjeve nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore përkatëse do të bëjnë të mundur që këto të drejta të jenë “*praktike dhe efektive*” dhe jo thjesht “*teorike dhe iluzive*”, ashtu siç rekomandohet në vazhdimësi nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në jurisprudencën e saj. Aktorët e përfshirë në drejtësinë penale për të mitur, si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, psikologë dhe punonjës socialë, ndërmjetës, përfaqësues proceduralë, etj, kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e legjislacionit të drejtësisë penale për të mitur. Këta duhet të jenë të trajnuar dhe specializuar mbi këtë legjislacion, dhe për ta duhet përcaktuar si një kriter i detyrueshëm, trajnimi dhe specializimi i tyre për Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Bazuar në KDPM, por edhe në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe Ligjin nr. 55/2017 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë (DHASH) është përgjegjëse për trajnimin dhe specializimin e avokatëve të cilët do të përfaqësojnë

¹ Në kuadër të analizës për reformën në drejtësi, Kuvendi i Shqipërisë ngriti, me vendimin nr. 96/2014, Komisionin e Posaçëm “Mbi reformën në sistemin e drejtësisë”.

² <http://reformatdrejtesi.al/dokumenti-strategjik-dhe-plani-i-veprimit>.

³ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë. Objektivi VIII. fq. 28.

të miturit në konflikt me ligjin, viktima apo dëshmitarë, duke pasur si prioritet parësor – trajnimin e vazhdueshëm dhe specializimin e avokatëve që janë pjesë e listës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Për këtë qëllim, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet DHASH dhe organizatës Terre des Hommes, është përgatitur edhe ky modul trajnimi për avokatët mbi drejtësinë miqësore për të mitur, dhe veçanërisht rolin e avokatit në përdorimin e programeve të drejtësisë restauruese dhe masave të shmangies nga procesi penal për fëmijët në konflikt me ligjin apo viktima/dëshmitarë.

1.1 Çfarë qëllimi ka dhe kujt i drejtohet moduli i trajnimit?

1.1.1 Objektivi i përgjithshëm

Moduli i trajnimit synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe aftësitë teknike e profesionale të avokatëve, në përgjithësi, dhe veçanërisht avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti për të miturit sipas legjislacionit përkatës, të cilët duhet të jenë të specializuar mbi standardet e drejtësisë miqësore për të miturit, sipas standardeve ndërkombëtare dhe atyre të përcaktuara nga KDPM, mbi aplikimin e masave të drejtësisë restauruese, shmangies nga procesi penal dhe ndërmjetësimin, gjithmonë kur i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës, duke respektuar në të njëjtën kohë parimin e aksesit në drejtësi dhe garancitë procedurale të drejtësisë miqësore për fëmijë. Ky udhëzues i shërben edhe asistent – avokatëve të Shkollës së Avokatisë, si pjesë e kurrikulës trajnuese të kësaj Shkolle, dhe mund të përdoret edhe nga profesionistë të tjerë të përfshirë në sistemin e drejtësisë për të mitur, duke udhëzuar se si të zbatohet një rol i tillë në praktikë dhe se si të kombinohet ekspertiza ligjore me aftësi të tjera siç janë: aftësitë komunikuese, gjuha miqësore me fëmijët, qëndrimi ndaj fëmijëve, si dhe marrëdhënia me profesionistë të tjerë në sistemin e drejtësisë për të mitur. Një tjetër aspekt mjaft i rëndësishëm i modulit do të jetë qasja e tij psikologjike, duke përfshirë karakteristikat e miturve në pozita të ndryshme në sistemin e drejtësisë: kur ata hyjnë në konflikt me ligjin si dhe kur janë viktimë apo dëshmitarë, elemente të rëndësishme për tu mbajtur në konsideratë në marrëdhënien avokat-klient i mitur, si dhe roli i psikologut dhe shërbimeve sociale në drejtësinë penale për të mitur.

1.1.2 Objektiva konkrete

Pas përfundimit të këtij Moduli, avokatët do të jenë në gjendje të:

- njohin dhe përvetësojnë parimet dhe konceptet kryesore të drejtësisë miqësore për të mitur sipas standardeve ndërkombëtare (në nivelin e OKB, KE dhe BE); njohin dhe përdorin me efikasitet parimet kryesore të Konventës së OKB mbi të drejtat e fëmijës, veçanërisht të kenë aftësitë praktike në përdorimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës si filtri kryesor për çdo procedurë dhe çdo profesionist; njohin rëndësinë e drejtësisë miqësore para, gjatë dhe pas procedurave gjyqësore;
- njohin rëndësinë e rolit të avokatit në përmbushjen e parimeve dhe garancive procedurale për të miturit të përcaktuara në KDPM;
- njohin dhe ndërgjegjësohen mbi rëndësinë e procedurave alternative apo jo-gjyqësore si dhe proceseve të drejtësisë restauruese, shmangies nga procedimi penal, ndërmjetësimin dhe alternativa të tjera, duke respektuar kushtet dhe procedurat në përputhje me interesin më të lartë të të miturit të përcaktuar në KDPM;
- njohin dhe vlerësojnë rolin e aktorëve të tjerë të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë për të mitur

si atë të psikologut, ndërmjetësit, punonjësit të zyrës për mbrojtjen e të miturve, etj, dhe rëndësinë e ndërveprimit me ta;

- njohin dhe ndërgjegjësohen mbi rëndësinë e ndërveprimit me fëmijët në konflikt me ligjin si sfida kryesore; si ndikon në këtë ndërveprim moshë dhe të kuptuarit; gjinia; statusi, cenueshmëria; pjesëmarrja; rëndësia e komunikimit dhe krijimit të marrëdhënies me të miturin dhe rëndësia e vlerësimit individual në aplikimin e procedurave jo-gjyqësore.

1.1.3 Temat e modulit të trajnimit

Moduli i trajnimit është hartuar dhe organizohet bazuar në tre drejtime kryesore:

Tema I: Parimet dhe konceptet kryesore të drejtësisë miqësore për të mitur sipas standardeve ndërkombëtare (në nivelin e OKB, KE dhe BE). Njohja dhe përdorimi me efikasitet i parimeve kryesore, veçanërisht aftësimi praktik në përdorimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës si filtri kryesor për çdo procedurë dhe çdo profesionist;

Tema II: Roli i avokatit sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur me fokus të veçantë në njohjen dhe ndërgjegjësimin mbi procedurat jo-gjyqësore. Përkufizimet dhe avantazhet në aplikimin e procedurave të drejtësisë restauruese, masave të shmangies nga procedimi penal dhe ndërmjetësimin në përputhje me garancitë procedurale dhe kushtet e përcaktuara në KDPM;

Tema III: Roli i psikologut sipas KDPM dhe ndërveprimi me fëmijët në sistemin gjyqësor si sfidë kryesore. Karakteristikat e miturve në pozita të ndryshme në sistemin e drejtësisë: kur ata hyjnë në konflikt me ligjin si dhe kur janë viktima apo dëshmitarë. Këndvështrimi psikologjik mbi drejtësinë restauruese në çështjet ku përfshihen fëmijët. Marrëdhënia avokat-i mitur.

1.1.4 Metodologjia e trajnimit

Moduli i trajnimit do t'i shërbejë të gjithë avokatëve aktivë, sidomos atyre që do të jenë pjesë e listës së avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti për fëmijët në konflikt me ligjin. Siç u theksua edhe më sipër, këta avokatë duhet të jenë të specializuar mbi drejtësinë penale për të mitur dhe KDPM. Gjithashtu, trajnim specifik mbi KDPM, janë të detyruar të ndjekin edhe kandidatët për avokatë që janë pjesë e Shkollës së Avokatisë të DHASH, si një kusht për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 55/2017 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë" me qëllim fitimin e titullit "Avokat". Trajnimi do të bazohet në temat e përcaktuara sipas këtij moduli trajnimi i cili ndërthur njohuritë ligjore me ato psiko-sociale me qëllim aftësimin e avokatëve në komunikimin dhe qasjen me klientin e mitur. Temat e trajnimit së bashku me ushtrimet për secilën prej temave do të zhvillohen gjatë trajnimit dyditor për avokatët, dhe brenda disa orëve mësimore për asistent avokatët, në varësi të rishikimit dhe miratimit të kurrikulës së

trajnimin të Shkollës së Avokatisë. Avokatët do të pajisen me certifikatë trajnimi, e cila do të jetë në funksion të procesit të certifikimit të tyre, si kërkesë e KDPM dhe legjislacionit përkatës.

1.1.5 Metodatat e trajnimit

- Diskutim interaktiv ndërmjet trajnuesve dhe pjesëmarrësve;
- Ndarja në grupe të vogla pune dhe prezantimi/diskutimi i gjetjeve bashkërisht në çdo temë trajnimi;
- Diskutim për nxjerrje idesh për çdo temë trajnimi;
- Prezantimi me raste praktike përgjatë të gjitha temave të trajnimit;
- Prezantime power point si dhe përgatitja e kazuseve për pjesëmarrësit;
- Lojë me role, kryesisht lidhur me praktikën e komunikimit dhe ndërveprimit avokat – klient i mitur;
- Vënia në dispozicion të pjesëmarrësve e listës së leximit më të thelluar përsa i përket temave të trajnimit;
- Si trajnues do të shërbejnë jo vetëm ekspertë ligjorë me eksperiencë të gjatë në fushën e drejtësisë për të mitur, por edhe psikologë klinikistë.

1.1.6 Programi/Skeleti i trajnimit (2 ditë të plota)

Dita 1	
30 minuta	<p>Njohja e pjesëmarrësve me njëri-tjetrin dhe diskutimi i pritshmërive Ushtrim për thyerjen e akullit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i trajnerëve dhe objektivave të trajnimit, temave, metodologjisë, etj; • I kërkohet pjesëmarrësve të tregojnë shkurtimisht eksperiencën e tyre në përfaqësimin e fëmijëve në kontakt me sistemin e drejtësisë dhe pritshmëritë nga ky trajnim; • Pjesëmarrësit informohen lidhur me rregullat që zbatohen gjatë trajnimit dyditor si dhe procedurat e vlerësimit/certifikimit të tyre.
60 minuta	<p>Sesioni 1 Tema I:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Parimet dhe konceptet kryesore të drejtësisë miqësore për të mitur sipas standardeve ndërkombëtare (në nivelin e OKB, KE dhe BE). • Njohja dhe përdorimi me efikasitet i parimeve kryesore, veçanërisht aftësimi praktik në përdorimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës si filtri kryesor për çdo procedurë dhe çdo profesionist.

	<p>Bëhet ndarja e pjesëmarrësve në 3 – 4 grupe, në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku çdo grupi i jepen pyetje (të ndryshme) mbi kuptimin dhe rëndësinë që ka drejtësia miqësore për fëmijët dhe përse është e rëndësishme të zbatohen parimet e saj, me fokus të veçantë zbërthimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.</p> <p>Trajneri pas raportimit të grupeve shpjegon çështjet e përcaktuara në temën I.</p>
15-20 minuta	Pushim
60 minuta	<p>Sesioni 1 Tema I:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Parimet dhe konceptet kryesore të drejtësisë miqësore për të mitur sipas standardeve ndërkombëtare (në nivelin e OKB, KE dhe BE). • Njohja dhe përdorimi me efikasitet i parimeve kryesore, veçanërisht aftësimi praktik në përdorimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës si filtri kryesor për çdo procedurë dhe çdo profesionist. <p>Bëhet ndarja e pjesëmarrësve në 3 – 4 grupe, në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku çdo grupi i jepen pyetje (të ndryshme) mbi kuptimin dhe rëndësinë që ka drejtësia miqësore për fëmijët dhe përse është e rëndësishme të zbatohen parimet e saj, me fokus të veçantë zbërthimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.</p> <p>Trajneri pas raportimit të grupeve shpjegon çështjet e përcaktuara në temën I.</p>
15-20 minuta	Pushim
60 minuta	<p>Tema II:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Roli i avokatit sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur me fokus të veçantë në njohjen dhe ndërgjegjësimin mbi procedurat jo-gjyqësore. • Përkufizimet dhe avantazhet në aplikimin e procedurave të drejtësisë restauruese, masave të shmangies nga procesi gjyqësor dhe ndërmjetësimit në përputhje me garancitë procedurale dhe kushtet e përcaktuara në KDPM. <p>Bëhet ndarja e pjesëmarrësve në 3 – 4 grupe, në varësi të numrit të</p>

	<p>pjesëmarrësve, ku çdo grupi i jepen pyetje (të ndryshme) mbi kuptimin dhe rëndësinë që ka secila nga çështjet e mësipërme.</p> <p>Trajneri pas raportimit të grupeve shpjegon çështjet e përcaktuara në temën II.</p>
15-20 minuta	Pushim
60 minuta	<p>Tema II: Vazhdim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Roli i avokatit sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur me fokus të veçantë në njohjen dhe ndërjegjësimin mbi procedurat jo-gjyqësore. • Përkufizimet dhe avantazhet në aplikimin e procedurave të drejtësisë restauruese, masave të shmangies nga procesi dhe ndërmjetësimin në përputhje me garancitë procedurale dhe kushtet e përcaktuara në KDPM. <p>Bëhet ndarja e pjesëmarrësve në 3 – 4 grupe, në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku çdo grupi i jepen pyetje (të ndryshme) mbi kuptimin dhe rëndësinë që ka secila nga çështjet e mësipërme.</p> <p>Trajneri pas raportimit të grupeve shpjegon çështjet e përcaktuara në temën II.</p>
Dita 2	
60 minuta	<p>Shembuj nga praktika ndërkombëtare dhe kombëtare</p> <p>Bëhet ndarja e pjesëmarrësve në 3 – 4 grupe, në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku çdo grupi i jepen kazuse në lidhje me përshtatshmërinë e aplikimit të masës së shmangies dhe ndërmjetësimin (kazuse të njëjta për të gjitha grupet) dhe pas përfundimit secili grup prezanton listën e kushteve që duhet të marrë në analizë prokurori ose gjyqtari, evidentimin e arsyeve pse një masë është e përshtatshme, e nevojshme dhe e mundshme për t'u përmbushur nga i mituri, kushtet dhe mënyrën e arritjes së marrëveshjes, hapat që ndiqen me ndërmjetësimin.</p> <p>Trajneri/trajnuesit pas raportimit të grupeve, paraqesin konkluzionet mbi kazuset e paraqitura.</p> <p>Kazuset do të përgatiten paraprakisht nga trajnuesit dhe do të bazohen tek përshtatshmëria e masës së shmangies dhe procedura</p>

	e ndërmjetësimit për veprat penale të vjedhjes, shpërndarjes dhe përdorimit të lëndëve narkotike, etj.
15-20 minuta	Pushim
60 minuta	<p>Sesioni 1 Tema III:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Roli i psikologut sipas KDPM, roli i shërbimeve sociale dhe ndërveprimi me fëmijët në sistemin gjyqësor si sfidë kryesore. Karakteristikat e të miturve në pozita të ndryshme në sistemin e drejtësisë: kur ata hyjnë në konflikt me ligjin, si dhe kur janë viktima apo dëshmitarë. • Këndvështrimi psikologjik mbi drejtësinë restauruese në çështjet ku përfshihen fëmijët. Marrëdhënia avokat – i mitur.
60 minuta	<p>Sesioni 2 Tema III: Vazhdim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Roli i psikologut sipas KDPM dhe ndërveprimi me fëmijët në sistemin gjyqësor si sfidë kryesore. Karakteristikat e të miturve në pozita të ndryshme në sistemin e drejtësisë: kur ata hyjnë në konflikt me ligjin, si dhe kur janë viktima apo dëshmitarë. • Këndvështrimi psikologjik mbi drejtësinë restauruese në çështjet ku përfshihen fëmijët. Marrëdhënia avokat – i mitur.
60 minuta	<p>Përmbledhje e tematikës së trajtuar dhe testim i njohurive të marra</p> <p>Bëhet ndarja e pjesëmarrësve në 3 – 4 grupe, në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku çdo grupi i jepen kazuse me fëmijë në kontakt me sistemin e drejtësisë në cilësinë e të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale, viktimë ose dëshmitar dhe vazhdohet me luajtjen e roleve.</p> <p>Eksperti psikolog vlerëson seancat me luajtjen e roleve të pjesëmarrësve dhe paraqet specifikat e çdo rasti, gabimet, etj;</p> <p>Bëhet ndarja e pjesëmarrësve në 3 – 4 grupe, në varësi të numrit të pjesëmarrësve, ku çdo grupi i jepen pyetje (të ndryshme) mbi rolin e avokatit në faza të ndryshme të procesit, prej momentit të parë deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit nga i mituri, me fokus të veçantë në procedurat e shmangies, ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese.</p>

	<p>Eksperti ligjor vlerëson përgjigjet dhe orienton pjesëmarrësit lidhur me ushtrimet konkrete.</p> <p>Shpërndarja e një testi të shkurtër për plotësim nga ana e pjesëmarrësve</p>
30 minuta	Trajnuesit paraqesin konkluzionet e trajnimit dhe testimit
5-10 minuta	Vlerësimi i trajnimit nga pjesëmarrësit nëpërmjet plotësimit të formularëve të shpërndarë të cilët janë anonime.

1.1.7 Fjalor/terminologji mbi konceptet kyçe

“I mitur” është çdo person nën moshën 18 vjeç.

“I mitur në konflikt me ligjin” është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një veprë penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënues me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale.

“I mitur viktimë” është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një veprë penale.

“I mitur dëshmitar” është çdo person nën 18 vjeç, i cili mund të ketë informacion lidhur me veprën penale.

“I ri” është çdo person nga mosha 18 deri në 21 vjeç që akuzohet për kryerjen e një veprë penale, kur ka qenë i mitur.

“I afërm” është personi që ka lidhje të afërt familjare, gjinie ose krushqie me të miturin.

“Moshë minimale e përgjegjësisë penale” është mosha 14 vjeç në rastet e kryerjes së një krimi dhe mosha 16 vjeç në rastin e kryerjes së një kundërvajtjeje penale të parashikuar nga Kodi Penal.

“Alternativë e dënimit me burgim” është masa që mund të vendoset ndaj të miturit nga organi kompetent i sistemit të drejtësisë penale në të gjitha fazat e tij, të cilat nuk konsistojnë në kufizimin/heqjen e lirisë.

“Drejtësi penale për të mitur” janë procedura që lidhen me veprat penale, duke përfshirë hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e dënimit, çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar të një veprë penale.

“Masë e drejtësisë restauruese” është çdo masë, e cila lejon një të mitur në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigjojë pasojat e një vepre penale, të kompensojë dëmet dhe/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale, ku i mituri që ka kryer veprën penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për të zgjidhur pasojat e një vepre penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tretë të pavarur.

“Ndërmjetësim” është procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.

“Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” është struktura për mbrojtjen e të miturit në nivel vendor, sipas ligjit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

“Organ kompetent/pjesëmarrës në administrimin e drejtësisë penale për të mitur” është, sipas rastit, gjyqtari, prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore, punonjësi i policisë së shtetit, avokati, psikologu, punonjësi social, ndërmjetësi, punonjësi i Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe të shërbimit të provës, punonjësi i institucionit të rehabilitimit të të miturve dhe paraburgimit e burgjeve, si dhe çdo strukture/zyrtar tjetër që përfshihet në këtë proces, të cilët ushtrojnë përgjegjësitë dhe kompetencat e parashikuara në këtë Kod dhe që janë të trajnuar dhe specializuar në çështjet penale me të mitur dhe të rinj.

“Përfaqësues ligjor” është prindi, i afërmi ose kujdestari i të miturit, i cili merr pjesë në procedurën e drejtësisë penale për të mitur për të mbrojtur interesat e të miturit.

“Përfaqësues procedural” është personi në kuptimin e përcaktuar në ligjin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës që do të kryejë përfaqësimin procedural të të miturit, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

“Person i besuar” është personi madhor i kërkuar nga i mituri dhe i pranuar nga organi kompetent, i cili shoqëron të miturin në fazat e procedimit penal.

“Qendër/institucion për rehabilitimin e të miturit” është një strukturë ose program ku vendoset i mituri i dënuar ose jo, e cila është e pajisur me infrastrukturën dhe personelin e duhur për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturit dhe të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

“Riviktimizim” është shkaktimi i dëmit të miturit viktimë e veprës penale, si pasojë e një vepre penale të re që ka lidhje me të parën.

“Rishoqërimi/rehabilitimi” është inkurajimi dhe zhvillimi, në kuptim të përgjegjësisë së të miturit, e ndjenjës

së respektimit të të drejtave të të tjerëve, për të nxitur dhe mundësuar zhvillimin e shëndoshë fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të të miturit dhe për ta përgatitur atë që të rikthehet në shoqëri.

“Shmangie” është masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

“Psikologu asistues” është psikologu që thirret nga prokurori ose gjykata për të mbështetur emocionalisht të miturin në konflikt me ligjin, si dhe për të lehtësuar komunikimin me të miturin përgjatë procedimit penal (në fazën e hetimeve paraprake ose të gjykimit). Pjesëmarrja e tij në procedim është e domosdoshme.

“Psikologu vlerësues” është psikologu që caktohet në procedimin penal ndaj një të mituri në konflikt me ligjin për të kryer vlerësimin e të miturit, që i shërben prokurorit ose gjyqtarit për marrjen e vendimit.

“Përvojat negative të fëmijërisë”, është një term që përdoret për të përshkruar të gjitha llojet e abuzimeve, neglizhencës dhe përvojave të tjera potencialisht traumatike që ndodhin tek njerëzit nën moshën 18 vjeç.

“Avokat për të miturit” është një avokat i specializuar në mbrojtjen e fëmijëve në kontakt me sistemin e drejtësisë.

“Traumë” është reagimi ndaj një ngjarje thellësisht shqetësuese, që rrezikon integritetin fizik e psikologjik të individit, ndikon aftësinë për t’u përballur me situatat e ndryshme, shkakton ndjenjën e pafuqisë, dhe ul aftësinë për të përjetuar emocione dhe eksperiencia.

PMF është Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve pranë njësisë së mbrojtjes së fëmijëve ose pranë njësisë administrative.

Tema I: Parimet dhe konceptet kryesore të drejtësisë miqësore për të mitur sipas standardeve ndërkombëtare (në nivelin e OKB, KE dhe BE). Njohja dhe përdorimi me efikasitet i këtyre parimeve, veçanërisht aftësimi praktik në përdorimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës si filtri kryesor për çdo procedurë dhe çdo profesionist

Termi *“Drejtësi miqësore për të mitur”* i referohet sistemeve të drejtësisë të cilat garantojnë respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijëve bazuar në disa parime dhe standarde të përcaktuara fillimisht në Konventën e OKB *“Për të drejtat e fëmijës”* (KDF), të zhvilluara më tej nga Këshilli i Evropës në *“Udhëzuesin për drejtësinë miqësore për të miturit”* e më pas të përthithura në legjislacionin e Bashkimit Evropian. Pavarësisht mundësisë së aplikimit të llojeve të ndryshme të procedurave, të cilat varen nga objektivi i pikësnyuar (p.sh. penal, restaurues, edukativ, i mirërritjes, etj.) çdo shtet bazuar në detyrimin e përcaktuar në nenin 40, pika 3 e KDF, është i detyruar të ndërtojë një sistem të drejtësisë miqësore për të miturit:

“Shtetet Palë përpiqen që të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, autoriteteve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që cilësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal”.

E ndarë në komponentë kjo nënkupton;

- drejtësi të hapur,
- në përputhje me moshën,
- të shpejtë,
- efektive,
- të përshtatur dhe të fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve, ku përfshihet e drejta për proces të rregullt, e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për të kuptuar procedurat, etj.⁴

Përdorim togfjalëshin “drejtësi miqësore për fëmijët” sepse qëllimi është të kuptojmë dhe të arrijmë të ndihmojmë fëmijët në ushtrimin e të drejtave të tyre për të pasur akses në drejtësi. Përdorim termin *“miqësor për fëmijët”* sepse fëmijët kanë nevojë të jenë në gjendje të ndërveprojnë dhe të bashkëpunojnë me profesionistët, në atë mënyrë që i përshtatet kapaciteteve të tyre të të kuptuarit, si dhe kapaciteteve të tyre për të marrë pjesë. Të gjithë profesionistët që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, dhe veçanërisht ata të përfshirë në drejtësinë penale për të miturit, duhet ta vendosin veten në vend të fëmijës dhe të zbatojnë ato protokolle dhe metoda pune që e mundësojnë fëmijën të shprehë vetveten në kushte që i përputhen moshës, cenusshmërisë dhe situatës në të cilën ndodhet fëmija.

Sistemi i drejtësisë për të mitur duhet t'i përgjigjet nivelit të kërkesave që burojnë nga të drejtat themelore, t'i përshtatet nevojave të fëmijës dhe të jetë në proporcion të drejtë si me rrethanat ashtu edhe me shkeljen penale përkatëse. Pavarësisht kësaj, nevojitet të shkojmë përtej të drejtave, të cilat janë të domosdoshme, por përsëri mbeten një kusht i pamjaftueshëm për ngritjen e një sistemi të drejtësisë miqësore për të miturit

në konflikt me ligjin. Në vend të ndëshkimit dhe të qëllimit shpagues të tij, për këta fëmijë, është e domosdoshme të përdoren alternativa të tjera në zgjidhjen e konflikteve, me qëllim parandalimin e hyrjes së tyre në rrethin vicioz të procedimeve penale. Avokatët duhet të jenë të parët në advokimin e këtij qëllimi, duke kundërshtuar izolimin dhe dënimin me heqje lirie të të miturve, duke përdorur masa të tjera ekzistuese, duke u fokusuar në riintegrimin e fëmijëve me qëllim pjesëmarrjen e tyre në jetën sociale, duke marrë masa social-ekonomike për familjet e tyre, duke favorizuar arsimin për të gjithë, formimin profesional, etj.

2.1 Parimet e përgjithshme të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, OKB

1.1.1 Objektivi i përgjithshëm

KDF është akti ndërkombëtar më i ratifikuar në botë, me 196 ratifikime. Ai përfshin një numër të madh të parimeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut – të drejtat civile, kulturore, ekonomike, politike, sociale si dhe aspekte të së drejtës humanitare. Një pjesë e rëndësishme e garancive të parashikuara në KDF kanë të bëjnë me pozitën e fëmijës në sistemin e drejtësisë. Ato parashikojnë krijimin e një sistemi gjyqësor kombëtar, i cili i përgjigjet nevojave të veçanta të fëmijëve si në aspektin e sigurimit të qasjes së duhur dhe efikase, ashtu edhe në trajtimin e tyre, në çdo sferë të sistemit të drejtësisë, në atë civile, administrative dhe penale. Këshilli i Evropës ka hartuar standarde dhe udhëzime të ndryshme në fushën e drejtësisë miqësore për fëmijët.

Paketa më gjithëpërfshirëse e standardeve për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve është ajo e *Udhëzimeve të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve*. Këto standarde janë hartuar për të plotësuar boshllëqet mes paketës së standardeve në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe zbatimit të tyre në ligj dhe në praktikë, si dhe në përgjigje të kërkesave për udhëzime të qeverive dhe profesionistëve të cilët punojnë me fëmijët, për të siguruar zbatimin efikas të të drejtave të tyre. Udhëzimet janë hartuar duke u bazuar në standardet ndërkombëtare, evropiane dhe ato të vendeve të veçanta. Parimi orientues i tyre janë interesat më të larta të fëmijëve, pasi ato marrin parasysh parimet themelore të përcaktuara në KEDNJ dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ dhe KDF.

Sipas Komitetit të KDF *“Në administrimin e drejtësisë për të mitur, Shtetet anëtare duhet të aplikojnë në mënyrë sistematike parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenet 2, 3, 6 dhe 12 të KDF, si edhe parimet themelore në nenet 37 dhe 40”*.⁵ Nenet e mësipërme do të shërbejnë si kërkesa të përgjithshme për të gjitha të drejtat e fëmijëve, përfshirë dhe ato që kanë lidhje me drejtësinë penale për të mitur:

- Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 2 i KDF);
- Parimi i interesit më të lartë të fëmijës (neni 3 i KDF);
- E drejta e jetës dhe e mbijetesës (neni 6 i KDF);
- E drejta e fëmijës për t’u dëgjuar (neni 12 i KDF).

⁵ CRC/C/GC/10, 5-14.

2.1.1 Parimi i interesit më të lartë të fëmijës (neni 3 i KDF)

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës garantohet në nenin 3 të Konventës së OKB për të drejtat e fëmijës.⁶ Parimi i interesit më të lartë të fëmijës është një nga parimet bazë mbi të cilat mbështetet vendimmarrja dhe ushtrimi i veprimtarisë së të rriturve, të cilët me ligj kanë përgjegjësinë për t'u kujdesur për të miturit dhe për të ushtruar të drejta në emër dhe në lidhje me ta. Ky parim aplikohet në mënyrë unike vetëm për fëmijët, dhe nuk ka një parim të ngjashëm për të rriturit, sikurse ndodh në rastin e të drejtave të tjera, të cilat garantohen si për subjektin fëmijë ashtu edhe për atë të rritur.

Interesi më i lartë i fëmijëve duhet të jetë konsiderata mbizotëruese në të gjitha çështjet që prekin fëmijët. Në vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijëve të përfshirë ose të prekur, duhet të merren në konsideratë: a) opinionet dhe mendimet e tyre, të cilave duhet t'i jepet rëndësia e duhur; b) të gjitha të drejtat e tjera të fëmijës, të tilla si e drejta për dinjitet, liri dhe trajtim të barabartë, të cilat duhet të respektohen në çdo kohë; c) një qasje gjithëpërfshirëse duhet të miratohet nga të gjitha autoritetet shtetërore në mënyrë që të marrin parasysh të gjitha interesat në rrezik, duke përfshirë edhe mirëqenien psikologjike dhe fizike dhe interesat juridike, ekonomike dhe sociale të fëmijës. Në rast konkurrimi të interesit më të lartë të dy ose më shumë fëmijëve të përfshirë në të njëjtën procedurë ose rast, ato duhet të vlerësohen veç e veç dhe të balancuara, duke pasur si qëllim pajtimin e interesave të mundshme konfliktuale të fëmijëve.

Në të gjitha vendimet e marra në kontekstin e administrimit të drejtësisë për të mitur, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore. Fëmijët ndryshojnë nga të rriturit për shkak të zhvillimit të tyre psikologjik dhe emocional si dhe për shkak të nevojave emocionale dhe edukative. Kjo diferencë përbën bazën për një shkallë fajësie më të vogël të fëmijëve në konflikt me ligjin. Këto dhe ndryshime të tjera, janë arsyet për një sistem të veçantë drejtësie për të mitur dhe për një trajtim të ndryshëm për fëmijët. Interesi më i lartë i fëmijës do të thotë për shembull se, qëllimi tradicional i dënimit, ndëshkimi i autorit, duhet të zëvendësohet me qëllimet e rehabilitimit dhe dëmshpërblimit në rastet e fëmijëve autorë të veprave penale. Kjo duhet të bëhet duke pasur parasysh edhe sigurinë publike.⁷

Komiteti i të Drejtave të Fëmijës thekson se interesat më të larta të fëmijës janë një koncept i trefishtë:⁸

(a) Një e drejtë themelore: E drejta e fëmijës për të pasur interesin e tij/saj të vlerësuar dhe në qendër të vëmendjes kur merren në konsideratë interesat e ndryshme, kur merret një vendim për një çështje konkrete,

⁶ Teksti i Nenit 3 të KDF: "1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese. 2. Shtetet Palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislativë dhe administrative përkatëse. 3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur."

⁷ Komenti i përgjithshëm nr. 10 i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, pika 10.

⁸ Komente të Përgjithshme Nr. 14 (2013) të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës për të drejtat e fëmijës për të pasur interesat e tij/saj në qendër të vëmendjes mbi Nenin 3, paragrafi 1.

si dhe garancia se kjo e drejtë do të zbatohet sa herë që merret një vendim që ka të bëjë me fëmijën, një grupi të identifikuar fëmijësh apo fëmijët në përgjithësi. Neni 3, pika 1, krijon një detyrim të brendshëm për Shtetet, është drejtpërsëdrejti i zbatueshëm dhe mund të kërkohej të mbrohet në gjykatë;

(b) Një parim ligjor themelor interpretues: Nëse një dispozitë ligjore është e hapur për një ose më shumë interpretime, atëherë duhet zgjedhur interpretimi i cili i shërben më mirë interesave më të larta të fëmijës. Të drejtat e përcaktuara në Konventë dhe Protokollet Opsionale të saj, përcaktojnë kuadrin për interpretim;

(c) Një rregull procedural: Sa herë që merret një vendim, i cili ndikon një fëmijë të caktuar ose një grup fëmijësh të caktuar ose fëmijët në përgjithësi, procesi i vendimmarrjes duhet të përfshijë një vlerësim të ndikimit të mundshëm (pozitiv ose negativ) që ai mund të ketë tek fëmija apo fëmijët në fjalë. Vlerësimi dhe përcaktimi i interesave më të larta të fëmijës ka nevojë për garanci procedurale. Për më tepër, arsyetimi i një vendimi duhet të tregojë se kjo e drejtë është marrë parasysh në mënyrë të veçantë. Në lidhje me këtë, Shtetet palë duhet të shpjegojnë se si është respektuar kjo e drejtë në vendim, që do të thotë se çfarë është marrë parasysh në interesin më të lartë të fëmijës, tek cilat kritere janë bazuar, dhe se çfarë peshe i është dhënë interesit të fëmijës në krahasim me çështjet e tjera, qofshin këto çështje të përgjithshme të rasteve të politikëbërjes apo raste individuale.

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës, është një parim i zërthyeshëm dhe i përbërë nga disa elemente, të cilët nëse merren parasysh në mënyrën e duhur, e kthejnë vendimmarrjen e gjykatës në një proces i cili respekton dhe është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës dhe si i tillë edhe rezultati i tij, d.m.th. vendimi i saj ndikon në mënyrë pozitive në jetën e fëmijës dhe kontribuon në mirëqenien e tij.

Ndërkohë që autoritetet dhe organizatat publike që marrin vendime që kanë të bëjnë me fëmijët, duhet të veprojnë në përputhje me detyrimet për të vlerësuar dhe përcaktuar interesin më të lartë të fëmijës, nga njerëzit që marrin këto vendime në lidhje me fëmijët çdo ditë, (p.sh. prindërit, kujdestarët, mësuesit, etj.) nuk pritët që të ndjekin në mënyrë strikte këtë procedurë prej dy hapash, megjithëse edhe vendimet që merren në jetën e përditshme duhet të respektojnë dhe pasqyrojnë interesat më të larta të fëmijës.

Prandaj, shtetet duhet të vënë në përdorim procese formale, me siguri procedurale strikte, të hartuara për të vlerësuar dhe përcaktuar interesat më të larta të fëmijës për vendimet që ndikojnë mbi fëmijën, duke përfshirë këtu edhe mekanizmat e vlerësimit të rezultateve. Shtetet duhet të zhvillojnë procese transparente dhe objektive për të gjitha vendimet e marra nga ligjvënësit, gjyqtarët apo autoritetet administrative, veçanërisht në fushat të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti tek fëmija apo fëmijët.

Komiteti i fton shtetet dhe të gjithë personat, të cilat për shkak të pozitës së tyre, vlerësojnë dhe përcaktojnë interesat më të larta të fëmijës, që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë sigurive dhe garancive të mëposhtme:

(a) E drejta e fëmijës për të shprehur pikëpamjet e tij/saj

Komunikimi me fëmijët është një element jetësor i procesit që lehtëson pjesëmarrjen e qenësishme të fëmijëve dhe identifikimin e interesave të tyre më të larta. Një komunikim i tillë duhet të përfshijë informimin e fëmijëve për procesin dhe zgjidhjet dhe shërbimet e mundshme të qëndrueshme, si edhe marrjen e informacionit nga fëmijët dhe pikëpamjet e tyre.

Në rastet kur fëmija dëshiron të shprehë mendimin e tij apo të saj dhe kur kjo e drejtë përmbushet përmes përfaqësuesit, ky i fundit ka detyrimin që të komunikojë me saktësi pikëpamjet e fëmijës. Në rastet kur pikëpamjet e fëmijës janë në kundërshtim me ato të përfaqësuesit të tij apo të saj, atëherë nëse është e nevojshme, duhet të zbatohet një procedurë që lejon fëmijën të paraqitet tek autoriteti për të krijuar një përfaqësim të ndarë për fëmijën (p.sh. kujdestari përgjegjës për fëmijën (ad litem)).

Procedura për vlerësimin dhe përcaktimin e interesave më të larta të fëmijëve si grup është, në një shkallë të caktuar, e ndryshme nga ajo që ka të bëjë me një fëmijë të vetëm. Kur janë në pikëpyetje interesat e një grupi të madh fëmijësh, institucionet qeveritare duhet të gjejnë mënyra për të dëgjuar mendimet e një kampioni përfaqësues të fëmijëve. Kështu do t'i jepet pesha e duhur pikëpamjeve të tyre, kur planifikohen masa apo kur merren vendime legjislative të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kanë të bëjnë me grupin, në mënyrë që të sigurohet përfshirja e të gjitha kategorive të fëmijëve. Ekzistojnë shumë shembuj se si bëhet një gjë e tillë, përfshirë këtu edhe seancat dëgjimore të fëmijëve, parlamentet e fëmijëve, organizatat e drejtuara nga fëmijët, shoqatat e fëmijëve apo organe të tjera përfaqësuese të fëmijëve, diskutimet në shkolla, faqet e internetit të rrjeteve shoqërore, etj.

(b) Vërtetimi i fakteve

Faktet dhe informacionet relevante për një çështje të caktuar duhet të përftohen nga profesionistë të mirë-trajnuar, në mënyrë që të renditen të gjithë elementët e nevojshëm për vlerësimin e interesit më të lartë. Kjo mund të përfshijë mes të tjerash, intervistimin e personave të afërt të fëmijës, njerëzve të tjerë që janë në kontakt të përditshëm me fëmijën dhe dëshmitarët e incidenteve të caktuara.

(c) Perceptimi i kohës

Kalimi i kohës nuk perceptohet në të njëjtën mënyrë nga fëmijët dhe të rriturit. Vonesat në vendimmarrjen e tejzgjatur kanë efekte të këqija tek fëmijët pasi ata evoluojnë. Për këtë arsye, është e këshillueshme që procedurave dhe proceseve në lidhje me fëmijët ose që kanë ndikim tek ta, t'u jepet përparësi dhe të përfundojnë në kohën më të shkurtër të mundshme. Koha e vendimit duhet të përputhet sa më shumë që të jetë e mundur, me perceptimin e fëmijës se si mund të përfitojë ai ose ajo, dhe vendimet duhet të shqyrtohen në intervale të arsyeshme kohore pasi fëmija zhvillohet dhe evoluon kapaciteti i tij apo saj për të shprehur

mendimet. Të gjitha vendimet për përkujdesjen, trajtimin, vendosjen në një institucion dhe masat e tjera që kanë të bëjnë me fëmijën duhet të shqyrtohen në mënyrë periodike, në përputhje me perceptimin e tij apo saj të kohës, kapacitetet evoluese dhe zhvillimin e tij apo saj (Neni 25).

(d) Profesionistët e kualifikuar

Fëmijët janë një grup i shumëllojshëm, ku secili ka karakteristikat dhe nevojat vetjake, të cilat mund të vlerësohen vetëm nga profesionistë që kanë ekspertizën e duhur në çështjet që lidhen me zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve. Kjo është arsyeja se pse procesi i vlerësimit formal duhet të kryhet në një mënyrë miqësore dhe atmosferë të sigurtë nga ana e profesionistëve të cilët janë të trajnuar, ndër të tjera, në psikologjinë e fëmijëve, zhvillimin e fëmijëve dhe fusha të tjera relevante të zhvillimit njerëzor dhe shoqëror, të cilët kanë përvojë pune me fëmijët dhe që do ta shqyrtojnë informacionin e marrë në mënyrë objektive. Një ekip profesionistësh shumëdisiplinor duhet të përfshihet sa më shumë që të jetë e mundur në vlerësimin e interesave më të larta të fëmijës.

Vlerësimi i pasojave të zgjidhjeve alternative duhet të bazohet në njohuri të përgjithshme (që nënkupton në fushën e së drejtës, sociologjisë, arsimit, punës sociale, psikologjisë, shëndetit, etj.) mbi pasojat e mundshme të secilës zgjidhje që jepet për fëmijët, duke pasur parasysh karakteristikat dhe të shkuarën individuale të tij apo saj.

(e) Përfaqësimi ligjor

Fëmijës i nevojitet përfaqësim i duhur ligjor, kur interesat e tij apo saj duhet të vlerësohen dhe përcaktohen formalisht nga gjykata dhe organet përkatëse. Veçanërisht në rastet kur një fëmijë është bërë pjesë e një procedure administrative apo gjyqësore, ku përfshihet përcaktimi i interesit më lartë të tij apo saj, atij apo asaj duhet t'i sigurohet një përfaqësues ligjor, përveç kujdestarit apo përfaqësuesit të pikëpamjeve të tij apo saj, kur në procesin e marrjes së vendimit ekziston konflikti i mundshëm mes palëve.

(f) Arsyetimi ligjor

Për të demonstruar se është respektuar e drejta e fëmijës që interesi i tij ose i saj më i lartë është vlerësuar dhe marrë në konsideratë në mënyrë parësore, çdo vendim që ka të bëjë me fëmijën apo fëmijët duhet të motivohet, përligjet dhe shpjegohet. Motivimi duhet të përcaktojë në mënyrë të veçantë të gjitha rrethanat faktike në lidhje me fëmijën, çfarë elementesh janë gjetur si relevante në vlerësimin e interesit më të lartë, përmbajtjen e elementëve në çdo rast të veçantë dhe se si janë shqyrtuar për t'u përcaktuar interesat më të larta të fëmijës. Nëse vendimi ndryshon nga pikëpamjet e fëmijës, arsyetimi për këtë duhet të shprehet në mënyrë të qartë. Nëse përjashtimisht, zgjidhja e ndërmarrë nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, atëherë duhet të paraqiten arsyet për këtë, në mënyrë që të tregohet se interesat më të larta të fëmijës janë

vlerësuar në mënyrë parësore pavarësisht rezultatit. Nuk mjafton të thuhet në terma të përgjithshëm se konsideratat e tjera dominonin ndaj interesave më të larta të fëmijës; të gjitha konsideratat duhet të përcaktohen në mënyrë specifike në lidhje me rastin në fjalë dhe duhet shpjeguar edhe arsyeja se pse ato kanë peshë më të madhe në rastin konkret. Arsyetimi duhet gjithashtu, të demonstrojë, në një mënyrë të besueshme, arsyen se pse interesat më të larta të fëmijës nuk ishin mjaftueshmërisht të forta për të dominuar ndaj konsideratave të tjera. Duhet të merren parasysh rrethanat në të cilat interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata kryesore.

(g) Mekanizmat e shqyrtimit apo rishikimit të vendimeve

Shtetet duhet të krijojnë mekanizma brenda sistemeve të tyre ligjore për të ankimuar apo rishikuar vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët në rastet kur një vendim nuk duket se është në përputhje me procedurat e duhura për vlerësimin dhe përcaktimin e interesave më të larta të fëmijës apo fëmijëve. Gjithmonë duhet të ekzistojë një mundësi për të kërkuar rishqyrtimin apo ankimin e një vendimi të tillë në nivel kombëtar. Mekanizmat duhet t'i bëhen me dije fëmijës dhe të jenë të aksesueshme nga ana e tij apo saj, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes përfaqësuesit të tij apo saj ligjor, nëse shikohet që siguritë procedurale nuk janë respektuar, nëse faktet janë të gabuara, nëse vlerësimi i interesit më të lartë nuk është kryer apo nëse konsideratave konkurruese i është dhënë rëndësi tejet e madhe. Organi shqyrtues duhet t'i shikojë të gjitha këto aspekte e të sigurohet që këto siguri procedurale janë zbatuar.

• Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët

III. B. Interesat më të larta të fëmijës.

1. Shtetet anëtare duhet të garantojnë zbatimin e efektshëm të së drejtës së fëmijëve, që interesi i tyre më i lartë të jetë në qendër të vëmendjes në të gjitha çështjet ku përfshihen fëmijët apo që kanë ndikim mbi ta.
2. Gjatë vlerësimit të interesave më të larta të fëmijëve të përfshirë apo të ndikuar:
 - a. duhet t'i jepet rëndësia e duhur pikëpamjeve dhe opinionëve të tyre;
 - b. duhet gjithmonë të respektohen të gjitha të drejtat e fëmijës, të tilla si e drejta për dinjitet, liri dhe trajtim të barabartë;
 - c. duhet të zbatohet një qasje gjithëpërfshirëse nga të gjitha autoritetet përkatëse në mënyrë që të merren parasysh të gjitha interesat në fjalë, duke përfshirë mirëqenien psikologjike, fizike dhe ligjore, interesat sociale dhe ekonomike të fëmijës.

3. Interesi më i lartë i të gjithë fëmijëve të përfshirë në të njëjtën procedurë apo çështje duhet të vlerësohet në mënyrë të ndarë dhe të baraspeshuar duke pasur parasysh mundësinë e bashkërendimit të interesave të mundshme konfliktuale të fëmijës.

4. Ndërkohë që autoritetet gjyqësore kanë kompetencën dhe përgjegjësinë themelore për marrjen e vendimeve përfundimtare, shtetet anëtare, kur është e nevojshme, duhet të bëjnë përpjekje të bashkërenduara për krijimin e qasjes shumëdisiplinore për objektivat e vlerësimit të interesave më të larta të fëmijës në procedurat ku ata janë të përfshirë.

• Karta për të Drejtat Themelore e Bashkimit Evropian

Neni 24 par. 2

Në të gjitha veprimet që ndërmerren në lidhje me fëmijët si nga autoritetet publike qoftë dhe nga institucionet private, interesat më të larta të fëmijës gëzojnë vëmendje parësore.

Interesat më të larta të fëmijës si konsideratë parësore janë të përcaktuara në disa akte të legjisllacionit të BE-së, të tilla si Rregullorja IIA e Brukselit, Direktiva 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, Direktiva 2011/93/BE për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, dhe Direktiva 2012/29/BE për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, të cilat deklarojnë se interesat më të larta të fëmijës duhet të vlerësohen në baza individuale. Madje, edhe Direktiva 2008/52/KE për disa aspekte të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare, e cila nuk përfshin dispozita të posaçme për fëmijët, parasheh konfidencialitetin e ndërmjetësve, përveç rasteve kur nevojitet të sigurohet mbrojtja e interesave më të larta të fëmijëve. Rregullorja III e Dublinit (Rregullorja (BE) Nr. 604/2013), për shembull, përcakton disa kritere për një vlerësim të interesave më të larta, të tilla si mundësia e ribashkimit familjar, mirëqenia dhe zhvillimi i fëmijës, pikëpamjet e fëmijës në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij apo saj, aspekti i sigurisë dhe ruajtjes, veçanërisht në lidhje me rrezikun që fëmija mund të jetë viktimë e trafikimit.

• Jurisprudenca e GJEDNJ

Në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut,⁹ është përcaktuar në mënyrë të qartë parimi i prioritetit të ruajtjes së interesave më të larta të fëmijës. Gjykata Evropiane i është referuar asaj në kontekste të ndryshme gjatë viteve, duke filluar me ribashkimin e fëmijëve nën kujdesin social me prindërit e tyre (p.sh. Hokkanen kundër Finlandës, 23 shtator 1994, dhe Nuutinen kundër Finlandës, Nr. 32842/96). Gjykata ndonjëherë është

⁹ Zaunegger kundër Gjermanisë (Nr. 22028/04, 3 dhjetor 2009); Jeunesse kundër Holandës ([GC] Nr. 12738/10, 3 tetor 2014); Mennesson kundër Francës (Nr. 65192/11, qershor 2014.); Schneider kundër Gjermanisë (Nr. 17080/07, 15 shtator 2011); X kundër Letonisë ([GC] Nr. 27853/09, 26 nëntor 2013 §117, 119); Pini dhe të tjerëve kundër Rumanisë (Nr. 78028/01 dhe 78030/01, 22 qershor 2004).

kritikuar për mungesën e përkufizimit të qartë të kriterëve që duhen marrë parasysh kur vlerësohen interesat më të larta të fëmijës. Komenti i Përgjithshëm i Komitetit mbi të Drejtat e Fëmijës Nr. 10 është udhëzuesi formal për zbatimin e nenit 3 të KDF për administrimin e drejtësisë penale për të miturit.¹⁰ Ashtu siç shprehet Gjyqtarja Turković e GJEDNJ në një intervistë të dhënë për Programin HELP të Këshillit të Evropës: “..... interesi më i lartë i fëmijës është një koncept dinamik, i cili vazhdimisht evoluon dhe që ne duhet ta mundësojmë një gjë të tillë dhe kur shqyrtojmë nivelin vendas ne duhet ta shqyrtojmë atë si një koncept që zhvillohet. Çdo rast duhet parë në kontekstin e veçantë të çështjes përkatëse dhe duhet t’i japim mundësinë që me kalimin e kohës, interesi më i lartë të mund të ketë ndryshuar nga koha kur është vlerësuar për herë të parë. Ne kemi raste të caktuara ku Gjykata ka pranuar, si për shembull në rastin *Mihailova kundër Bullgarisë apo M. dhe M. kundër Kroacisë*, se ndryshimi i vendimit të parë të autoriteteve kombëtare ka qenë i rregullt për shkak të faktit se me kalimin e kohës ka ndryshuar ajo që është në interesin më të lartë të fëmijës. Të gjitha këto theksojnë faktin se nuk është mirë dhe Gjykata për këtë arsye shmang dhënien e vendimeve sipas nenit 46 në lidhje me interesin më të lartë të fëmijës, pasi ne besojmë fort se autoritetet kombëtare janë instanca shumë më të mira për të marrë një vendim sesa vetë Gjykata”.

2.1.2 E drejta e fëmijës për t’u dëgjuar (neni 12 i KDF)

Zëri i fëmijës duhet të dëgjohet dhe respektohet në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të drejtat e tij/saj. Ky është një nga parimet kryesore të KDF dhe të drejtësisë miqësore me fëmijët. Kjo çështje është trajtuar në vitet e fundit, nga një praktikë e gjerë gjyqësore, duke u konceptuar gjerësisht si “pjesëmarrje” megjithëse ky term nuk gjendet në tekstin e KDF. Ky term ka evoluar dhe tashmë përdoret gjerësisht për të përshkruar proceset në vazhdim, ku përfshihen fëmijët dhe të rriturit, bazuar në respektin e ndërsjellë dhe ku fëmijët mund të mësojnë se si merren parasysh pikëpamjet e tyre dhe të të rriturve dhe se si ata i japin formë produkteve të proceseve të tilla. Shprehja e pikëpamjes është një zgjedhje e fëmijës, jo një detyrim. Shtetet palë duhet të garantojnë që fëmija të marrë të gjithë informacionin dhe këshillën e nevojshme për të marrë një vendim në favor të interesit më të lartë të tij/saj.

KDF deklaron se e drejta për t’u dëgjuar duhet t’i sigurohet çdo fëmije “që është në gjendje të ketë një pikëpamje të tij/saj”. Kjo frazë nuk duhet të konsiderohet si kufizuese, por si një detyrim për autoritetet përkatëse për të vlerësuar kapacitetin e fëmijës për të pasur një mendim të pavarur në shkallën më të lartë të mundshme. Kjo do të thotë se ata nuk mund të bazohen në supozimin se një fëmijë nuk është në gjendje të shprehë pikëpamjet e tij ose saj. Përkundrazi, duhet të supozohet se një fëmijë ka kapacitetin për të krijuar pikëpamjet e tij/saj dhe të pranojmë se ai/ajo ka të drejtë t’i shprehë ato. KDF parashikon se një fëmije duhet t’i bëhet vlerësimi i duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij/saj.

Kjo do të thotë se vetëm mosha nuk mund të përcaktojë rëndësinë e pikëpamjeve të një fëmije. Nivelet e të

kuptuarit tek një fëmijë nuk janë të lidhura në mënyrë uniforme me moshën biologjike. Kërkimet shkencore kanë treguar se informacioni, përvoja, mjedisi, pritshmëritë shoqërore dhe kulturore dhe nivelet e mbështetjes që merr fëmija, kontribuojnë të gjitha në zhvillimin e kapaciteteve të tij/saj për të krijuar një pikëpamje. Për këtë arsye, pikëpamjet e fëmijës duhet të vlerësohen në bazë të ekzaminimit të çdo rasti. Profesionistët, të cilët janë në kontakt me fëmijët, duhet të aftësohen në mënyrë adekuate (këtu përfshihet edhe trajnimi përkatës) për t'i dëgjuar ata duke u dhënë mundësinë që të shprehin lirisht mendimet e tyre dhe të japin dëshmi.

Neni 12, paragrafi 2, parashikon se mundësitë për t'u dëgjuar duhet të jenë të parashikuara në mënyrë të veçantë "në çdo procedurë gjyqësore dhe administrative që ndikon tek fëmija". Gjithashtu, Neni 12, paragrafi 2, parashikon posaçërisht për fëmijët në konflikt me ligjin, të drejtën e tyre për ndihmë ligjore në përgatitjen dhe përfaqësimin e mbrojtjes së tyre. Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijës në Komentin e Përgjithshëm Nr. 12 të KDF¹¹ thekson se kjo dispozitë zbatohet në të gjitha procedurat gjyqësore relevante që prekin fëmijën, pa kufizime, duke përfshirë, për shembull, divorcin e prindërve, kujdestarinë, kujdesin prindëror dhe birësimin, fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime të dhunës fizike ose psikologjike, abuzimit seksual ose të krimeve të tjera, kujdesin shëndetësor, sigurinë sociale, fëmijët e pashoqëruar, azilkërkuesit dhe fëmijët e refugjatëve, dhe viktimat e konflikteve të armatosura dhe emergjencave të tjera. Procedurat tipike administrative përfshijnë, për shembull, vendime për arsimin, shëndetin, mjedisin, kushtet e jetesës, ose mbrojtjen e fëmijëve.

Si procedurat gjyqësore ashtu edhe ato administrative, mund të përfshijnë mekanizma alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi. E drejta e fëmijës për të mos folur dhe shprehur mendimet e tij, nëse ai/ajo është e përfshirë në procedurat e drejtësisë për të mitur është po aq e rëndësishme sa e drejta e shprehjes së pikëpamjeve nga fëmija. Megjithatë, në realizimin e kësaj të drejte është thelbësor roli i avokatëve në dhënien e këshillave dhe udhëzimeve për fëmijët se kur e drejta për të mos folur është në interesin e tyre më të lartë.

Një e drejtë tjetër e rëndësishme e garantuar për fëmijët në konflikt me ligjin, është e drejta e fëmijës për të marrë pjesë. Sipas nenit 16 të KLGJ " ... pjesëmarrja e fëmijëve në këtë proces përfshin të drejtën e fëmijës që të dëgjohet dhe të shprehë pikëpamjet e veta të cilave u jepet pesha e duhur, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës. Kur një fëmijë kërkon të dëgjohet, kërkesa do të pranohet, përveçse për arsye të rëndësishme që duhet të arsyetohen në vendimin përkatës. Nëse fëmija nuk është në gjendje ta ushtrojë këtë të drejtë, ai / ajo mund ta bëjë këtë përmes prindit si përfaqësues ligjor". Në të njëjtin nen, ligjvënësi ka adresuar çështjen e mendimeve të kundërta mes fëmijës në konflikt me ligjin dhe / ose përfaqësuesit të tij ligjor, duke ngarkuar organin kompetent të zgjidhë çështjen duke i dhënë përparësi kërkesave që i shërbejnë më mirë interesit më të mirë të fëmijës.

¹¹ CRC/C/GC/12.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Neni 12

1. Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.
2. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet në mënyrë të veçantë mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar.



Komente të Përgjithshme Nr. 12 të KDF-së (2009) E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar

(b) Paragrafi 2 i Nenit 12

(i) E drejta për "t'u dëgjuar në çdo procedim gjyqësor dhe administrativ që ndikon tek fëmija"

32. Neni 12, paragrafi 2, parashikon se mundësitë për t'u dëgjuar duhet të jenë të parashikuara në mënyrë të veçantë "në çdo procedurë gjyqësore dhe administrative që ndikon tek fëmija". Komiteti thekson se kjo dispozitë zbatohet në të gjitha procedurat gjyqësore relevante që prekin fëmijën, pa kufizime, duke përfshirë, për shembull, divorcin e prindërve, kujdestarinë, kujdesin dhe birësimin, fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë të dhunës fizike ose psikologjike, abuzimit seksual ose të krimeve të tjera, kujdesin shëndetësor, sigurinë sociale, fëmijët e pashoqëruar, azilkërkuesit dhe fëmijët e refugjatëve, dhe viktimat e konflikteve të armatosura dhe emergjencave të tjera. Procedurat tipike administrative përfshijnë, për shembull, vendime për arsimin, shëndetin, mjedisin, kushtet e jetesës ose mbrojtjen e fëmijëve. Të dy llojet e procedurave mund të përfshijnë mekanizma alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi.

33. E drejta për t'u dëgjuar zbatohet si për procedurat që fillohen nga fëmijët, siç janë ankesat kundër keqtrajtimit dhe ankesat kundër përjashtimit nga shkolla, ashtu edhe për ato procedura të filluara nga të tjerët që prekin fëmijën, siç është ndarja e prindërve ose birësimi. Shtetet palë inkurajohen të miratojnë masa ligjore që i kërkojnë vendimmarrësve në procedurat gjyqësore ose administrative të shpjegojnë shkallën e marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të fëmijës dhe pasojave për fëmijën.

34. Fëmija nuk mund të dëgjohet në mënyrë efektive kur mjedisi është frikësues, armiqësor, i pandjeshëm ose i papërshtatshëm për moshën e tij ose të saj. Procedurat duhet të jenë sa të aksesueshme aq edhe të përshtatshme për fëmijën. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sigurimit dhe dhënies së informacionit miqësor ndaj fëmijëve, mbështetjes adekuate për vetë-advokim, stafit të trajnuar mirë, projektimit të

dhomave të gjykatave, veshjeve të gjyqtarëve dhe avokatëve, ekraneve të shikuesve dhe dhomave të veçanta të pritjes.

(ii) “Ose drejtpërsëdrejti, ose përmes një përfaqësuesi apo organi të përshtatshëm”

35. Pasi fëmija të ketë vendosur që të dëgjohej, ai ose ajo do të duhet të vendosë se si do të dëgjohej: “ose drejtpërsëdrejti, ose nëpërmjet një përfaqësuesi ose organi të përshtatshëm”. Komiteti rekomandon që, kurdoherë që është e mundur, fëmijës duhet t’i jepet mundësia për t’u dëgjuar drejtpërdrejt në çdo procedurë.

36. Përfaqësuesi mund të jetë prindi/prindërit, avokati ose një person tjetër (ndër të tjerë, punonjësi social). Megjithatë, duhet të theksohet se në shumë çështje (civile, penale apo administrative) ekzistojnë rreziqe për një konflikt interesi mes fëmijës dhe përfaqësuesit të tij më të parë (prindit/prindërve). Nëse dëgjimi i fëmijës kryhet përmes një përfaqësuesi, atëherë është me rëndësi veçanërisht të madhe që pikëpamjet e fëmijës të transmetohen në mënyrë të saktë nga përfaqësuesi tek vendimmarrësi. Metoda e zgjedhur duhet të përcaktohet nga fëmija (ose nga autoriteti përkatës sipas nevojës) sipas gjendjes së tij ose saj të veçantë. Përfaqësuesit duhet të kenë njohuri të mjaftueshme dhe të kuptuarit e mjaftueshëm mbi aspektet e ndryshme të procesit të vendimmarrjes dhe përvojë në punën me fëmijët.

37. Përfaqësuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se ai ose ajo përfaqëson ekskluzivisht interesin e fëmijës dhe jo interesat e personave të tjerë (prindit/prindërve), institucioneve apo organeve (p.sh. qendrave rezidenciale, administratës apo shoqërisë). Duhet të zhvillohen kode sjelljeje për përfaqësuesit që caktohen për të përfaqësuar pikëpamjet e fëmijës.

(iii) “Në një mënyrë të përputhshme me rregullat procedurale të legjislacionit kombëtar”

38. Mundësia për përfaqësim duhet të jetë “në përputhje me rregullat procedurale të legjislacionit kombëtar”. Kjo klauzolë nuk duhet të interpretohet si lejim i përdorimit të legjislacionit procedural që kufizon ose pengon gëzimin e kësaj të drejte themelore. Përkundrazi, shtetet palë inkurajohen të respektojnë rregullat themelore të procedurave të drejta, të tilla si e drejta për t’u mbrojtur dhe e drejta për të pasur akses tek dosjet e veta.

39. Kur nuk respektohen rregullat procedurale, vendimi i gjykatës ose i autoritetit administrativ mund të kundërshtohet dhe mund të anulohet, zëvendësohet ose të kthehet përsëri mbrapsht për shqyrtim të mëtejshëm juridik.

(ii) E drejta e fëmijës për t’u dëgjuar në procedimet gjyqësore penale

57. Në procedimet penale, e drejta e fëmijës për të shprehur lirisht mendimin e saj apo tij në lidhje me të gjitha çështjet që prekin fëmijën, duhet të respektohet dhe zbatohet plotësisht gjatë çdo faze të procesit të drejtësisë për të mitur.

(iii) E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar në procedurat administrative

65. Të gjitha shtetet palë duhet të zhvillojnë procedura administrative në legjislacionin e tyre, të cilat pasqyrojnë kërkesat e nenit 12 dhe sigurojnë të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar së bashku me të drejta të tjera procedurale, duke përfshirë të drejtat për njohjen me të dhënat që kanë lidhje me çështjen, njoftimin për seancën dëgjimore dhe përfaqësimin nga prindërit ose persona të tjerë.

66. Fëmijët kanë më shumë gjasa të përfshihen në procedura administrative sesa në procedura gjyqësore, sepse procedurat administrative janë më pak formale, më fleksibël dhe relativisht më të lehta për t'u rregulluar me ligj ose rregullore. Procedurat duhet të jenë miqësore dhe të aksesueshme për fëmijët.

67. Shembujt e veçantë të procedurave administrative që kanë të bëjnë me fëmijët përfshijnë edhe mekanizma për trajtimin e problemeve disiplinore në shkolla (p.sh. pezullimet dhe përjashtimet), refuzimet për dhënien e certifikatave shkollore dhe çështjet e lidhura me performancën, masat disiplinore dhe refuzimet për dhënien e privilegjeve në qendrat e paraburgimit për të mitur, kërkesat për azil nga fëmijët e pashoqëruar dhe aplikimet për lejen e drejtimit të automjetit. Në këto çështje, fëmija duhet të ketë të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të gëzuar të drejta të tjera "në përputhje me rregullat procedurale të legjislacionit kombëtar".



Udhëzimet e OKB-së për drejtësinë në çështjet ku përfshihen fëmijët viklima dhe dëshmitarë të krimit, kapitujt III, Parimet, paragrafi 8, dhe VIII, E drejta për t'u dëgjuar dhe shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet

8. Sikurse përcaktuar në instrumentet ndërkombëtare dhe në veçanti në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, sikurse pasqyruar në punën e Komitetit mbi të Drejtat e Fëmijës, dhe për të siguruar drejtësi për fëmijët viklima dhe dëshmitarë të krimit, profesionistët dhe personat e tjerë, përgjegjës për mirëqenien e këtyre fëmijëve, duhet të respektojnë parimet e ndërthurura vijuese:

(d) E drejta e pjesëmarrjes. Çdo fëmijë, subjekt i një ligji procedural kombëtar, ka të drejtë që të shprehë lirshëm mendimet, opinionet dhe besimin e tij apo saj, me fjalët e veta dhe të kontribuojë veçanërisht në vendimet që ndikojnë mbi jetën e tij apo të saj, duke përfshirë edhe ato të marra në cilindo proces gjyqësor dhe që këto mendime t'i merren parasysh në përputhje me mundësitë, moshën, pjekurinë intelektuale dhe kapacitetet evoluese të tij apo saj.

21. Profesionistët duhet të bëjnë çdo përpjekje për t'i mundësuar fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me përfshirjen në procesin e drejtësisë, duke përfshirë edhe:

(a) Sigurimin që fëmijët viktime dhe aty kur është e përshtatshme fëmijët dëshmitarë, të konsultohen për çështjet e parapara në paragrafin 19 më lart;

(b) Sigurimin që fëmijëve viktime dhe dëshmitarë t'u mundësohet të shprehin lirisht dhe në mënyrën e tyre, mendimet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me përfshirjen e tyre në procesin e drejtësisë, shqetësimet e tyre në lidhje me sigurinë në lidhje me të akuzuarin, mënyrën në të cilën ata preferojnë që të japin dëshmi dhe ndjenjat e tyre për përfundimet e procesit;

(c) Dhënien e konsideratës së duhur për mendimet dhe shqetësimet e fëmijës dhe nëse nuk janë në gjendje që ta realizojnë këtë, t'ia shpjegojnë arsyet fëmijës.



Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët.

III. A. Pjesëmarrja

1. E drejta e të gjithë fëmijëve që të informohen për të drejtat e tyre, që t'u krijohen mënyrat e përshtatshme për të pasur akses në drejtësi dhe të konsultohen dhe të dëgjohen në procedurat që përfshijnë ose prekin ata, duhet të respektohet. Kjo përfshin marrjen parasysh në mënyrën e duhur të pikëpamjeve të fëmijëve duke pasur parasysh pjekurinë e tyre dhe çdo vështirësi komunikimi që ata mund të kenë për ta bërë kuptimplotë këtë pjesëmarrje.

2. Fëmijët duhet të konsiderohen dhe trajtohen si bartës të të drejtave të plota dhe duhet të kenë të drejtën të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tyre në një mënyrë që merr parasysh kapacitetin e tyre për të krijuar pikëpamjet e veta dhe rrethanat e rastit.

Standardet e GJEDNJ

Në çështje penale



Çështja e T. kundër Mbretërisë së Bashkuar ([GC] Nr. 24724/94, 16 dhjetor 1999, § 88) ka të bëjë me vrasjen e një fëmije dyvjeçar nga dy fëmijë të tjerë dhjetëvjeçarë. Ata u gjykuan në një gjykim publik nën vëmendjen e madhe të medias. Procedura e gjykatës u modifikua pjesërisht, duke u zhvilluar seanca pak më të shkurtra, prindërit e kërkuesit u vendosën pranë tij, një kënd lojërash u vu në dispozicion të tyre gjatë

pushimit, etj. Megjithatë, kërkuesi dhe i bashkëakuzuari tjetër i tij, u gjykuan në një gjykatë të rriturish dhe shumica e masave të rrepta u zbatuan përsëri në këtë çështje penale. Gjykata ishte e mendimit se kërkuesi nuk kishte mundur që të merrte pjesë në mënyrë efektive në procedurat penale për shkak të publicitetit të seancave, të kombinuara edhe me shkallën e lartë të vëmendjes së medias dhe kapacitetin e tij të kufizuar për të udhëzuar avokatët e tij dhe për të dhënë dëshmitë e duhura. Për këtë arsye ishin shkelur të drejtat e tij sipas nenit 6 të KEDNJ.

Në çështje civile



Në çështjen Sommerfeld kundër Gjermanisë [GC], nr. 31871/96, 8 korrik 2003, § 88) vajza 13-vjeçare e kërkuesit kishte shprehur një dëshirë të qartë që të mos e shikonte kërkuesin dhe e kishte bërë një gjë të tillë për disa vite. Gjykatat kombëtare ishin të mendimit se detyrimi i saj për të parë kërkuesin do të trazonte rëndë ekuilibrin emocional dhe psikologjik të saj. Gjykata pranoi se procesi i vendimmarrjes i dha kërkuesit mbrojtjen e kërkuar për interesat e tij.



Në çështjen Sahin kundër Gjermanisë ([GC], Nr. 30943/96, 8 korrik 2003, § 75) mamaja i ndaloi të gjitha kontaktet mes kërkuesit dhe vajzës së tij katërvjeçare. Gjykata rajonale gjermane vendosi se dhënia e aksesit të babait tek vajza e tij do të ishte e dëmshme për fëmijën për shkak të tensionit mes prindërve. Kjo gjykatë e bëri një gjë të tillë pa e dëgjuar fëmijën nëse ajo dëshironte që të shikonte babain e saj. Në pyetjen për dëgjimin e fëmijës në gjykatë, gjykata iu referua shpjegimit të ekspertit përpara gjykatës rajonale në Gjermani. Pas disa takimeve me fëmijën, nënën e saj dhe kërkuesin, eksperti konsideroi se procesi i marrjes në pyetje të fëmijës mund të shoqërohej me një rrezik për atë, i cili nuk mund të shmangej nga rregullimet e veçanta në sallën e gjyqit. GJEDNJ, në këto rrethana, konstatoi se kriteret procedurale që prekin nenin 8 të KEDNJ, për të dëgjuar një fëmijë në gjykatë, nuk përbënin detyrimin e pyetjes së drejtpërdrejtë të fëmijës për marrëdhënien e saj me babain e saj;



Në çështjen e Maumousseau dhe Washington kundër Francës (Nr. 39388/05, 6 dhjetor 2007, § 78-79) Gjykata e mori në shqyrtim argumentin e kërkuesit se gjykata kombëtare nuk e kishte marrë parasysh dëshminë e fëmijës, megjithëse një pretendim i tillë nuk ishte ngritur në gjykatën kombëtare. Këtu vërehet se Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijëve, në Vërejtjet e tij Përfundimtare të datës 30 qershor 2004 në lidhje me Francën, shprehu shqetësimin e tij për zbatimin e nenit 12 të Konventës së Nju Jorkut, dhe po ashtu vërejtje se në "Komentin e tij të Përgjithshëm, Nr. 7" të vitit 2005, Komiteti deklaroi se neni 12 zbatohet si për fëmijët e vegjël ashtu dhe për fëmijët e rritur. Megjithatë, mosmarrja e dëshmisë nga fëmija në çështjen në fjalë nuk përbënte një shkelje të nenit 8 të Konventës, pasi fëmija ishte intervistuar në disa raste nga ekspertë të ndryshëm, dëshmitë e saj ishin pasqyruar në raportet e tyre dhe më pas edhe referuar në vendimet gjyqësore të sfiduara më pas. Gjykata konstatoi se nga pikëpamja e moshës së fëmijës, marrja e dëshmisë nga ajo, mund të konsiderohej në rastin konkret si diçka jo vendimtare.



Në çështjen Blaga kundër Rumanisë (Nr. 54443/10, 1 korrik 2014, § 80) Gjykata vëren se Konventa e Hagës nuk kërkon që një gjyqtar në mënyrë automatike të miratojë dëshirat e deklaruara të fëmijës edhe nëse gjyqtari në fjalë konstaton se fëmija ka mbërritur një shkallë të mjaftueshme pjekurie. Për këtë arsye, Gjykata është e mendimit se ndërkohë që KEDNJ i njej fëmijës që kundërshton të drejtën që të shprehet, e drejta e shprehjes nuk përbën një të drejtë vetoje në një proces ku vendoset nëse ai apo jo do të kthehet.

Karta për të Drejtat Themelore e BE-së



Neni 24, paragrafi 1

Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit të nevojshëm për mirëqenien e tyre. Ata mund t'i shprehin lirisht pikëpamjet e tyre. Pikëpamje të tilla merren në konsideratë për çështje me interes për ta, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre.



Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) shqyrtoi çështjen Joseba Andoni Aguirre Zarraga kundër Simone Pelz (22 dhjetor 2010) që ka të bëjë me zhvendosjen e një fëmije të mitur nga Spanja për në Gjermani në shkelje të vendimit për kujdestari. GJDBE është pyetur nëse gjykata gjermane (me fjalë të tjera, gjykata e vendit ku është vendosur fëmija) mund të kundërshtonte urdhrin e zbatimit të lëshuar nga gjykata spanjolle (vendi i origjinës) bazuar në faktin se fëmija nuk është dëgjuar, duke shkelur kështu nenin 42, paragrafi 2, germa "a" të Rregullores Nr. 2201/2003 (Bruksel II bis) dhe nenin 24 të Kartës Evropiane të të Drejtave Themelore. Fëmija ka kundërshtuar kthimin kur ajo ka shprehur mendimin e saj në procedurat e zhvilluara në gjykatën gjermane. GJDBE arsyetoi se dëgjimi i fëmijës nuk është një e drejtë absolute, por nëse gjykata vendos se është e nevojshme, ajo duhet t'i ofrojë fëmijës mundësinë e vërtetë dhe të efektshme për të shprehur mendimin e saj apo tij. Ajo gjithashtu ishte e mendimit se e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar, siç parashikohet në Kartë dhe në Rregulloren e Brukselit II bis, kërkon procedura dhe kushte ligjore, të cilat i mundësojnë fëmijëve të shprehin mendimet e tyre lirshëm dhe këto të jenë në dispozicion të tyre dhe të gjykatës për të dëgjuar këto mendime. Gjykata gjithashtu, duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të organizuar seanca dëgjimore të tilla në lidhje me interesat më të larta të fëmijëve dhe rrethanat për çdo çështje individuale. Megjithatë, sipas vendimit të GJDBE, autoritetet e vendit ku është zhvendosur fëmija (Gjermania) nuk mund të kundërshtojnë kthimin e fëmijës në bazë të shkeljes së të drejtës për t'u dëgjuar në vendin e origjinës (Spanjë).



Manuali për profesionistët dhe politikëbërësit për drejtësinë për çështjet ku përfshihen fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të krimit.

Lista e plotë e zbatimit 5: e drejta për t'u dëgjuar dhe për të shprehur mendimet dhe shqetësimet

Për të zbatuar Udhëzimet për drejtësinë në çështjet ku janë të përfshirë fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të krimit dhe në veçanti, për të siguruar të drejtat e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për të shprehur mendimet dhe shqetësimet, aktorët e mëposhtëm mund të marrin në konsideratë si në vijim:

a Gjyqtarët: të monitorojnë nga afër mënyrën se si palët i drejtohen fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë dhe të sigurojnë që gjuha e përdorur të jetë e përshtatshme;

(b) Zyrtarët e zbatimit të ligjit:

(i) Të jenë të vëmendshëm ndaj mendimeve, shqetësimeve dhe nevojave që mund të shprehen nga fëmijët viktimë dhe dëshmitarë gjatë kontaktit të tyre me nëpunësit e zbatimit të ligjit duke iu përgjigjur pozitivisht sa herë që të jetë e mundur dhe duke u shpjeguar, në gjuhën që kuptojnë fëmijët, se pse disa mendime, kërkesa apo pritshmëri do të merren parasysh ose jo;

(ii) Ta bëjnë trajnimin për komunikimin me fëmijët të detyrueshëm për nëpunësit e zbatimit të ligjit që merren me fëmijë.

(c) Avokatët: Në shtetet ku fëmijët viktimë asistohen nga një avokat, të përcaktojnë mendimet, shqetësimet, pritshmëritë dhe nevojat e fëmijës duke ia përcjellë këto autoriteteve përkatëse dhe t'i shpjegojnë fëmijës se çfarë pritet në mënyrë të arsyeshme nga përfshirja e tij në procesin e drejtësisë;

(d) Ligjvënësit/politikëbërësit:

(i) Të parashikojnë në legjislacion, të drejtën e çdo fëmije, pavarësisht moshës së tij apo saj, që pa pasur nevojën e një autorizimi paraprak, të shprehë mendimet dhe shqetësimet e tij apo saj në procedurat ku ai ose ajo përfshihen si viktimë apo dëshmitarë;

(ii) Të zhvillojnë praktikën e hartimit të deklaratave të ndikimit mbi viktimën apo procedurave të barasvlershme për të përcaktuar mendimet e fëmijës dhe familjes së tij apo saj;

(iii) Aty ku mund të jetë e zbatueshme, të promovojnë proceset e drejtësisë restauruese ku fëmijët viktimë dhe komunitetet e tyre të mund të shprehin mendimet e tyre dhe të dëgjohen për dëmin që u është shkaktuar;

(iv) Në shtetet ku viktimat nuk mund të marrin pjesë në procedurat penale dhe civile kundër shkelësve të tyre, të sigurohen gjithsesi që pikëpamjet dhe shqetësimet e fëmijëve viktimë të regjistrohen dhe të merren parasysh;

(v) Ta bëjnë trajnimin e komunikimit me fëmijët të detyrueshëm për të gjitha grupet e profesionistëve që merren me fëmijët në proceset e drejtësisë.

(e) Organizatat jo qeveritare dhe ato me bazë në komunitet:

(i) të promovojnë aktivitete ku fëmijëve u jepet mundësia që të shprehin mendimet e tyre për çështjet e lidhura me proceset e drejtësisë dhe që lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në proceset e drejtësisë;

(ii) të informojnë fëmijët dhe komunitetet e tyre për të drejtat për të shprehur mendimet e tyre në proceset e drejtësisë.

(f) Prokurorët:

(i) Të zhvillojnë praktikën e marrjes dhe paraqitjes së deklaratave të ndikimit tek viktimë apo të procedurave të barasvlershme për të dëgjuar mendimet e fëmijëve dhe familjeve të tij;

(ii) Aty ku mund të jetë e zbatueshme, të promovojnë dhe marrin pjesë në proceset e drejtësisë restauruese ku fëmijët viktimë dhe komuniteti i tyre të mund të shprehin mendimet e tyre dhe të dëgohen për dëmin që u është shkaktuar.

2.1.3 Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 2 i KDF)

Ndalimi i diskriminimit ndaj fëmijëve bazohet në të njëjtat parime si ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit, goftë ky diskriminim që bazohet në moshë, racë, fe ose faktorë të tjerë të ndaluar. Në këtë drejtim, fëmijët janë një kategori që mund të vuajë pasojat e diskriminimit bazuar në të njëjtat arsye si çdo grup tjetër. Mbrojtja që nevojitet nuk është shumë ndryshe nga mbrojtja që garantohet në rastet e diskriminimit në përgjithësi. Kjo ngre çështjen e përcaktimit të grupeve që krahasohen, bazuar në standardet e zhvilluara nga e drejta ndërkombëtare, për të vlerësuar nëse ka diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose për të vërtetuar dallimin në trajtim, e më pas për të parë nëse ky është i përligjur apo jo..

Ndalimi i diskriminimit nuk do të thotë se fëmijët viktimë apo dëshmitarë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë me të rriturit, pavarësisht situatave dhe nevojave të tyre të veçanta. Përkundrazi, e drejta ndërkombëtare shpesh thekson nevojën e dallimit të fëmijëve nga të rriturit dhe garantimin e një mbrojtjeje

më të mirë për ata fëmijë që janë më të rrezikuar. Në këtë kategori përfshihen fëmijët e rrugës, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që vijnë nga komunitetet indigjene, vajzat, fëmijët përsëritës të cilët bien shpesh në konflikt me ligjin.¹² Komiteti i Ministrave ka përgatitur një vlerësim shumë të dobishëm dhe të përdorshëm, si dhe një listë të parimeve themelore që duhet të ndiqen në shumëllojshmërinë e madhe të rasteve ku autoritetet vendosin për çështjet e të drejtave të fëmijëve. Këto mund të jenë çështje shumë ndryshme si të drejtat e kujdestarisë, marrëdhëniet familjare, ndarja e fëmijëve nga familja e tyre, mund të jenë raste të migrantëve ose mund të jenë rastet kur një fëmijë është viktimë e krimit ose akuzohet se ka kryer një krim. Në të gjitha këto raste, përsëri parimi themelor është kombinimi i një procedure të drejtë me parimet e sigurimit të mbrojtjes adekuate të fëmijës, duke pasur parasysh cenueshmëritë e tyre.

• Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi drejtësinë miqësore për fëmijët

D. Mbrojtja nga diskriminimi

1 Të drejtat e fëmijëve duhet të garantohen pa asnjë lloj diskriminimi mbi baza gjinore, racore, ngjyre apo përkatësie etnike, moshe, gjuhe, besimi fetar, bindje politike, kombësie, prejardhjeje social-ekonomike, pasurore, lindjeje, orientimi seksual, etj.

2 Mbrojtje dhe asistencë e veçantë duhet t'i sigurohet fëmijëve në rrezik, si fëmijëve emigrantë, refugjatë, azilantë, fëmijëve të pashoqëruar, fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve të pastrehë, fëmijëve të rrugës, fëmijëve nga komuniteti rom si dhe fëmijëve në qendrat rezidenciale.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka një praktikë gjyqësore të pasur dhe të rëndësishme për çështjet e të drejtave të fëmijëve. Zakonisht, këto janë çështje të të drejtave prindërore, ndarjes së fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve të rrezikuar. Por ka edhe disa raste ku janë ngritur çështje të diskriminimit të fëmijëve në kontekstin e arsimit në bazë të origjinës etnike. Më e njohura nga këto raste, është çështja *DH dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, ku Gjykata për herë të parë në praktikën e saj gjyqësore, zhvilloi parimin e diskriminimit të tërthortë dhe përcaktoi parimin më të rëndësishëm në përcaktimin e diskriminimit të tërthortë dhe parimin e përligjjes.

2.1.4 E drejta e jetës dhe e mbijetesës (neni 6 i KDF)

Fëmijët kanë të drejtën e jetës dhe atë për t'u zhvilluar. Është detyra e shteteve të marrin masa për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e shëndetshëm të tyre. Të gjitha format e heqjes së lirisë (përfshi ndalimin, arrestimin dhe burgimin) mund të sjellin pasoja negative për zhvillimin harmonik të tyre dhe mund të dëmtojnë seriozisht riintegrimin e tyre.¹³ Për këtë qëllim, heqja e lirisë duhet të përdoret vetëm si alternativa e fundit dhe për një periudhë kohe sa më të shkurtër, siç përcaktohet në nenin 37 të KDF.

¹² CRC/C/GC/10, 6.

¹³ CRC/C/GC/10 & 11).

2.1.5 Parimet themelore të KDF, OKB të lidhura specifikt me drejtësinë për të mitur

Nenet 37 dhe 40 të KDF i kushtohen drejtësisë penale për të miturit. Këto nene përcaktojnë një numër të konsiderueshëm të drejtash për të fëmijët në konflikt me ligjin si p.sh. përdorimi i heqjes së lirisë vetëm si një alternativë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër, e drejta e fëmijës për t'u veçuar nga të rriturit në institucionet e paraburgimit apo vuajtjes së dënimit, e drejta për ndihmë ligjore dhe psikologjike falas si dhe të gjitha të drejtat procedurale të lidhura me një proces të drejtë ligjor, të cilat aplikohen njësoj si për të rrituri.

Përtej mbrojtjes që gëzojnë të rriturit, fëmijët e akuzuar apo dënuar për vepra penale, kanë të drejtën "... e një trajtimi në pajtueshmëri me zhvillimin e ndjenjës së dinjitetit dhe vlerës së fëmijës, që përforcon tek ai respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës, si dhe dëshirën për të nxitur riintegrimin e tij në shoqëri dhe marrjen e një roli konstruktiv në të" (Neni 40, paragrafi 1, i KDF).¹⁴

Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijës ka përgatitur një udhëzues ligjor formal mbi mënyrën e zbatimit të të drejtave të KDF, Komentin e Përgjithshëm Nr. 10 mbi të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur.¹⁵ Sipas Komitetit mbi të Drejtat e Fëmijës, sistemi i drejtësisë penale për të mitur duhet të jetë një sistem drejtësie i përshtatur me nevojat e fëmijës, i cili duhet të karakterizohet nga këta elementë kyç:

- i) parandalimi i kriminalitetit tek fëmijët;
- ii) shmangia pa filluar ndjekjen penale dhe shmangiet në kontekstin e ndjekjes penale duke përcaktuar modifikime specifike procedurale;
- iii) përcaktimi i moshës minimale për përgjegjësinë penale dhe moshës maksimale për drejtësinë penale për të miturit;
- iv) garancitë për një proces të drejtë; dhe
- v) heqja e lirisë, përfshi paraburgimin dhe burgimin, si një alternativë e fundit dhe për një periudhë sa më të shkurtër që është e mundur.

• Rregullat e Pekinit

Që drejtësia penale për të miturit të konsiderohet si drejtësi miqësore për të miturit, ajo duhet të jetë në përputhje jo vetëm me KDF, por edhe me standardet kryesore ndërkombëtare, siç janë ato që përfshihen në *Rregullat standarde minimale të OKB për administrimin e drejtësisë për të mitur (Rregullat e Pekinit)*. Këto rregulla edhe pse nuk janë të detyrueshme në aspektin juridik, përfaqësojnë kushtet minimale të pranuar në nivel ndërkombëtar për trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin.¹⁶

¹⁴ Neni 40 ka lidhje me nene të tjera të KDF ndër të cilat: neni 16: e drejta e privatësisë; neni 19: mbrojtja nga të gjitha format e dhunës; neni 20: përkujdesja alternative; neni 25: rishikimi periodik i masës/trajtimit; neni 37: ndalimi i dënimit me vdekje dhe burgim të përjetshëm, limite në kufizimin e lirisë; neni 39: rehabilitimi i viktimave, etj.

¹⁵ CRC/C/GC/10.

¹⁶ Rregulli 5 mbi "Qëllimet e drejtësisë për të miturit" nga Rregullat e Pekinit "Sistemi i drejtësisë për të miturit duhet të theksojë mirëqenien e të miturit dhe çdo reagim mbi të miturit shkelës të ligjit duhet të jetë gjithmonë në përputhje si me rrethanat e shkelësve ashtu edhe ato të shkeljes".

• Udhëzimet e Riadit

Udhëzimet e OKB për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit (Udhëzimet e Riadit) përfaqësojnë një qasje pro-aktive dhe praktike për të parandaluar rritjen e kriminalitetit tek të miturit, nëpërmjet listimit të disa metodave që shërbejnë për të shkurajuar këtë lloj kriminaliteti (edhe këto udhëzime nuk janë të detyrueshme).¹⁷ Politikat e parandalimit në nivel kombëtar duhet të ndihmojnë në thjeshtimin e socializimit dhe integrimin e të gjithë fëmijëve, duke u fokusuar në mbështetjen për familjet në rrezik dhe në veçanti duke përfshirë fëmijët e margjinalizuar.

• Rregullat e Havanës

Drejtësia miqësore për fëmijët ofron dënime dhe masa të tjera alternative nga heqja e lirisë, duke synuar respektimin e parimit se heqja e lirisë për të miturit duhet të përdoret vetëm si një alternativë e fundit dhe duhet të zgjasë sa më pak të jetë e mundur, për të mbështetur sa më mirë integrimin e tyre në shoqëri. Ky parim i rëndësishëm është parashikuar edhe nga Rregullat e OKB për mbrojtjen e të miturve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës).

Këto rregulla synojnë të shërbejnë si standarde minimale për mbrojtjen e fëmijëve, të cilëve u është hequr liria në çdo formë, në përputhje me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, me pikësynimin për të kundërbalancuar efektet negative të të gjitha formave të heqjes së lirisë dhe për të mbështetur riintegrimin e fëmijës në shoqëri.

Neni 40, paragrafi 3, i KDF kërkon nga shtetet anëtare të nxisin përdorimin e masave jashtëgjyqësore për fëmijët në konflikt me ligjin, duke siguruar respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe të garancive ligjore. Po ashtu, edhe Komenti i Përgjithshëm i Komitetit mbi të Drejtat e Fëmijës Nr. 10 parashikon një numër udhëzimesh se si të përdoren këto masa pa shkelur të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin. Për sa më sipër, përdorimi i këtyre masave duke evituar përfshirjen e fëmijëve në procedimin penal ose atë të drejtësisë penale për të miturit, dhe referimi në shërbimet sociale alternative apo ato të shmangies duhet të kthehen në një praktikë të konsoliduar, e cila duhet të përdoret në shumicën e rasteve që kanë të bëjnë me fëmijët.¹⁸

• Udhëzimet mbi drejtësinë miqësore për fëmijët

Një tjetër instrument kyç në fushën e drejtësisë për të miturit, i cili synon rritjen e aksesit të të miturve në drejtësi dhe përmirësimin e trajtimit të tyre nga ky sistem, janë *Udhëzimet për drejtësinë miqësore për fëmijët të Këshillit të Evropës*.¹⁹ Ato promovojnë ndër të tjera, parimin e interesave më të larta të fëmijës, kujdesin dhe

¹⁷ Parimet themelore të Riadit "Parandalimi i kriminalitetit të të miturve është një pjesë esenciale e parandalimit të krimit në shoqëri. Duke u përfshirë në aktivitete të ligjshme, sociale dhe të dobishme dhe duke adaptuar një qasje humaniste kundrejt shoqërisë dhe jetës, të rinjtë mund të zhvillojnë zakone jo-kriminale".

¹⁸ CRC/C/GC/10, paragrafët 24 – 25.

¹⁹ Këto Udhëzime mund të gjenden në <https://rm.coe.int/16804b2cf3>.

respektin, pjesëmarrjen efektive, trajtimin e barabartë dhe respektimin e ligjit. Gjithashtu, këto udhëzime inkurajojnë përdorimin e qasjeve dhe trajnimeve shumëdisiplinore duke kërkuar nga shtetet anëtare sigurimin e garancive procedurale gjatë gjithë fazave të procedimit penal në sistemin e drejtësisë penale për të mitur.

Udhëzimet për drejtësinë miqësore për fëmijët të Këshillit të Evropës nuk janë formalisht të detyrueshme, por ato janë hartuar bazuar mbi instrumente dhe standarde ndërkombëtare dhe evropiane, siç është KDF. Një karakteristikë e rëndësishme e Udhëzimeve për drejtësinë miqësore për fëmijët është fakti se ato janë hartuar fillimisht përmes një procesi ndërqeveritar së bashku me fëmijët. Gjatë procesit të hartimit të tyre janë pyetur edhe fëmijët me mbështetjen e UNICEF dhe Rrjetit Evropian të Avokatëve të Popullit për Fëmijët. Intervistat me fëmijët kanë dhënë këshilla shumë konkrete, duke treguar rëndësinë e lejimit të fëmijëve në ushtrimin e të drejtave të tyre, pra aksesin e tyre në drejtësi. Të rriturit ndonjëherë, marrin vendime për ta, për të cilat besojnë se janë në interesin më të lartë të fëmijës, por për të përcaktuar interesin më të lartë të fëmijës është shumë e rëndësishme që fëmijët të kenë mundësi të shprehen dhe të paraqesin pikëpamjet e tyre.

• **Parimet e drejtësisë miqësore për fëmijët në legjislacionin e Bashkimit Evropian**

Pesë direktivat e Bashkimit Evropian, të ashtuquajtura “direktivat e të drejtave të procesit të drejtë” parashikojnë garanci të gjera procedurale për personat e dyshuar apo akuzuar në procesin penal, të cilat aplikohen si për fëmijët ashtu dhe të rriturit:

- Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e përkthimit me gojë dhe me shkrim në procedimin penal;
- Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procedimin penal;
- Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2013 mbi të drejtën e aksesit në një avokat në procedimin penal dhe në procedimet e urdhrit evropian të arrestit, dhe mbi të drejtën për të informuar palët e treta gjatë privimit të lirisë dhe për të komunikuar me palët e treta dhe me autoritetet konsullore gjatë privimit të lirisë;
- Direktiva 2016/343/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 mars 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë prezent në procedimin penal;
- Direktiva 2016/1919/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi ndihmën juridike për personat e dyshuar apo akuzuar në procedimet penale dhe për personat e kërkuar në procedimet e urdhrit evropian të arrestit.

Vetëm në vitin 2016, Bashkimi Evropian miratoi Direktivën 2016/800/BE²⁰ mbi garancitë procedurale për fëmijët e dyshuar apo akuzuar në procedimet penale, duke synuar përcaktimin e standardeve detyruese minimale për të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo Direktivë përbën instrumentin e vetëm që i kushtohet në mënyrë të posaçme fëmijëve në konflikt me ligjin dhe që përmban elemente të drejtësisë miqësore për të miturit. Ajo mbështetet tek KDF, Parimet e Përgjithshme të Drejtësisë Miqësore për Fëmijët të Këshillit të Evropës, Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, si dhe Konventën mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Gjithashtu, kjo Direktivë duhet të lexohet së bashku me nenet 21, paragrafi 1 dhe 24 të Kartës mbi të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian, në të cilat janë përfshirë parimet e përgjithshme të KDF, si interesi më i lartë i fëmijës, mosdiskriminimi, pjesëmarrja si dhe mbrojtja e mirëqenies së fëmijës.

2.1.6 Ushtrim për nxjerrje idesh – Ky ushtrim mund të zhvillohet përpara dhe/ose pas Modullit I nga trajnerët

Trajnerët bëjnë ndarjen e pjesëmarrësve në 3 – 4 grupe në varësi të numrit të tyre, ku çdo grupi i jepen pyetje (të ndryshme) mbi kuptimin dhe rëndësinë që ka drejtësia miqësore me fëmijët, cilat janë dhe përse është e rëndësishme të zbatohen parimet e saj, me fokus të veçantë zbërthimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Trajnerët duhet t'i orientojnë diskutimet në mënyrë që t'u tregojnë avokatëve parimet kryesore të instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve, duke filluar nga ato të KDF të OKB por edhe të instrumenteve të tjera ndërkombëtare si p.sh., Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët, zbërthimin e parimit kryesor dhe unik për të miturit, atë të vlerësimit të interesit më të lartë të fëmijës si parim mbizotërues, jurisprudencën e GJEDNJ, etj.

Për më tepër, trajnerët duhet të theksojnë rëndësinë pse fëmijës i nevojitet përfaqësimi i duhur ligjor kur interesat e tij/saj vlerësohen dhe përcaktohen formalisht nga gjykata dhe organet përkatëse. Çdo vendim që ka të bëjë me fëmijën ose fëmijët duhet të motivohet, përligjet dhe shpjegohet për të treguar se është respektuar e drejta e fëmijës për të pasur të vlerësuar dhe konsideruar në mënyrë parësore interesin e tij apo saj më të lartë. Motivimi duhet të deklarohet në mënyrë të veçantë të gjitha rrethanat faktike në lidhje me fëmijën, çfarë elementesh janë gjetur si relevantë në vlerësimin e interesit më të lartë, përmbajtjen e elementëve në çdo rast të veçantë dhe se si janë shqyrtuar për të përcaktuar interesat më të larta të fëmijës. Nëse vendimi ndryshon nga pikëpamjet e fëmijës, arsyetimi për këtë duhet të shprehet në mënyrë të qartë. Nëse përjashtimisht, zgjidhja e ndërmarrë nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, atëherë duhet të paraqiten arsye për këtë në mënyrë që të tregohet se interesat më të larta të fëmijës janë konsideruar në

²⁰ Direktiva 2016/800/BE, recital 1: "Qëllimi i kësaj direktive është të krijojë garanci procedurale për të siguruar që fëmijët, që nënkupton personat nën 18 vjeç, të cilët janë të dyshuar apo akuzuar në procedimet penale, janë në gjendje për të kuptuar dhe ndjekur ato procedime si dhe për të ushtruar të drejtat e tyre në një proces të drejtë dhe për të parandaluar recedivizmin dhe përsheptuar integritimin social të tyre".

mënyrë parësore pavarësisht rezultatit. Nuk mjafton të thuhet me terma të përgjithshme se konsideratat e tjera dominonin ndaj interesave më të larta të fëmijës; të gjitha konsideratat duhet të përcaktohen në mënyrë specifike në lidhje me rastin në fjalë dhe duhet shpjeguar edhe arsyeja se pse ato kanë peshë më të madhe në rastin konkret. Arsyetimi duhet gjithashtu të tregojë, në një mënyrë të besueshme, arsyen se pse interesat më të larta të fëmijës nuk ishin mjaftueshmërisht të forta për të dominuar ndaj konsideratave të tjera. Rrethanat në të cilat interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata kryesore duhet të merren parasysh.

Trajneri pas raportimit të grupeve shpjegon çështjet e përcaktuara në temën I.

Tema II: Roli i avokatit sipas KDPM me fokus të veçantë në njohjen dhe ndërgjegjësimin mbi procedurat jo-gjyqësore. Përkufizimet dhe avantazhet në aplikimin e procedurave të drejtësisë restauruese, masave të shmangies nga procesi dhe ndërmjetësimin në përputhje me garancitë procedurale dhe kushtet e përcaktuara në KDPM

3.1 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

Në kuadër të paketës ligjore të reformës në drejtësi, u hartua dhe miratua me Ligjin Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”. Ky është një ligj i veçantë për shkak të përmbajtjes si të normave materiale dhe ashtu edhe atyre procedurale, duke përfshirë të gjitha dispozitat për të miturit nga Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Ligji për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe Paraburgosurve. Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” është hartuar në përputhje të plotë me KDF, jo vetëm në kontekstin e të drejtave, por edhe të ngritjes së një sistemi mbrojtjeje për realizimin efektiv të tyre.

Qëllimi i këtij Kodi është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve, integrimi social i tyre, rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dëshmitarë dhe viktima, parandalimi i viktimizimit të dytë ose riviktimizimit, parandalimi i kryerjes së veprave penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë.

Bazuar në standardet ndërkombëtare dhe rajonale të drejtësisë miqësore për fëmijët, të cilat u trajtuan në pjesën e parë të këtij Udhëzuesi, KDPM mbështetet në këto parime dhe garanci procedurale, jo vetëm për të miturit në konflikt me ligjin por edhe për ata fëmijë që përfshihen në sistemin e drejtësisë me statusin e viktimës ose dëshmitarit. Në KDPM parashikohen të drejta dhe garanci për të miturin në statusin e: i) dëshmitarit; ii) viktimës; iii) të akuzuarit për kryerjen e një veprë penale; iv) të miturit në programe për shmangien nga ndjekja penale, të drejtësisë restauruese, ndërmjetësim, etj.; v) të dënuarit; vi) të miturit në provë.

Parimet e përgjithshme të KDPM janë të përcaktuara në nenet 8 – 18 dhe përfshijnë:

- i) Parimin e mbrojtjes nga diskriminimi;
- ii) Të drejtën për zhvillim harmonik të të miturit
- iii) Parimin e interesit më të lartë të fëmijës;
- iv) Kufizimin ose heqjen e lirisë si masë e fundit;
- v) Drejtësinë miqësore;
- vi) Prezumimin e pafajësisë;
- vii) Shmangien nga ndjekja penale dhe dënimi penal;

- viii) Parimin e proporcionalitetit;
- ix) Shqyrtimin pa vonesë dhe me përparësi.

Këto parime shoqërohen dhe nga një numër garancish procedurale për fëmijët në sistemin e drejtësisë, përcaktuar në nenet 19 – 24 ku përfshihen: i) e drejta e të miturit për jetë private; ii) mbrojtja e të dhënave personale; iii) e drejta për t'u informuar; iv) mbrojtja; v) ndihma juridike dhe mbështetja psikologjike; vi) prania e të miturit, prindit, përfaqësuesit ligjor ose procedural; vii) vlerësimi individual; viii) shërbimet falas.

Interesi më i lartë i fëmijëve konsiderohet si një nga parimet themelore të drejtësisë penale për fëmijët në konflikt me ligjin në Shqipëri. Ky koncept edhe pse jo i ri në legjislacionin shqiptar, u prezantua në fushën e drejtësisë penale vetëm në vitin 2017 me Kodin e ri të Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM), ndërsa ai ishte përfshirë që nga viti 2008 në Kodin e Familjes. Arsyeimi i këtij ndryshimi të vonë kishte të bënte me faktin se shumë profesionistë të fushës juridike kanë hasur vështirësi në aplikimin e këtij parimi për fëmijët e dyshuar dhe /ose të akuzuar për kryerje të krimeve. Për shumë prej tyre ishte më e lehtë për të kuptuar dhe zbatuar një parim të tillë në sferën e mbrojtjes së fëmijëve sesa në rastet e drejtësisë penale. KDPM përfaqëson në këtë aspekt një hap të madh përpara sepse u garanton fëmijëve në konflikt me ligj të njëjtin lloj mbrojtje si fëmijëve të tjerë.

KDPM përcakton në nenin 10, detyrimet pozitive të të gjitha organeve të përfshira në drejtësinë penale për të mitur, që duhet të përfshijnë në vendimet dhe aktet e tyre një arsyetim të veçantë në lidhje me mënyrën si është analizuar dhe siguruar interesi më i lartë i fëmijës. Ky detyrim edhe pse në dukje tingëllon formal, në të vërtetë është shumë i rëndësishëm, sepse krijon terrenin e duhur për ankime të suksesshme në rast se, gjykata, prokuroria, policia, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve nuk i kanë bazuar ose nuk i argumentojnë veprimet dhe vendimet e tyre mbi parimin e interesit më të lartë të fëmijës, i cili do të kërkonte ekzaminimin e elementeve, si më poshtë:

- a)** nevojat e fëmijës për zhvillim fizik dhe psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen /përkatësinë në një familje;
- b)** mendimin e fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- c)** historinë e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
- ç)** aftësinë e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
- d)** vazhdimësinë e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe /ose shpirtërore.

3.2 Avokati i specializuar në drejtësinë për të mitur sipas KDPM

3.2.1 Çfarë është avokati për fëmijët?

Mbështetja e një avokati të specializuar nevojitet sa herë që fëmijët përfshihen në sistemin e drejtësisë. Ndryshe nga e kaluara, sot një fëmijë, falë të gjitha instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale është bartës i të drejtave të cilat i sigurojnë pjesëmarrje të plotë dhe efektive në të gjitha procedurat gjyqësore apo administrative që kanë lidhje me të. Që të mund të realizohet plotësisht kjo pjesëmarrje, fëmija duhet të përfaqësohet nga një avokat i specializuar në procedurat para, gjatë dhe pas proceseve gjyqësore civile dhe penale.

Në KDPM përcaktohet që i mituri viktimë ose në konflikt me ligjin të mbrohet nga avokatë të specializuar në drejtësinë penale për të mitur, me përjashtim të rasteve kur i mituri ose përfaqësuesi i tij ligjor përzgjedh një avokat tjetër. Për këtë qëllim, Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA) vë në dispozicion të institucioneve të ndihmës juridike falas një listë të avokatëve të specializuar në drejtësinë penale për të mitur, pas trajnimit të tyre mbi parimet e drejtësisë miqësore dhe të drejtat e fëmijëve.

Pavarësisht nëse avokati është i zgjedhur nga vetë i mituri apo përfaqësuesi i tij ligjor apo i caktuar nga lista e avokatëve që përgatit DHKA, ai DUHET:

1 Të jetë një person i besuar për fëmijën

Për këtë qëllim avokati duhet të:

- Trajnohet mbi udhëheqjen që duhet t'i bëjë fëmijës gjatë procedurave të drejtësisë për të mitur. Është e kuptueshme që për këtë, atij i nevojitet të ketë njohuri të kënaqshme mbi mënyrën e funksionimit të sistemit të drejtësisë për fëmijë, masat e posaçme për fëmijët, sidomos ato të shmangies dhe masat alternative, rolin e aktorëve të tjerë me të cilët duhet të bashkëpunojë, sidomos të psikologut apo punonjësit social, ndërmjetësit, përfaqësuesit procedural, punonjësit të njësisë së mbrojtjes së fëmijëve, punonjësit të policisë, gjyqtarit apo prokurorit, etj. Përveç avokatit, i cili duhet të shoqërojë të miturin në çdo procedurë përgjatë gjithë procesit, madje edhe pas tij sipas parashikimit në Kod të rolit të avokatit në fazën e vuajtjes së dënimit,²¹ edhe psikologu dhe prindi/përfaqësuesi ligjor janë aktorë të tjerë shumë të rëndësishëm, që duhet të jenë prezent dhe ta mbështesin të miturin në çdo fazë të procedurave, kur kjo pjesëmarrje nuk bie ndesh me interesat më të larta të të miturit;

- Avokati ka për detyrë që të informojë të miturin mbi të drejtat e tij në një gjuhë të kuptueshme dhe miqësore;
- Informimi i fëmijës mbi alternativat e mundshme dhe pasojat e secilës prej tyre është po aq i rëndësishëm;
- Dëgjimi i fëmijës dhe respektimi i mendimit të tij mbi çështjen është një garanci themelore në ushtrimin e së drejtës së tij/saj për të marrë pjesë në mënyrë efektive në gjykim;
- Krijimi i marrëdhënies së besimit me fëmijën;
- Të takohet me klientin e mitur disa herë dhe në ambiente të përshtatshme apo të përshtatura me nevojat e fëmijës.

2 Duhet të bëhet zëdhënësi dhe mbrojtësi i opinionëve dhe interesave të fëmijës

Marrëdhënia avokat – klient nuk duhet të influencohet nga familja e të miturit apo nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore. Avokati duhet të punojë në bazë të instruksioneve që i jep fëmija dhe në përputhje me interesat e tij më të larta:

- duhet të kuptojë se sa fëmija e kupton situatën ku ndodhet, çfarë dëshiron ai/ajo me qëllim për t'ia transmetuar këtë gjyqtarit edhe në rastet kur për sytë e të rriturve ky opinion nuk është relevant. Informimi i fëmijës mbi strategjitë dhe pasojat e secilës prej tyre, do të përmbushë detyrimin e avokatit që fëmija të marrë një vendim vetëm pasi të jetë informuar plotësisht mbi pasojat;
- duhet të identifikojë interesin më të lartë të fëmijës (nëpërmjet analizës rast pas rasti) dhe duhet të jetë në gjendje të vlerësojë ndikimin e mundshëm mbi mirëqenien fizike dhe psikologjike të tij. Gjithashtu, ky identifikim kërkon edhe respektimin e garancive të procesit të drejtë penal;
- duhet të kërkojë që të përdoren të gjitha përshtatjet e domosdoshme procedurale mbështetur në të drejtën që kanë fëmijët në konflikt me ligjin, për të marrë pjesë në procedura të specializuara, të përshtatura në varësi të nevojave dhe moshës së fëmijës,²² si p.sh. zhvillimi i seancave me dyer të mbyllura si rregull i përgjithshëm, trajtimi i çështjeve në mënyrë të shpejtë, informimi i plotë i prindit/përfaqësuesit ligjor mbi çështjen dhe e drejta e tyre për të marrë pjesë në çdo fazë të procesit, sa kohë nuk kanë një konflikt interesi me fëmijën e tyre;

²² Neni 16, pikat 4 – 6 i KDPM.

- bërrja e mundur që zëri i fëmijës t'i bëhet i ditur edhe profesionistëve të tjerë në proces. Për këtë qëllim, avokati duhet të marrë kontakt me të gjithë profesionistët, në prani të fëmijës nëse është e mundur, për të mos e përjashtuar nga vendimmarrja e tyre;
- duhet gjithmonë të kërkojë nga gjyqtarët që këta të fundit të marrin në konsideratë mendimet e fëmijës apo të japin arsytet në rast refuzimi.

3 Duhet të bashkëpunojë me profesionistë të tjerë në sistemin e drejtësisë për të mitur

Bazuar në një anketim të kryer në disa vende të BE-së,²³ avokati i të miturit nuk shikohet nga profesionistët e tjerë si një aktor kyç në proces për të mbrojtur interesat më të larta të fëmijës. Për këtë qëllim, avokati duhet të kuptojë rolin e tij në sistemin e drejtësisë për të mitur në mënyrë që të luajë një rol aktiv dhe kjo nënkupton:

- të kuptojë rolin e veçantë në procedurat e drejtësisë për të mitur;
- të ketë njohuri të mira mbi funksionimin e sistemit dhe rolin e secilit aktor në të;
- të jetë i ndërgjegjshëm mbi ndihmën që mund të kërkojë dhe të marrë nga profesionistët e tjerë në punën e tij si avokat;
- të komunikojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të forcojë bashkëpunimin me psikologun, punonjësin social, përfaqësuesit nga njësia e mbrojtjes së fëmijëve, etj;
- të sjellë zërin e fëmijës tek profesionistët e tjerë dhe çfarë mendon ai për ta.

3.2.2 Avokati i specializuar në drejtësinë për të mitur sipas procedurave të KDPM

Avokati i specializuar dhe caktimi i tij:

- I mituri viktimë ose në konflikt me ligjin mbrohet nga avokatë të specializuar në drejtësinë për të mitur, me përjashtim të rasteve kur i mituri ose përfaqësuesi i tij ligjor përzgjedh një avokat tjetër;
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë vë në dispozicion të institucioneve të ndihmës juridike falas, një listë të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur;

- Institucioni që administron ndihmën juridike falas, në rastet e parashikuara me ligj, siguron menjëherë ndihmë ligjore mbi bazën e kërkesës së të miturit ose të çdo organi kompetent. Kur kërkesa bëhet nga i mituri, ajo mund të paraqitet në çdo lloj forme përpara organit kompetent, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- Përfaqësuesi ligjor i të miturit ka të drejtë të zgjedhë dhe të caktojë, në mënyrë të pavarur, një mbrojtës, duke marrë parasysh interesin më të lartë të të miturit;
- Nëse një i mitur në konflikt me ligjin nuk ka zgjedhur mbrojtës, organi kompetent që kryen veprimin përkatës procedural, cakton menjëherë mbrojtësin sipas parashikimeve të KDPM;
- Kërkesa për caktimin e mbrojtësit, marrja dijani e të miturit dhe dhënia e pëlqimit të të miturit dhe në mungesë të këtij pëlqimi, të përfaqësuesit ligjor ose procedural të të miturit, shënohet në një procesverbal të veçantë. Sipas rastit, procesverbali nënshkruhet prej të miturit ose përfaqësuesit ligjor/procedural të të miturit dhe mbrojtësit;
- Në çdo rast, pjesëmarrja e mbrojtësit është e detyrueshme;
- Thëniet e të miturit të dyshuar, të bëra jo në prani të mbrojtësit, nuk mund të përdoren si provë.

Prania e detyrueshme e avokatit:

- Çdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin bëhet në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut;
- Nga ky rregull bëhet përjashtim vetëm në rastet kur veprimet ose mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike dhe/ose në rastet e parashikuara lidhur me gjendjen e flagrancës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale;
- Gjyqtari, gjatë gjykimit dhe prokurori në fazën e hetimit, mund të ndalojnë përfaqësuesin ligjor të të miturit në konflikt me ligjin, të marrë pjesë në një veprim procedural vetëm nëse një gjë e tillë është në interesin më të lartë të të miturit.

Roli i avokatit gjatë procedurave restauruese apo shmangies:

- Mbrojtësi informon të miturin mbi masat e drejtësisë restauruese, ndërmjetësimin apo shmangien nga procesi penal dhe pasojat e secilës alternativë;

- Gjatë negociimit të marrëveshjes për marrjen e masës së shmangies, i mituri ndihmohet nga mbrojtësi. Ai nënshkruan edhe marrëveshjen;
- Verifikimi i konfliktit të interesit midis të miturit dhe përfaqësuesit ligjor;
- Pyetja e të miturit në prani të mbrojtësit. Pyetja e të miturit nën 14 vjeç;
- Masa për fshirjen e të dhënave publike të të miturit;
- Masa për mosidentifikimin e të miturit;
- Pëlqimi për masat e shmangies; Programet e shmangies/ndërmjetësimit;
- I mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
- Masat mbrojtëse: shmangia e kontaktit të papërshtatshëm, të drejtpërdrejtë, urdhër-kufizimi, arresti në shtëpi, ruajtjen e sekretit për vendndodhjen, etj;
- Prania e detyrueshme në kontrollin personal ose ekzaminimin shëndetësor të të miturit;
- Gjykimi në mungesë.

Avokati në fazën e ekzekutimit:

- Për realizimin e të drejtave në procesin e ekzekutimit të vendimeve penale, të miturit i caktohet mbrojtës kryesisht sipas dispozitave të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi;
- Me pëlqimin e të miturit dhe kur kjo është në interes të tij, ky mbrojtës mund të jetë i njëjti që e ka përfaqësuar atë në fazat e mëparshme të procesit;
- Mbrojtësi merr pjesë në çdo seancë dëgjimore për masat disiplinore gjatë ekzekutimit të dënimit.

3.3 Instrumentet ndërkombëtare lidhur me te drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur me avokat

E drejta e fëmijëve për të pasur **akses në një avokat** nga fillimi i procedimit penal dhe që nga pyetjet e para të policisë.

Sipas të drejtës së BE, Direktiva 2013/48/BE mbi aksesin në një avokat, e cila hyri në fuqi më 27 nëntor 2016, i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtave të fëmijëve në pikat nr. 52 dhe 55 të preambulës së saj si edhe në nenet 5, pikat 2 – 4 dhe . Sipas pikës 55 të preambulës dhe nenit 5, paragrafi 2, nëse një fëmijë është i privuar nga liria, ushtruesi i përgjegjësishë prindërore duhet të njoftohet dhe t'i shpjegohen arsyet, me përjashtim të rastit kur kjo është në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës. Në këtë rast duhet të informohet një person tjetër i rritur i përshtatshëm. Sipas nenit 2, Direktiva zbatohet që nga çasti kur i dyshuari ose i akuzuari vihen në dijeni të dyshimit ose të akuzës për kryerjen e veprës penale e deri në përfundimin e procesit përmes dhënies së një vendimi fajësie ose pafajësie. Për më tepër, neni 3, paragrafi 3 nënvizon se aksesin në një avokat përfshin të drejtën e të dyshuarit/akuzuarit që të takohet dhe të komunikojë privatisht me avokatin, duke përfshirë realizimin e së drejtës, përpara marrjes në pyetje për herë të parë, prezencën dhe pjesëmarrjen efektive të avokatit gjatë marrjes në pyetje dhe prezencën e avokatit gjatë gjithë investigimit ose mbledhjes/marrjes së provave.

Rregullat e Pekinit

Rregulli 7.1

7.1 Garancitë kryesore procedurale si prezumimi i pafajësisë, e drejta për të marrë njoftim lidhur me akuzat, e drejta për të mos folur, e drejta për avokat mbrojtës, e drejta për të pasur pranë një prind ose kujdestar, e drejta për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe e drejta për t'u ankuar pranë një organi më të lartë, të garantohen në të gjitha shkallët e procedimit.

E drejta e fëmijës për t'u mbrojtur nga një avokat

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 37 (d): ... Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Neni 40.b (ii): ... dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij.

Parimet Bazë të OKB-së për Rolin e Avokatëve (1999) shkojnë më tej duke deklaruar se një avokat duhet të jetë me përvojë dhe të tregojë kompetencë në proporcion me natyrën e veprës. Me fjalë të tjera, avokati duhet të jetë i specializuar.

Rregullat e Pekinit

Rregulli 15

15.1 Gjatë të gjitha procedurave, i mituri duhet të ketë të drejtën për t'u përfaqësuar nga një këshilltar ligjor ose për të aplikuar për ndihmë juridike falas kur ka parashikime për këtë lloj ndihme në vend.

15.2 Prindërit dhe kujdestarët duhet të kenë të drejtën të marrin pjesë në procedura dhe mund t'iu kërkohet nga autoritetet kompetente të marrin pjesë në to, në interes të fëmijës. Megjithatë, atyre mund t'iu mohohet pjesëmarrja nga autoriteti kompetent nëse ka arsye për të supozuar se një përjashtim i tillë është i domosdoshëm në interes të fëmijës.

E drejta për t'u mbrojtur nga një avokat në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 6(3)(c): Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të vetëmbrohet ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.

Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi Drejtësinë Miqësore për Fëmijët

Pika 2, shkronja D "Drejtësia miqësore gjatë procesit gjyqësor":

(37) Fëmijët kanë të drejtën e këshillimit dhe përfaqësimit të tyre ligjor, në emër të tyre, në procese ku ka ose mund të ketë, një konflikt interesi ndërmjet fëmijës dhe prindërve ose palëve të tjera të përfshira.

(39) Avokatët që përfaqësojnë fëmijët duhet të trajnohen dhe të kenë njohuri mbi të drejtat e fëmijëve dhe çështjeve që kanë lidhje me to, të marrin trajnime të thelluara dhe vazhduese dhe të jenë të aftë të komunikojnë me fëmijët në përputhje me nivelin e tyre të të kuptuarit.

(40) Fëmijët duhet të konsiderohen klientë të plotë me gjithë të drejtat e tyre dhe avokatët që i përfaqësojnë

ata duhet të paraqesin opinionin e fëmijës.

(41) Avokati duhet t'i sigurojë fëmijës të gjithë informacionin dhe shpjegimet e nevojshme në lidhje me pasojat e mundshme të pikëpamjeve dhe/ose opinioneve të fëmijës.

(42) Në rastet kur ka një konflikt interesi ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, autoriteti kompetent duhet ose të caktojë një kujdestar ad litem ose një përfaqësues tjetër të pavarur për të përfaqësuar pikëpamjet dhe interesat e fëmijës.

(43) Përfaqësim i përshtatshëm dhe e drejta për t'u përfaqësuar në mënyrë të pavarur nga prindërit duhet të garantohet, veçanërisht në proceset ku prindërit, anëtarët e familjes ose kujdestarët janë autorët e supozuar të krimit.

3.4 Drejtësia restauruese, shmangia dhe masat alternative të dënimit sipas KDPM

Përpara miratimit të KDPM, në legjislacionin shqiptar, drejtësia restauruese dhe shmangia, ishin të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, përkatësisht në nenet 59, 284, 338, në Ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, në Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe në Kodin Penal.

Një nga risitë kryesore që ka sjellë Kodi, është përkufizimi i plotë i konceptit të përjashtimit nga përgjegjësia penale, shmangia nga procedurat gjyqësore – para, gjatë dhe pas procesit, si dhe programet e drejtësisë restauruese, si ndërmjetësimi, etj. Ky përcaktim në Kod është në përputhje me objektivin kryesor të Strategjisë së Reformës në Drejtësi dhe Planit të saj të Veprimit, në të cilën parashikohet: **“Reformimi i sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të drejtave të tyre procedurale”.**

3.4.1 Përse na nevojitet drejtësia restauruese?

Shumica e viktimave të krimeve të dhunshme as nuk e telefonojnë policinë, si fillim. Ata preferojnë që të mos bëjnë asgjë apo të mos përdorin asnjë nga garancitë apo të drejtat e tyre si viktimë. Shumica e vuajtjeve të të mbijetuarve të krimeve kalon pa u shëruar.

Nga ana tjetër, në shtetet anëtarë të Bashkimit Evropian e më gjerë, promovohet zbatimi i një qasjeje parandaluese dhe riintegruese në çështjet e drejtësisë penale për të mitur. Sistemi i drejtësisë penale nuk vihet në lëvizje në mënyrë automatike sapo kryhet një kundërvajtje nga fëmijët, ndërkohë që masat më konstruktive dhe edukative mund të jenë më të suksesshme. Gjithashtu, reagimi ndaj veprave duhet të jetë në përpjesëtim jo vetëm me rrethanat dhe peshën e veprës, por gjithashtu edhe me moshën, fajësinë më të vogël dhe me nevojat e fëmijës apo me nevojat e shoqërisë.

Ekzistenca e drejtësisë restauruese nënkupton se edhe në vendin tonë, ka ardhur koha që aktorët e sistemit të drejtësisë, sidomos ata të drejtësisë për të mitur të heqin dorë nga sjellja sikur nuk dinë se çfarë të bëjnë tjetër përveç dënimit dhe heqjes së lirisë së të miturve që bien në konflikt me ligjin. Si vend, ne jemi shumë të zotë për t’i dënuar dhe njëkohësisht për t’i përjashtuar ata nga përgjegjësia për atë që kanë bërë.

Drejtësia restauruese është një proces që i mban ata të përgjegjshëm. Ajo është një mjet. Njerëzit pyesin me radhë: Çfarë ndodhi? Çfarë nevojash kanë? Përgjegjësia e kujt është që të plotësojë ato nevoja? Dhe si do ta bëjë ai person atë gjë? Kërkohej që dikush të marrë përgjegjësinë për të riparuar gjërat sa më shumë që të jetë e mundur dhe të mos shkaktojë më dëme. Kjo nuk ka të bëjë thjesht me faljen që kërkon i mituri viktimë,

por është një kërkim falje që shoqërohet me vepra, si p.sh. shkuarja në shkollë, gjetja e një pune, pagesa e dëmshpërblimit, kërkimi i faljes, puna në komunitet, e të tjera si këto.

Praktikat e drejtësisë restauruese janë përdorur për t'u ballafaquar me shkelje të lehta nga vandalizmi deri kundër pasojave të vrasjeve tek anëtarët e mbijetuar të familjes. Proceset e drejtësisë restauruese së pari, janë për të përmbushur nevojat e njerëzve që janë dëmtuar. Ndonjëherë personi që mund të kontribuojë më shumë në shërimin e të mbijetuarit, është pikërisht ai që e ka lënduar atë.

Njerëzit që janë lënduar kanë të drejtë të marrin pjesë në një proces që do t'i ndihmojë ata të shërohen.. Sistemi formal/klasik i drejtësisë penale nuk jep asnjë prej këtyre rezultateve në drejtësinë penale për të mitur, ndërsa drejtësia restauruese i jep këto rezultate në mënyrën më të mirë. Shumica e shteteve evropiane janë fokusuar tek zgjidhja e konflikteve jashtë gjykatës, ndër të tjera përmes ndërmjetësimit, shmangies dhe drejtësisë restauruese duke siguruar njëkohësisht që këto procedura të mos përdoren për të penguar aksesin e fëmijëve në drejtësi dhe dëmtuar garancitë procedurale që përdoren në procedimet gjyqësore.

3.4.2 Përkufizime të drejtësisë restauruese, shmangies dhe ndërmjetësimit

• Drejtësia restauruese

Drejtësia restauruese është një qasje në të cilën viktimat dhe autori i veprës penale, në disa raste edhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale, *“marrin pjesë në mënyrë aktive bashkërisht në zgjidhjen e çështjeve të lidhura me veprën e kryer, zakonisht me ndihmën e një moderatori/ndërmjetësi”*.²⁴ Drejtësia restauruese nënkupton procesin për zgjidhjen e krimit, duke u fokusuar në korrigjimin e dëmit që u është bërë viktimave, mbajtjen si përgjegjës të të akuzuarit për veprën penale dhe shpesh edhe angazhimin e komunitetit në zgjidhjen e konfliktit.

Pjesëmarrja e palëve është një element thelbësor i procesit që thekson ndërtimin e marrëdhënieve, pajtimin dhe zhvillimin e marrëveshjeve rreth një rezultati të dëshiruar midis viktimave dhe autorëve. Proceset e drejtësisë restauruese mund të përshtaten sipas konteksteve të ndryshme kulturore dhe nevojave të komuniteteve të ndryshme. Përmes tyre, viktimat, autori dhe komuniteti rifitojnë kontrollin mbi procesin. Për më tepër, vetë procesi shpesh mund të transformojë marrëdhëniet midis komunitetit dhe sistemit të drejtësisë në tërësi.

Programet e drejtësisë restauruese bazohen në besimin se palët në konflikt duhet të përfshihen në mënyrë aktive në zgjidhjen e tij dhe zbutjen e pasojave negative të tij.

²⁴ UN Basic Principles on the use of restorative justice programmes in criminal matters (Parimet kryesore të OKB mbi përdorimin e programeve të drejtësisë restauruese në çështjet penale)

Në përputhje me parimet kryesore të drejtësisë restauruese dhe drejtësisë miqësore për fëmijët, KDPM jep përkufizimin se *“Masë e drejtësisë restauruese”* është çdo masë, e cila lejon një të mitur në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigojë pasojat e një veprë penale, të kompensojë dëmet dhe/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale, ku i mituri që ka kryer veprën penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për të zgjidhur pasojat e një veprë penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tretë të pavarur.

Programi i drejtësisë restauruese, mund të zbatohet nëse: i) i mituri, mbrojtësi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë; dhe ii) çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e arsyeshme dhe e përshtatshme.

Programi i drejtësisë restauruese mund të parashikojë që të miturit t’i kërkohet:

- të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe pasojën e shkaktuar ndaj viktimës;
- të kompensojë dëmin e shkaktuar ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;
- t’i kërkojë falje viktimës;
- të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktima ose/dhe komuniteti;
- të marrë pjesë në një procedurë ndërmjetësimi;
- të kryejë punë në interes publik;
- të marrë pjesë në programe rehabilituese lidhur me pasojat e veprës penale.

• ***Ndërmjetësimi***

Ndërmjetësimi në konceptin modern është trajtimi i konflikteve ose mosmarrëveshjeve me natyrë të ndryshme, si familjare, kontraktore e penale, duke gjetur zgjidhje përmes komunikimit të palëve në konflikt me praninë e një ndërmjetësi që është i licencuar, i akredituar, dhe që ka aftësinë për të gjetur zgjidhje, pra është një formë alternative jashtë rrugëve gjyqësore. Nëpërmjet një personi të tretë, palët kanë të drejtë të kërkojnë zgjidhje për konfliktin, duke shprehur vullnetin e tyre në marrëveshjet përkatëse, me kusht që ky i fundit të mos bjerë ndesh me ligjin. Ndërmjetësit janë të paanshëm dhe neutralë në raport me palët, por ndryshe nga gjykata nuk kanë të drejtën e vendimmarrjes apo autoritetin për t’iu imponuar zgjidhjen e ofruar prej tyre subjekteve përkatëse. Detyra e ndërmjetësit nuk është të marrë vendime, por të asistojë dhe të ofrojë mundësi për zgjidhjen e konfliktit, ndërsa kjo e fundit është në çdo rast, në dorë të palëve. Ndërmjetësi nuk mund të luajë kështu rolin e gjykatësit apo të japë drejtësi, por ka kompetencë për të ndërtuar një proces komunikimi, dialogu dhe negociimi, duke i orientuar në çdo rast palët drejt zgjidhjes më të mirë. Në rast se nuk ka dakordësi mes palëve apo marrëveshja mes tyre është e pamundur për t’u arritur, zgjidhja e vetme mbetet rruga gjyqësore.

Ndërmjetësimi ofron disa avantazhe në krahasim me shqyrtimin gjyqësor apo me arbitrazhin, sepse kursen shumë kohë. Nëse një çështje në arbitrazh trajtohet për shumë muaj apo edhe vite, kur palët shkojnë në ndërmjetësim, çështja zgjidhet brenda disa seancave, që zakonisht zgjasin jo më shumë se një muaj. Një tjetër epërsi ka të bëjë edhe me kursimin e parave, sepse në rastet e konflikteve pronësore apo kontraktore, nuk kërkohet që të ndërpritet biznesi dhe ngrirja e aseteve (siç ndodh nëse rasti shkon në gjykatë) e si rrjedhim, që biznesi të përballet me humbje të konsiderueshme. Avantazh tjetër është se nëse palët në kontratë apo marrëveshje me shkrim kanë parashikuar kushtin se ndërmjetësimi do të jetë alternativa e parë e zgjidhjes së konfliktit, para asaj gjyqësore, gjykata nuk e merr në shqyrtim çështjen pa u zbatuar ky kusht, duke shmangur në këtë mënyrë procesin gjyqësor. Për komunitetet në nevojë, ndërmjetësimi është falas.

Nga një konflikt, jo domosdoshmërisht palët mund të dalin humbëse ose fitimtare. Ekziston edhe mundësia që gjithçka të përkthehet në avantazh dhe kjo falë procesit të ndërmjetësimit. Një koncept i ri në praktikë për shoqërinë shqiptare, por që duket se po gjen më shumë terren për t'u zhvilluar. Largimi i mosmarrëveshjeve të vogla nga sallat e gjykatave është një prej synimeve themelore të Reformës në Drejtësi. Ligji për ndërmjetësimin²⁵ ka për qëllim që këto përplasje të vogla gjyqësore, deri 1 milion lekë të zgjidhen në zyrat e ndërmjetësuesve dhe jo më në gjykata.”²⁶ Ligji për ndërmjetësimin e zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve, ishte një risi për sa u përket mundësive dhe alternativave për zgjidhjen e konflikteve jashtëgjyqësisht ndërmjet palëve.

• ***Ndërmjetësimi sipas KDPM***

“Ndërmjetësim” sipas KDPM është procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogut mes të miturit që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.

Neni 64 i KDPM përcakton disa rregulla procedurale të detyrueshme të lidhura vetëm me parimet e ndërmjetësimit, si, karakteri vullnetar i procesit të ndërmjetësimit, karakteri personal i pjesëmarrjes së palëve ose parimi i realizimit detyrimisht të procesit përmes një personi të tretë siç është ndërmjetësi, duke nënkuptuar se procedura do të vlerësohet bazuar në rastin konkret, dhe ajo mund të ndikohet nga një sërë rrethanash si p.sh. nga natyra e veprës penale dhe karakteristikat personale të sjelljes së palëve, historiku i të miturit, nga mundësinë e kthimit të raporteve normale mes palëve, nga mundësia e rehabilitimit, etj.

Gjithashtu, KDPM e lidh procedurën e ndërmjetësimit, megjithëse kjo është një procedurë jashtëgjyqësore, me procedurën e hetimit apo të gjykimit dhe mundësinë e prokurorit dhe gjyqtarit për pezullimin e procesit

²⁵ Ligji Nr. 10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, ndryshuar me Ligjin nr. 81/2013, datë 14.2.2013, nr. 26/2018, datë 17.5.2018, i përditësuar. Ligji nr. 26/2018, datë 17.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 85, datë 12 qershor 2018.

²⁶ Interviste e Znj. Drita Avdyli, Revista “Monitor”, Kreu i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve Ligjorë, datë 21.12.2019, e aksesueshme në linkun <https://www.monitor.al/konfliktet-me-te-shpeshta-te-shqiptareve-qe-po-zgjidhen-me-ndermjetesim/>.

hetimor/gjyqësor në rast të kalimit drejt një procedure ndërmjetësimi. Neni 64 përcakton afatin kohor maksimal prej 45 ditësh, brenda të cilit duhet të lidhet marrëveshja dhe në të njëjtën kohë bëhet pezullimi i procedurës hetimore/gjyqësore. Me këtë përcaktim, ndërmjetësimi konsiderohet edhe si masë shmangie nga procesi penal.

KDPM përcakton edhe rrethin e personave që mund përfshihen në një procedurë ndërmjetësimi, duke specifikuar se prania e tyre në procesin e ndërmjetësimit nuk është e detyrueshme, por varet nga vullneti i të miturit të akuzuar, viktimës ose në çmimin e disa përfaqësuesve si: përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij. Megjithatë procedura e ndërmjetësimit mund të propozohet nga prokurori, gjyqtari apo punonjësi i policisë, ajo mbetet një procedurë jashtëgjyqësore, e cila realizohet nga subjekte private të licencuar si ndërmjetës nga Komisioni i Licencimit, të cilët punojnë bazuar në legjislacionin e veçantë të ndërmjetësimit²⁷ si dhe KDPM. Produkti i përgatitur apo aktmarrëveshja²⁸ e arritur nga palët i përcillet organit kompetent i cili e ka propozuar.

Si vendimi për kalimin e çështjes për ndërmjetësim (**kujdes: gjithmonë nëse palët bien dakord me propozimin e gjyqtarit apo prokurorit**) apo për vlerësimin nëse akt-marrëveshja e hartuar mes palëve është e **“arsyeshme ose e përshtatshme”**, merren nga gjyqtari ose prokurori vetëm nëse janë në interesin më të lartë të të miturit apo alternativa më e mirë për të.

Në nenet 63 dhe 64 përcaktohen një sërë kushtesh që duhet të vlerësohen nga prokurori ose gjyqtari për të arritur në përfundimin nëse ndërmjetësimi është alternativa më e përshtatshme. Këto kushte kanë të bëjnë me natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historikun e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

Pas rënies dakord mbi ndjekjen e procedurës së ndërmjetësimit, palët së bashku me ndërmjetësin nënshkruajnë një marrëveshje për mënyrën se si do të realizohet ndërmjetësimi, e cila përmban një sërë elementesh.²⁹ Sipas nenit 22 të Ligjit “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” parashikohet se akt-marrëveshja bëhet në formë të shkruar, nënshkruhet nga palët dhe ndërmjetësi, është e detyrueshme dhe duhet të ekzekutohet në të njëjtat afate kohore si vendimet e arbitrazhit.

Në aktmarrëveshje përcaktohen:

- a) palët;
- b) përshkrimi i mosmarrëveshjes;

²⁷ Ligji për Ndërmjetësimin nr. 26/2018, datë 17.05.2018 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, Fletore Zyrtare nr. 85, datë 12.06.2018.

²⁸ Çdo aktmarrëveshje duhet të hartohet në përputhje me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë

²⁹ Neni 17 i Ligjit nr. 26/2018, datë 17.05.2018 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, Fletore Zyrtare nr. 85, datë 12.06.2018.

c) detyrimet e kushtet që palët i vënë njëra-tjetrës dhe mënyra e afati i përmbushjes së tyre;

ç) nënshkrimi i palëve dhe i ndërmjetësit.

Afati për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshje vendoset nga palët në mirëkuptim me njëra-tjetrën. Aktmarrëveshja duhet të përmbajë detyrime të qarta dhe saktësisht të përcaktuara. Aktmarrëveshja lidhet me shkrim, përveç rasteve kur ndërmjetësi dhe palët vlerësojnë se ajo mund të lidhet me gojë, nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, si dhe kur ligji nuk e ndalon një gjë të tillë. Aktmarrëveshja hartohet në tri kopje, një për secilën palë dhe një kopje që depozitohet te subjekti ndërmjetës, i cili është i detyruar të administrojë çdo aktmarrëveshje dhe dokumentacion lidhur me to, sipas rregullave të përcaktuara nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve. *Në rastin kur çështja është referuar nga prokurori ose gjykata, ndërmjetësi, brenda afatit të përcaktuar, i njofton ata për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes, duke dërguar edhe aktet përkatëse.*

Marrëveshja e ndërmjetësimit duhet të përmbajë të gjithë elementet e mësipërm të parashikuar në Ligjin e Ndërmjetësimit si dhe në *Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 7641, datë 5.07.2018, "Për përcaktimin e elementëve të Marrëveshjes e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimit".*³⁰

Zgjidhja me ndërmjetësim ofron një sërë avantazhesh për të miturin në konflikt me ligjin, si p.sh.:

i pushon ndjekja penale;

ii pushon hetimi;

iii i mituri konsiderohet i padënuar;

iv sigurohet asgjësimi i të dhënave të gjendjes penale/gjyqësore;

v sigurohet rehabilitimi dhe rishoqërimi i të miturit;

vi sigurohet zhdëmtimi i viktimës;

vii përmirësohen marrëdhëniet midis të akuzuarit dhe viktimës.

• **Shmangia krahasuar me drejtësinë restauruese**

Edhe nëse ka ngjashmëri mes drejtësisë restauruese dhe shmangies, ato nuk mbulojnë saktësisht të njëjtën gjë. Drejtësia restauruese mund të organizohet ose në kuadër të një procedure gjyqësore ose të një skeme shmangieje. Shmangia mund të marrë shumë forma, ndryshe nga drejtësia restauruese. Megjithëse shmangia mund të ketë efekte restauruese apo të mirëqenies, ajo jo dosmodoshmërisht "korrigjon dëmin e shkaktuar" si p.sh. "paralajmërimi" mund të përdoret si metodë shmangia gjithashtu.

³⁰ http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/Urdher_percaktimi-i-elementeve-te-marreveshjes-per-zbatimin-e-mases-se-shmangies_ndermjetesimit_KDPM.pdf.

Programet e shmangies janë alternativa ndaj fillimit ose vazhdimit të procedimit formal të të rinjve në sistemin e drejtësisë për të mitur. Ajo synon t'i ridrejtojë të rinjtë larg procedimit formal ose të minimizojë përfshirjen e të rinjve në sistemin e drejtësisë për të mitur, duke i mbajtur ata në të njëjtën kohë përgjegjës për veprimet e tyre. Programet e shmangies shërbejnë si mundësi për të korrigjuar sjelljet antisociale të të rinjve më shumë me ndihmën e familjeve të tyre dhe komunitetit, sesa nëpërmjet sistemit të drejtësisë.

Për këtë qëllim, KDPM ka parashikuar *që masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësi e parë nga organi kompetent, pra shmangia alternative e parë, ndërsa burgimi alternative e fundit. Vlerësimi i organit kompetent mban parasysh se këto masa i shërbejnë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal. Në çdo vendimmarrje në lidhje me të miturin, merren në konsideratë rrethanat individuale të tilla si: mosha, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat lejojnë vlerësimin individual. Gjykata dhe/ose prokurori, përpara marrjes së ndonjë vendimi mbi të miturin, thërret, sipas rastit, një ekspert ose grup ekspertësh të disiplinave të ndryshme për vlerësimin e rrethanave individuale, shëndetësore, familjare, sociale dhe mjedisore të të miturit në mënyrë që të kuptojë personalitetin, përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Prokurori/gjykata në procesin e vlerësimit të të miturit mbështetet në nivelin e zhvillimit, mënyrën e jetesës, edukimin dhe kushtet e zhvillimit, arsimimin, gjendjen shëndetësore, mjedisin familjar dhe kushtet e tjera të të miturit, të cilat e lejojnë për të vlerësuar karakteristikat e personalitetit të të miturit, të sjelljes dhe të nevojave të tij, përfshirë edhe nevojat e veçanta. Në raportin e vlerësimit individual pasqyrohen karakteristikat individuale të të miturit, të parashikuara në nenin 22 të KDPM. Raporti i vlerësimit individual përshkruan nevojat e veçanta të të miturit, rrezikun e kryerjes së veprës penale, si dhe elemente të tjera në varësi të rastit dhe rekomandon masat e duhura për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e tij në shoqëri. Prokurori/gjykata kërkojnë në mënyrë të detyrueshme përgatitjen dhe mbajtjen parasysh të raportit të vlerësimit individual kur:*

- a)** përcaktohet masa alternative e shmangies;
- b)** caktohet lloji i dënimit;
- c)** ekzekutohet vendimi i dënimit; si dhe
- ç)** shqyrtohet kërkesa për lirimin me kusht.

Prokurori/gjykata bën kujdes që afati i përgatitjes së raportit të mos bëhet pengesë për ecurinë dhe afatet e çështjes penale konkrete. Në fazat e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b", raporti i vlerësimit individual përgatitet nga eksperti/grupi i ekspertëve ose nga Shërbimi i Provës, sipas parashikimeve të nenit 22 të KDPM. Në rastet e parashikuara nga shkronjat "c" dhe "ç", ky raport përgatitet nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) për të miturit dhe/ose Shërbimi i Provës. Sipas rastit, organet e mësipërme, në

përgatitjen e raportit të vlerësimit individual marrin edhe mendimin e Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Gjatë kryerjes së vlerësimit individual të të miturit, eksperti ose grupi i ekspertëve, përfaqësuesi i Shërbimit të Provës, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale ose, sipas rastit, Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, takohet lirisht me të pandehurin e mitur dhe merr të gjithë informacionin e nevojshëm nga çdo person fizik ose/dhe juridik publik ose/dhe privat që e konsideron si ndihmës në këtë proces.

Në nenin 55, pika 3, është përcaktuar një listë me kritere specifike me vërtetimin e të cilëve, organi kompetent aplikon automatikisht zbatimin e masës së shmangies:

- ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një veprë penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë;
- i mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
- i mituri nuk është kallëzuar për kryerjen e një veprë penale ose nuk është përsëritës;
- i mituri dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural japin pëlqimin me shkrim për zbatimin e shmangies;
- i mituri nuk ka marrë pjesë më parë në një program ku të jetë zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose e ndërmjetësimit;
- dënimi i të miturit për ato vepra nuk i shërben korigjimit të sjelljes së tij;
- nuk ka një interes publik për fillimin e ndjekjes penale ose vazhdimin e ndjekjes penale të filluar.

Para zbatimit të vendimit për masën e shmangies nga ndjekja penale, i mituri, mbrojtësi i tij dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor kanë të drejtë të kenë informacion të detajuar mbi thelbin e masës së shmangies nga ndjekja penale, kohëzgjatjen e saj, kushtet dhe mënyrën e zbatimit, si dhe pasojat për mospërbushjen e masave të shmangies.

Në mënyrë ideale, shmangia ndodh në fazat më të hershme të procedimit penal të të miturit për të parandaluar përfshirjen e mëtejshme në sistem. Megjithatë, mekanizmat e shmangies, mund të iniciohen edhe në fazat e mëvonshme për të parandaluar përfshirjen e mëtejshme në sistem dhe zgjidhjet e kushtueshme duke e çuar atë larg shtëpisë. Të miturit mund të shmangen nga strukturat ligjzbatuese para arrestimit, gjatë procedurës së pranimit të gjykatës, apo edhe pas gjykimit, por *gjithmonë* para dhënies së vendimit nga gjykata. Në varësi të momentit gjatë të cilit shmangen të rinjtë, një program shmangieje mund të përfshijë lirim të plotë me shërbime minimale, duke ia referuar një agjencie komunitare për ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve.³¹

³⁰Hulumtimi i bërë për shmangien ka prodhuar rezultate të përziera. Është e qartë se ka probleme që lidhen me shmangien të cilat duhen marrë parasysh para zbatimit të saj dhe programet ekzistuese duhet të vlerësohen me kujdes për të vlerësuar shkallën në të cilën ato përmbushin qëllimet dhe objektivat e tyre. Megjithatë, shmangia, përmban premtimin e një mekanizmi efektiv për të ndihmuar disa të rinj që të shmangin procedimin në drejtësinë për të mitur, duke kursyer burimet e pakta të gjykatave për të mitur dhe duke reduktuar recidivizmin mes pjesëmarrësve të programit.

Kush e propozon shmangien si alternative nga procesi gjyqësor?

- **Prokurori** mund të vendosë me iniciativën e tij zbatimin e masës së shmangies deri në momentin para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes. **Në këtë rast prokurori duhet të informojë të miturin/mbrojtësin e tij për përparësitë e shmangies dhe programet e drejtësisë restauruese.** Nëse i mituri e pranon shmangien me ndërmjetësim, atëherë prokurori reflekton në procesverbal pëlqimin (i cili kërkohet në formë të shkruar si nga i mituri dhe kur është e përshtatshme edhe nga mbrojtësi i tij) dhe njofton ndërmjetësin ose në rast të kundërt shënon mospranimin e të miturit dhe vazhdimin e procesit. Zbatimi i masës nga prokurori sjell mosfillimin e çështjes penale ose pushimin e saj nëse ajo është filluar. Ai i njofton këtë vendim mbrojtësit të të miturit, përfaqësuesit ligjor/procedural, viktimës, drejtuesit të prokurorisë si dhe lidh marrëveshje me të miturin sa i takon llojit të masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimit, bazuar në vlerësimin individual të të miturit dhe në vlerësimin e kriterëve specifike për aplikimin e masave të shmangies;
- Rasti më i mirë do të ishte që **i mituri** të jetë ndërgjegjësuar nga avokati i tij apo prindi mbi përparësitë e programeve restauruese apo ndërmjetësimit dhe të kërkojë vetë zbatimin e shmangies. Në bazë të kërkesës së të miturit/mbrojtësit, prokurori vendos për zbatimin ose jo të masës së shmangies me vendim të arsyetuar. Në rast të refuzimit nga prokurori, **i mituri ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë që të kërkojë në gjykatë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e refuzimit, zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale;**
- **Gjyqtari** kryesisht ose me kërkesë të arsyetuar të të miturit/mbrojtësit, psikologut, punonjësit social vendos pasi dëgjon të miturin dhe merr pëlqimin e tij, t'ia kthejë çështjen prokurorit për të proceduar me zbatimin e masës së shmangies apo zbatimin e masës së shmangies në fazën e gjykimit përpara marrjes së vendimit.

Bazuar në nenin 61 të KDPM, prokurori mund të pezullojë hetimin, me qëllim zbatimin me kusht të masës së shmangies nëse i mituri kërkon dhe garanton përmbushjen e detyrimeve të tilla si:

- a) riparimi ose kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale, sipas aftësive të tij dhe sipas rastit;
- b) përfshirja në programe të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- c) përfshirja në punët e një organizate humanitare ose në veprimtaritë e komunitetit ose të mbrojtjes së mjedisit;
- ç) trajtimi prej varësisë nga droga ose varësive të tjera.

Nëse i mituri i përmbush këto detyrime, sipas marrëveshjes së shmangies, prokurori vendos menjëherë pushimin nga ndjekja penale. I mituri nuk konsiderohet si i dënuar për një vepër penale dhe nuk do të trajtohet si person me të kaluar kriminale. Monitorimi i zbatimit të masës së shmangies nga ndjekja penale kryhet nga

Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me shërbimin e ndërmjetësimit. Në rast *mospërmbushjeje* me qëllim të masës së shmangies nga i mituri, prokurori organizon seancë të veçantë dëgjimore me të miturin, ku ky i fundit duhet të shpjegojë arsyet e mospërmbushjes së masës, dhe nëse e çmon të nevojshme kërkon një vlerësim të ri individual, kontakton përfaqësuesin e tij ligjor dhe pasi dëgjon punonjësën e Shërbimit të Provës mund të vendosë:

- revokimin ose lënien në fuqi të vendimit për shmangien nga ndjekja penale;
- ndryshimin e llojit të masës së shmangies;
- zgjatjen e kohës së marrëveshjes.

Në rast të revokimit të vendimit për shmangie, prokurori, me vendim të arsyetuar, vendos të shfuqizojë vendimin për mosfillimin e hetimit ose të vendimit të pushimit të çështjes së filluar dhe të vendosë rifillimin e hetimit.

Kujdes: *Pranimi i përgjegjësisë për një vepër penale, në kuadër të zbatimit të masës së shmangies nga ndjekja penale, nuk mund të përdoret kundër të miturit gjatë gjyqimit.*

Një rast tjetër i shmangies nga ndjekja penale mund të realizohet nëpërmjet ndërmjetësimit familjar dhe në grup bazuar në nenin 63, pika 6 të KDPM, në të cilin marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin, edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit tek të miturit. Në këtë proces, i akuzuari dhe familja e tij duhet të arrijnë një marrëveshje me viktimën, që përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë të akuzuarin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen. Bazuar në përcaktimin e këtij neni, ndërmjetësimi familjar mund të jetë në të njëjtën kohë edhe ndërmjetësim në grup, ku në përbërjen e secilës prej palëve janë dy ose më shumë përfaqësues nga familja e viktimës dhe nga familja e të akuzuarit të mitur. Nga ana tjetër, mjafton që në njërin nga palët të ketë më shumë se dy persona, dhe ndërmjetësimi do të konsiderohet në grup. *Ndërmjetësimi në grup* ka lidhje me çështjet penale në të cilat janë përfshirë dy ose më shumë të akuzuar dhe/ose më shumë se dy viktima, të cilët bashkohen të gjithë në të njëjtën procedurë ndërmjetësimi.

Sipas pikës 6 të nenit 63, në procesin e ndërmjetësimit krahas palëve dhe familjarëve të tyre, mund të ftohen edhe persona të tjerë, të cilët janë përmendur më lart, si p.sh., mbrojtësit, përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, e të tjerë. Pika 6 e këtij neni nuk përshkruan rolin e secilit prej tyre apo rastet kur mund të përdoren këta persona, por nisur nga roli i tyre në asistimin e të miturit dhe mbrojtjen e interesave më të larta të tij, mendohet se angazhimi i tyre nga palët do të varet nga rasti konkret dhe/ose karakteristikat e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe atyre viktima. Pavarësisht rastit apo personave që mund të ftohen për të marrë pjesë në këtë procedurë ndërmjetësimi, roli i mbrojtësit është thelbësor, në ofrimin e informacionit të saktë ligjor dhe çdo informacioni tjetër, lidhur me

marrëveshjen që do të hartohet dhe procesin e negociimit dhe nënshkrimit të saj edhe nga mbrojtësi. Procedura e ndërmjetësimit nuk ka lidhje me procedurën gjyqësore dhe në këtë mënyrë zhvillohet jashtë ambienteve të prokurorisë dhe gjykatës, e bazuar në rregullat dhe parimet bazë të ndërmjetësimit, të tilla si: palët të respektojnë njëri-tjetrin; të flasim me radhë dhe të mos ndërpresin njëri-tjetrin; të adresojnë problemin dhe të mos fokusohen tek fajti; të mos fyejnë pjesëmarrësit e tjerë; etj. (Diskutimi në familje dhe në grup është trajtuar më poshtë në seksionin e modeleve të drejtësisë restauruese – 3.6).

Të gjitha alternativat për procedimet gjyqësore të tilla si, ndërmjetësimi, shmangia nga ndjekja penale dhe zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve të trajtuara më lart, duhet të inkurajohet sa herë që këto mund t'i shërbejnë më së miri interesave më të larta të fëmijës. Përdorimi paraprak i alternativave të tilla nuk duhet të përdoret për të penguar aksesin e fëmijës në drejtësi.

Fëmijët duhen informuar dhe këshilluar me hollësi për mundësitë që kanë për të kundërshtuar si procedurat gjyqësore ashtu edhe alternativat jashtë mekanizmave të gjykatës. Ky informacion duhet të shpjegojë gjithashtu, edhe pasojat e mundshme për secilin opsion. Bazuar në informacionin e duhur, si ligjor ashtu edhe çdo informacion tjetër, fëmijës duhet t'i vihet në dispozicion zgjedhja për të përdorur ose procedurat gjyqësore ose ato alternativa që mund të ekzistojnë jashtë këtyre procedurave. Fëmijëve duhet t'u jepet mundësia për të marrë këshilla ligjore dhe asistencë tjetër profesionale në përcaktimin e përshtatshmërisë dhe dëshirueshmërisë për alternativat e propozuara, dhe për këtë qëllim vjen në ndihmë qasja shumëdisiplinore e parashikuar në KDPM. Në marrjen e vendimit, opinioni i fëmijës duhet të merret parasysh në të njëjtën shkallë, si në procedimet brenda, ashtu dhe në ato jashtë gjykatës.³²

3.4.3 Disa modele të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit

Model I : Ndërmjetësimi viktimë – kundërvajtës³³

- Ndërmjetësimi viktimë – kundërvajtës është një model që përdoret gjerësisht në Kanada, SHBA, si dhe në mjaft vende të tjera të Evropës.
- Zakonisht përdoret në raste të lehta kundërvajtjesh dhe sidomos kur kundërvajtësit janë të mitur. Megjithatë, kohët e fundit modeli po përdoret edhe në raste të tjera më të rënda dhe kur kundërvajtësit janë të rritur.
- Ky shërbim ofrohet jo vetëm si alternativë ndaj procesit penal, por edhe kur kundërvajtësi e ka marrë dënimin, por kërkon të ndreqë marrëdhënien me viktimën dhe familjarët e tij.

³² HKomenti i Përgjithshëm Nr. 12, I Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës.

³³ Zenelaga., Brunilda, "Prezantim mbi vlerat e drejtësisë restauruese në rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin – raste studimore".

- Qëllimi kryesor i procesit të ndërmjetësimit viktimë - kundërvajtës është të vendosë paqen mes viktimës dhe të afërmeve të tij dhe kundërvajtësit dhe të afërmeve të tij, prandaj ky proces përqendrohet tek vetë palët e përfshira në marrëdhënie konfliktuale.
- Në këtë model kërkohet që, si kundërvajtësi ashtu edhe viktimja, së pari, të njohin rolet përkatëse në konflikt dhe të pranojnë vullnetarisht të marrin pjesë në proces.

Model II: Diskutimi në familje dhe në grup³⁴

- Diskutimi në grup është një model i drejtësisë restauruese, që mbështetet në mjetet tradicionale të zgjidhjes së konflikteve. Ky model e ka origjinën në traditën e maorëve në Zelandën e Re. Praktikën tradicionale të diskutimit të maorëve mbështeteshin në konceptin e përgjegjësisë kolektive si për marrjen e vendimit për ndëshkimin e fajtorit, ashtu dhe për marrjen e masave të duhura për të ndrequr situatën. Më pas, ky model u mor dhe u përdor në mënyrë të përshtatur në Australi, Brazil, Kanada, Peru, Filipine, Tailandë, Afrikën e Jugut dhe SHBA.
- Modeli i diskutimit në grup është zbatuar edhe në shumë vende të tjera, dhe pavarësisht se ai i është përshtatur kulturës së këtyre vendeve, ka disa tipare që mbeten të përbashkëta dhe përdoren në të gjitha kulturat.
- Duke e vënë theksin tek përgjegjësia kolektive dhe drejtësia, diskutimi në grup nxit forcën e komunitetit, vlerëson përvojën dhe burimet e tij, jo vetëm për të zgjidhur konfliktet, por gjithashtu për të marrë në konsideratë faktorët (si për shembull, abuzimi dhe neglizhenca ndaj fëmijëve) që ndikojnë në kryerjen e akteve të rrugaçerisë, kundërvajtjeve, etj.
- Qëllimi i diskutimit në grup është t'i aftësojë palët të marrin përgjegjësi kolektive për kundërvajtjen dhe për zgjidhjen e pasojave të saj. Ky lloj diskutimi organizohet dhe drejtohet nga një ndërmjetës i trajnuar, i cili fton palët dhe të gjithë ata që ndikohen nga situata dhe ngjarja konfliktuale.
- Zakonisht në një proces të tillë përfshihen viktimja, kundërvajtësi dhe familjet e tyre dhe/ose dhe persona mbështetës që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e konfliktit, për shembull, oficerë të policisë dhe punonjës socialë, ose në rastin e një konflikti në shkollë, mund të ftohet mësuesi ose mësuesja, psikologu i shkollës, shokë të viktimës ose kundërvajtësit, etj.

³⁴ Si më sipër.

Model III: Rrethi i paqes³⁵

- Rrethi i paqes e ka origjinën nga mënyrat tradicionale të zgjidhjes së konflikteve të praktikuara nga popujt indigjenë në Kanada dhe SHBA. Ai mbështetet “jo vetëm në konceptin e faljes reciproke, por edhe në përgjegjësinë që ka çdo anëtar i komunitetit për të falur”.
- Varianti modern i rrethit të paqes është një ndërthurje e ritualeve të drejtësisë tradicionale me procedurat formale të drejtësisë penale. Zakonisht në rrethin e paqes marrin pjesë: kundërvajtësi, viktima, anëtarët e komuniteteve përkatëse, personeli i gjykatës, prokurorisë, avokati, policia dhe çdo anëtar tjetër nga komuniteti që ka interes në këtë rast.
- Rrethi prezantohet nga gjykatësi, i cili merr pjesë në të si një anëtar i barabartë me të tjerët. Anëtarët e rrethit hartojnë së bashku një plan gjykimi që merr parasysh nevojat e secilës palë. Ky plan më pas i bashkëngjitet formalisht gjykimit të gjykatës.
- Rrethi i paqes është përdorur në rastet e kundërvajtjeve të kryera nga fëmijët dhe të rriturit, si në zonat urbane dhe në ato rurale, si dhe është përdorur si në rastet e kundërvajtjeve serioze dhe atyre më pak serioze.
- Në një rreth, të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht nga mosha, gjinia, statusi dhe përvoja që kanë, konsiderohen me rëndësi të barabartë dhe u dëgjohet zëri njëjloj si çdo anëtari tjetër të rrethit.
- Rrethi është gjithëpërfshirës, e madje dhe ai që e drejton rrethin (moderatori), përveç drejtimit, merr edhe pjesë në rreth. Rrethet synojnë të nxjerrin në pah vlerat shpirtërore të pjesëmarrësve, të nxisin konsensusin dhe bashkëpunimin, dhe të përdorin mençurinë dhe përvojën e grupit.

Model IV: Projekti me shkrim, Belgjikë

Belgjika është vendi i parë ku u zbatua drejtësia restauruese në kuptimin e drejtësisë miqësore për fëmijët, kryesisht e fokusuar në ndërmjetësimin. Vetëm pas vitit 2006, është përcaktuar korniza e detajuar ligjore e zbatimit të masave alternative nga procedimi penal. Gjithashtu, në këtë vend ka filluar të aplikohet një “ofertë e re restauruese” nëpërmjet *projektit me shkrim*, i cili hartohet nga autori i veprës penale dhe zakonisht përmban: faljen, ndërmjetësimin familjar ose në grup, riparimin/kompensimin e dëmit material dhe jo-material, pjesëmarrjen në veprimtari të caktuara si p.sh. në spitale, etj, apo përfshirjen në aktivitetet e të rinjve. Elementi novator i këtij projekti qëndron në faktin e përfshirjes së drejtpërdrejtë të të miturit në konflikt me ligjin, duke nxitur kreativitetin e tij dhe pendesën e sinqertë. Projekti miratohet nga gjykata dhe zbatimi i tij monitorohet nga shërbimet sociale.³⁶

³⁵ Punimi i cituar në referencën nr. 35.

³⁶ National Research Report Terre des Hommes Hungary, 2018, Alternative Ways to Address Youth, Away Project, Diversion in the Hungarian Juvenile Justice System, AWAY Project, fq. 17.

3.4.4 Instrumentet ndërkombëtare – e drejta për masa të shmangjes dhe ndërhyrjeve në një proces gjyqësor

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

Neni 40/3: Shtetet Palë përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, autoriteteve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që cilësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti: ...

(b) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore.

Komenti i Përgjithshëm nr. 10

23 Fëmijët në konflikt me ligjin, duke përfshirë fëmijët recidivistë, kanë të drejtën të trajtohen në mënyra të tilla, që nxisin riintegrimin e tyre dhe marrjen e një roli konstruktiv në shoqëri. (Neni 40 (1) i KDF). Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër. (Neni 37 (b)). Prandaj, si pjesë e një politike gjithëpërfshirëse të drejtësisë për të rinjtë, është e domosdoshme të zhvillohen dhe të zbatohen një gamë e gjerë masash për të siguruar që fëmijët të trajtohen në një mënyrë të përshtatshme me mirëqenien e tyre, dhe në proporcion si me rrethanat e tyre ashtu dhe me veprën penale të kryer. Këto duhet të përfshijnë kujdesin, udhëzimin dhe mbikëqyrjen, këshillimin, periudhën e provës, kujdesin në familje, programet e arsimit dhe formimit profesional, si dhe zgjidhje të tjera alternative përveç kujdesit institucional (Neni 40 (4)).

Komenti i Përgjithshëm nr. 12

Mbi të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar, "Dhënia e miratimit me vullnet të lirë dhe pas marrjes së informacionit të nevojshëm mbi alternativën e propozuar nga avokati".

Ndërhyrje pa kaluar në procesin gjyqësor

24 Sipas nenit 40, pika 3 të KDF-së, shtetet palë do të përpiqen të promovojnë masat për trajtimin e fëmijëve që dyshohen, akuzohen ose që cilësohen se kanë shkelur ligjin penal, pa u mbështetur në procedimet penale, çdo herë që është e përshtatshme dhe e dëshirueshme. Duke pasur parasysh faktin se shumica e shkelësve fëmijë kryejnë vetëm kundërvajtje penale, një sërë masash që përfshijnë shmangien nga procedimi penal/procedimi penal për të mitur dhe referimin në shërbime alternative (sociale) (domethënë shmangien), duhet të kthehen në një praktikë të konsoliduar që mund dhe duhet të përdoret në shumicën e rasteve.

27 - Shmangia (d.m.th. masat për trajtimin e fëmijëve, që dyshohen, akuzohen ose që cilësohen se kanë shkelur ligjin penal pa përdorur procedimin penal) duhet të përdoret vetëm kur ka prova bindëse se fëmija ka kryer veprën e pretenduar, kur ai/ajo pranon lirisht dhe vullnetarisht përgjegjësinë, dhe kur asnjë kërcënim ose presion nuk është përdorur për të siguruar pranimin e fajësisë dhe, më në fund, se pranimi i fajësisë nuk do të përdoret kundër tij në asnjë procedim penal të mëvonshëm.

28 ... Në të njëjtën kohë, sistemi i drejtësisë për të rinj duhet të garantojë mundësi të bollshme për trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, përmes përdorimit të masave sociale dhe/ose edukuese dhe të kufizojë rreptësisht përdorimin e kufizimit të lirisë, dhe në veçanti të paraburgimit, vetëm si masë e fundit. Në fazën e përcaktimit të masës së dënimit, të procedurës gjyqësore, kufizimi i lirisë duhet të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër. (Neni 37 (b)). Kjo do të thotë se shtetet palë duhet të kenë të ngritur një shërbim prove të mirëtrajnuar

Rregullat e Pekinit

11. Shmangia

11.1 Duhet të merret në konsideratë, kurdoherë që është e mundshme, që shkelësit e rinj të trajtohen pa përdorimin e gjykimit formal nga autoritetet kompetente, siç parashikohet në rregullin 14.1 më poshtë.

11.2 Policia, prokuroria ose organet e tjera që merren me çështjet e të rinjve duhet të kenë të drejtën të mbyllin çështje të tilla, në diskrecionin e tyre, pa zhvilluar seanca formale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për këtë qëllim, në sistemin ligjor përkatës dhe gjithashtu, në përputhje me parimet e shprehura në këto Rregulla.

11.3 Çdo shmangie që përfshin referimin në komunitetin apo shërbime të tjera të përshtatshme, do të kërkojë miratimin e të riut, të prindit ose kujdestarit të tij ose të saj, me kusht që një vendim i tillë për referimin e çështjes të shqyrtohet nga një organ kompetent, mbi bazën e kërkesës.

Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi drejtësinë miqësore për fëmijët:

1. Fëmijët duhet të informohen gjerësisht dhe të konsultohen mbi mundësinë për të pasur akses në një procedurë gjyqësore apo një alternativë jashtëgjyqësore. Gjithashtu, ata duhet të informohen mbi pasojat e mundshme të zgjedhjes së tyre. Bazuar në informacionin e përshtatshëm ligjor ose jo, fëmijëve duhet t'iu sigurohet e drejta të zgjedhin ndërmjet procedurës gjyqësore ose alternativave të tij nëse këto të fundit ekzistojnë.

3. Fëmijët duhet të sigurohen që të japin miratimin e tyre të lirë dhe të informuar si dhe të përfitojnë këshillim ligjor apo çdo lloj asistence tjetër në përcaktimin e përshtatshmërisë dhe dëshirueshmërisë së masës alternative të propozuar

Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët

24. Alternativat ndaj procedimeve gjyqësore të tilla si, ndërmjetësimi, shmangia (e mekanizmave gjyqësorë) dhe zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve duhet të inkurajohen sa herë që këto mund t'i shërbejnë më së miri interesave më të larta të fëmijës. Përdorimi paraprak i alternativave të tilla nuk duhet të përdoret për të penguar aksesin e fëmijës në drejtësi.

25. Fëmijët duhen informuar dhe këshilluar me hollësi për mundësinë për t'iu drejtuar ose procedimeve gjyqësore ose alternativave jashtë kuadrit gjyqësor. Ky informacion duhet të shpjegojë gjithashtu, edhe pasojat e mundshme të secilit opsion. Bazuar në informacionin e duhur, si ligjor apo çdo informacion tjetër, fëmijës duhet t'i vihet në dispozicion zgjedhja për të përdorur ose procedurat gjyqësore ose ato alternative jashtë këtyre procedurave, sa herë që këto ekzistojnë. Fëmijëve duhet t'i jepet mundësia për të marrë këshilla ligjore dhe ndihmesë tjetër në përcaktimin e përshtatshmërisë dhe dëshirueshmërisë së alternativave të propozuara. Në marrjen e vendimit, duhet të vlerësohen pikëpamjet e fëmijës.

26. Alternativat jashtë procedurave gjyqësore duhet të garantojnë një nivel të barasvlershëm të garancive ligjore. Respektimi i të drejtave të fëmijëve siç përshkruhet në këto udhëzime dhe në të gjitha instrumentet ligjore relevante për të drejtat e fëmijës, duhet të garantohen në të njëjtën shkallë si në procedurat gjyqësore ashtu dhe në ato jashtëgjyqësore.



Memorandumi Shpjegues i Udhëzimeve të Komitetit të Ministrave për Këshillin e Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët

80. Në përgjithësi, një përjasje parandaluese dhe riintegruese duhet të promovohet dhe të zbatohet në çështjet e drejtësisë për të mitur. Sistemi i drejtësisë penale nuk duhet të vihet në lëvizje në mënyrë automatike nga kundërvajtje të vogla të kryera nga fëmijë, kur masa më konstruktive dhe më edukative mund të jenë më të suksesshme. Për më tepër, shtetet anëtare duhet të reagojnë ndaj veprave penale në proporcion jo vetëm me rrethanat dhe peshën e veprës penale, por gjithashtu, edhe me moshën, fajësinë më të vogël dhe me nevojat e fëmijës, dhe me nevojat e shoqërisë.

81. Udhëzimet 24 deri 26 rikujtojnë faktin që në disa shtete anëtare vëmendja është fokusuar tek zgjidhja e konflikteve jashtë gjykatave, ndër të tjera, përmes ndërmjetësimit të familjes, shmangies dhe drejtësisë

restauruese. Ky është një zhvillim pozitiv dhe shtetet anëtare inkurajohen që të sigurojnë që fëmijët të mund të përfitojnë nga këto procedura, me kusht që ato të mos përdoren për të penguar aksesin e fëmijëve në drejtësi.

82. Praktika të tilla tashmë ekzistojnë në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës dhe mund t'i referohen praktikave para, gjatë dhe pas procedurave gjyqësore. Ato bëhen veçanërisht relevante në fushën e drejtësisë për të rinj. Këto udhëzime nuk i japin përparësi asnjë prej alternativave jo-gjyqësore dhe duhet të zbatohen brenda tyre, veçanërisht në konfliktet familjare, të cilat nuk përfshijnë vetëm çështje rreptësisht ligjore. Ligji ka kufizimet e tij në këtë fushë dhe mund të ketë efekte të dëmshme në një perspektivë afatgjatë. Marrëveshjet e ndërmjetësuara raportohen të jenë më të respektuara, sepse palët e interesuara përfshihen në mënyrë më aktive. Edhe fëmijët mund të jenë në gjendje të luajnë një rol tek to. Gjithashtu, mund të konsiderohet edhe referimi i detyrueshëm tek shërbimet e ndërmjetësimit, para procedurave gjyqësore: kjo nuk është për t'i detyruar njerëzit që të përdorin ndërmjetësimin (që do të ishte në kundërshtim me të gjithë idenë e ndërmjetësimit), por për t'u dhënë të gjithëve mundësinë për të qenë të vetëdijshëm për një mundësi të tillë.

83. Pavarësisht se ekziston një bindje e caktuar se fëmijët duhet të mbahen jashtë gjykatave sa më shumë që të jetë e mundur, procedura gjyqësore nuk është domosdoshmërisht më e keqe se një alternativë jashtëgjyqësore, për aq kohë sa ajo është në përputhje me parimet e drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve. Ashtu si në kuadrin e gjykatave, edhe alternativat mund të përfshijnë rreziqe në lidhje me të drejtat e fëmijëve, të tilla si, rreziku i respektimit më të ulët të parimeve themelore si prezumimi i pafajësisë, e drejta për këshillim ligjor, etj. Prandaj, zgjedhjet e mundshme duhet të marrin parasysh cilësinë specifike të sistemit në fjalë.

84. Në Komentin e Përgjithshëm Nr. 12, Komiteti i Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës rekomandoi që: "Në rastin e shmangies, duke përfshirë ndërmjetësimin, një fëmijë duhet të ketë mundësinë të japë pëlqimin e lirë dhe me vullnet të lirë dhe duhet t'i jepet mundësia për të marrë këshillë ligjore dhe këshilla të tjera dhe ndihmë në përcaktimin e përshtatshmërisë dhe dëshirueshmërisë së shmangies së propozuar". Megjithatë, Udhëzimi 26, kërkon që fëmijëve t'u garantohen nivele të barasvlershme të garancive si në procedurat gjyqësore ashtu dhe ato jashtëgjyqësore.

85. Për ta përmbledhur, teksti i udhëzimeve inkurajon aksesin tek gjykatat kombëtare për fëmijët si bartës të të drejtave, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, tek e cila ata kanë akses nëse dëshirojnë. Megjithatë, ky akses peshohet dhe krahasohet me alternativat jashtë procedurave gjyqësore.

3.4.4 Ushtrime mbi temën II të modulit të trajnimit

Ushtrim 1: Dalloni ndryshimin ndërmjet procedurave gjyqësore dhe atyre jo-gjyqësore

Trajnerët u bëjnë pjesëmarrësve pyetje dhe mbledhin përgjigjet e tyre:

- i Nga ndryshojnë procedurat gjyqësore nga ato jo-gjyqësore dhe pse është e rëndësishme të mbahen fëmijët sa më larg proceseve gjyqësore?*
- ii Cili është roli i mbrojtësit të specializuar për të miturit sipas KDPM dhe veçanërisht në procedurat alternative si ndërmjetësimi, shmangia dhe drejtësia restauruese?*

Trajnerët duhet të drejtojnë argumentet e pjesëmarrësve drejt avantazheve të aplikimit të drejtësisë restauruese, ndërmjetësimit apo shmangies, mundësisht prej fillimit të procesit, dhe më tej të shpërndajnë shembujt e mëposhtëm për të ilustruar qëllimin e këtyre ushtrimeve që konsistojnë në ndërgjegjësimin e avokatëve për të mitur mbi këto alternativa, të cilat duhet të vlerësohen si opsion i parë në hetimin dhe gjykimin e çështjeve të të miturve në konflikt me ligjin.

Megjithatë, trajnerët duhet të theksojnë se në rast të aplikimit të masës së shmangies, duke përfshirë ndërmjetësimin, një fëmijë duhet të ketë mundësinë të japë pëlqimin e lirë dhe me vullnet të lirë dhe duhet t'i jepet mundësia për të marrë këshilla ligjore dhe këshilla të tjera dhe ndihmë në përcaktimin e përshtatshmërisë dhe dëshirueshmërisë së shmangies së propozuar.

Trajnerët duhet t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë edhe rëndësisë së të drejtës së kryerjes së vlerësimit individual të të miturit, i cili në KDPM është konceptuar më tepër si një procedurë sesa një e drejtë siç është realisht bazuar në standardet dhe legjislacionin evropian. Vlerësimi individual ka një rëndësi parësore në aplikimin e alternativave ndaj ndjekjes penale si ndërmjetësimi, shmangia apo drejtësia restauruese dhe për këtë qëllim, avokati duhet të njohë mirë këtë të drejtë dhe procedurën e përcaktuar, e cila në disa raste është e detyrueshme, siç përcaktohet në nenin 47 të KDPM.

Ushtrim 2: Trajnerët u shpërndajnë pjesëmarrësve dy variantet e mëposhtme dhe kërkojnë prej tyre argumentet pro dhe kundër:

Arbeni kryen një krim. Ai është arrestuar dhe marrë në pyetje nga policia që më pas thirri prokurorin. Prokurori vendosi që ai duhet të paraqitet në Gjykatë. Gjykatësi "e dënon" dhe e dërgon në një qendër të mbyllur për disa muaj. Atje, ai është i ndarë nga familja e tij, takon shkelës të tjerë të rinj dhe humbet shkollën. Ai është etiketuar si "shkelës i ri" dhe ka një dosje penale, e cila do ta bëjë më të vështirë që ai të kthehet në shkollë dhe të gjejë një punë.

Arbeni kryen një krim. Ai është arrestuar dhe marrë në pyetje nga policia e cila më pas thirri prokurorin. Prokurori vendos ta dërgojë atë në një qendër e cila do të organizojë një ndërmjetësim me viktimën për të parashikuar një dëmshpërblim. Arbeni gjithashtu, takohet me një punonjës social që do ta ndihmojë atë të kuptojë se pse ai e kreu atë krim. Ai vazhdon të shkojë në shkollë, jeton në shtëpi (prindërit e tij po e kontrollojnë atë nga afër); në fund, ai propozon një mënyrë për të riparuar dëmin që i është shkaktuar zonjës në moshë.

Ushtrim 3: Më poshtë janë listuar disa dëshmi reale të fëmijëve në kontakt me sistemin e drejtësisë. Trajnerët u kërkojnë pjesëmarrësve të vlerësojnë secilin nga rastet duke iu referuar rolit të avokatit dhe aktorëve të tjerë të drejtësisë:

1 Gjykatësi më tha se më duhej një ndihmë serioze, veçanërisht me problemin e drogës. Ai donte që unë të qëndroja në një shtëpi ku qëndronin një grup njerëzish ku mund ta lija drogën dhe të kthehesha në shkollë. E di që ai ka të drejtë, por gjithsesi do të apeloj, sepse ai tha se ishte e drejta ime dhe dua të kthehem te miqtë e mi në rrugë. Por unë nuk jam edhe aq i sigurt. Sepse gjyqtari më tha se mund të më ndihmonte në lidhje me prindërit e mi birësues. Mendoj ta provoj njëherë.

2 Kur më sulmuan, mamin tim e këshilluan që të shkonte në polici bashkë me mua dhe të paraqiste një ankesë; kur shkova atje, ndjeva sikur nuk më besonin; sikur të isha fajtor për diçka; Fillova të qaj; pas kësaj, më dëgjuan edhe tre herë të tjera; dhe çdo herë mu desh që të përsëris deklaraten time, kjo gjë më lëndoi; dhe mu desh të shkoja në aq shumë vende të ndryshme për t'u takuar me një mjek, një psikolog, një punonjës social, avokatin tim, gjyqtarin; Jam shumë i lodhur.

3 Kur më arrestoi policia, menjëherë i thirrën prindërit e mi birësues, të cilët erdhën sa më shpejt që mundën (edhe pse ishin të zemëruar me mua); ata thirrën edhe një avokat, i cili erdhi; më është dhënë kohë për të diskutuar me avokatin në një mjedis privat; ai e kishte parë dosjen dhe e dinte arsyen pse policia donte të më takonte; ai më dha këshilla dhe më tregoi se çfarë mund të ndodhte; gjatë marrjes në pyetje nga policia, ai qëndroi me mua dhe më ndihmoi t'i përgjigjem policisë; pas marrjes në pyetje, ai kërkoi nga policia që të shikojë deklaratat e mia dhe t'i lexojë përsëri me kujdes së bashku me mua; vetëm pas kësaj, e nënshkrova atë. Tani, unë jam duke pritur për të parë nëse gjyqtari do të më takojë; unë jam ende shumë i shqetësuar, por të paktën, e di që avokati im do të më shoqërojë;

4 Në vend që të shkoj në rajonin e policisë dhe në vende të ndryshme, shkova tek kjo shtëpi; ata e quajnë shtëpi të fëmijëve; dhe dikush më ka shpjeguar se të gjithë profesionistët do të vijnë për të më takuar; unë nuk kisha pse të shkoja lart e poshtë; dhe mbi të gjitha, mu desh të tregoja historinë time vetëm një herë; ata e regjistruan në video; avokati im e mbikëqyri të gjithë procedurën dhe më informoi; dhe unë mund të flisja me psikologun sa herë që ndihesha keq.

Trajnerët ndajnë pjesëmarrësit në grupe dhe shpërndajnë kazusin për zgjidhje.

I mituri i dyshuar për kryerjen e një veprë penale.

R.K është 17 vjeç. Ai ka lindur në qytetin e Librazhdit dhe aktualisht banon në Tiranë. Ai është një djalë i qeshur por impulsiv. Kohën më të madhe e kalon me një grup shokësh të cilët janë shumë të rëndësishëm për të. Nuk ka frekuentim të rregullt në shkollë por i pëlqen shumë futbollin. I mituri ndalohej nga forcat e policisë sepse dyshohet se ka kryer një vjedhje me dhunë. Ai kishte dalë me shokët dhe shoqet në një nga pub-et e Tiranës.

Rreth orës 5 (pesë) të mëngjesit, të ndikuar dhe nga efekti i pijeve alkoolike, të miturit janë zënë me njëri – tjetrin. R ka rrahur njërin nga shokët dhe më pas i ka marrë dhe celularin (Iphone). Mbas disa ditësh teksa gjendej në një lokal pranë kinemasë 17 Nëntori, R është kapur nga policia dhe sipas tij, ndaj tij është ushtruar forcë e panevojshme nga oficerët që e ndaluan. Në ambientet e komisarariatit të policisë, R është nervoz thajse gjatë gjithë kohës, nuk shfaqet bashkëpunues me oficerët e policisë dhe kërkon të flasë me një avokat.

Pyetje për pjesëmarrësit të ndarë në dy grupe:

- 1 Cilat veprime të menjëhershme do të ndërmerrnit ju si avokat i R.K.?
- 2 A është shmangia nga ndjekja penale e zbatueshme për këtë rast?
- 3 A është i mundshëm ndërmjetësimi në këtë rast?
- 4 Nëse po, në rolin e avokatit si do ta ndërgjegjësoni të miturin lidhur me masën e shmangies/ndërmjetësimin?
- 5 Në cilin moment do të kërkonte vlerësimin individual të të miturit?
- 6 Si e shikoni rolin e psikologut apo punonjësit social në këtë proces?
- 7 Si dhe sa do të përfshihenit ju si avokat në këtë proces?
- 8 Nëse do të ishit ndërmjetës cilët hapa do të ndërmerrnit?
- 9 Nëse prokurori i çështjes nuk do të miratonte një masë shmangie çfarë do të bënit ju si avokat i R.K.?

Vlerësimi individual

Të dhënat mbi personalitetin e të miturit në konflikt me ligjin.

- I mituri në konflikt me ligjin është nxënës shkolle me nivel të dobët në mësim dhe shpeshherë bën mungesa në shkollë;
- Është i padënuar më parë;
- Pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
- Është i gatshëm të kërkojë falje;
- Sillet mirë në komunitet dhe familje.

LITERATURA

Akte normative:

- Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijës”
- Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
- Karta për të Drejtat Themelore e Bashkimit Evropian
- Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e përkthimit me gojë dhe me shkrim në procedimin penal
- Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procedimin penal, OJ L 142, 1.6.2012
- Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2013 mbi të drejtën e aksesit në një avokat në procedimin penal dhe në procedimet e urdhrit evropian të arrestit, dhe mbi të drejtën për të informuar palët e treta gjatë privimit të lirisë dhe për të komunikuar me palët e treta dhe me autoritetet konsullore gjatë privimit të lirisë
- Direktiva 2016/343/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 mars 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë prezent në procedimin penal
- Direktiva 2016/1919/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi ndihmën juridike për personat e dyshuar apo akuzuar në procedimet penale dhe për personat e kërkuar në procedimet e urdhrit evropian të arrestit
- Udhëzimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për drejtësi miqësore ndaj të miturve, 2010
- Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”
- Ligji Nr. 26/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Koment i Përgjithshëm i Komitetit mbi të Drejtat e Fëmijës i KDF Nr. 14 (2013) për të drejtat e fëmijës për të pasur interesat e tij/saj në qendër të vëmendjes
- Koment i Përgjithshëm i KDF nr. 10
- Rregullat standarde minimale të OKB për administrimin e drejtësisë për të mitur (Rregullat e Pekinit)
- Udhëzimet e OKB për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit (Udhëzimet e Riadit)
- Rregullat e OKB për mbrojtjen e të miturve të cilëve u është hequr liria (“Rregullat e Havanës)
- Udhëzimet e OKB-së për drejtësinë në çështjet që përfshijnë fëmijët viktime dhe dëshmitarë të krimet
- Rekomandimi CM/Rec(2008)11 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare të Rregullave Evropiane për shkelësit e mitur që janë subjekt i sanksioneve dhe masave (ERJO)

Akte nënligjore:

- 1 Urdhri “Për miratimin e formatit të raportit për mospërbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturve në konflikt me ligjin”;
- 2 Urdhër “Për miratimin e formatit të planit individual për përbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”;
- 3 Urdhër “Përcaktim i formës dhe rregullave të përgatitjes së dokumentit për lirin me kusht të të miturve të dënuar”;
- 4 Urdhër “Për caktimin e elementeve të marrëveshjes për zbatimin e masës së shmangies ndërmjetësit nga KDPM”;
- 5 Urdhër “Përcaktimi i formës së regjistrit të posaçëm të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, “paralajmërim me gojë”;
- 6 Urdhër “Miratimi i formatit dhe të dhënave për masën alternative të shmangies. “paralajmërim me shkrim”;
- 7 Urdhër “Rregullat e përdorimit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur nga KDPM”;
- 8 Udhëzim mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur;
- 9 Urdhër i përbashkët “Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”.
- 10 Udhëzim i Përbashkët nr. 650, datë 13.09.2019, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal”, midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Doktrinë

- Project “My Lawyer, My Rights” mund të shikohet në www.mylawyermyrights.eu
- Raporte të UNICEF at <https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/digest3e.pdf>
- Interesat më të larta të fëmijës në çështjet e fundit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (2011), Jean-Paul Costa
- Drejtësia Miqësore për Fëmijët: mbrojtja dhe pjesëmarrja e fëmijëve në sistemin e drejtësisë, Ton Liefjaards
- Drejtësia miqësore për fëmijët – Lista e plotë për profesionistët (2017), Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (ADTh)
- Drejtësia miqësore për fëmijët – Perspektivat dhe përvoja e profesionistëve për pjesëmarrjen në procedimet civile dhe penale në 10 shtete anëtarë të BE-së (2015), Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (ADTh)
- National Research Report Terre des Hommes Hungary, 2018, Alternative Ways to Address Youth,

Away Project, Diversion in the Hungarian Juvenile Justice System, AWAY Project

- Moti Nissani, 1995 "Frutat, Sallata, dhe Smoothies: Një përkufizim i Punës me Qasje Ndërdisciplinore <https://esge4995.files.wordpress.com/2014/02/definicic2a6n-de-interdisciplinaredad-smothie-y-en-salada-de-frutas.p>

Jurisprudencë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, GJEDNJ

Çështja e T. kundër Mbretërisë së Bashkuar ([GC] Nr. 24724/94, 16 dhjetor 1999, § 88); Çështja Maumousseau dhe Washington kundër Francës (Nr. 39388/05, 6 dhjetor 2007, § 78-79)

Çështja Zaunegger kundër Gjermanisë (Nr. 22028/04, 3 dhjetor 2009);

Çështja Jeunesse kundër Holandës ([GC] Nr. 12738/10, 3 tetor 2014);

Çështja Mennesson kundër Francës (Nr. 65192/11, qershor 2014,);

Çështja Schneider kundër Gjermanisë (Nr. 17080/07, 15 shtator 2011);

Çështja X kundër Letonisë ([GC] Nr. 27853/09, 26 nëntor 2013 §117, 119);

Çështja Pini dhe të tjerëve kundër Rumanisë (Nr. 78028/01 dhe 78030/01, 22 qershor 2004);

Çështja G.U. kundër Turqisë (Nr. 16143/10, 18 tetor 2016);

Çështja I.C. kundër Rumanisë (Nr. 36934/08, 24 maj 2016)

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) çështja Joseba Andoni Aguirre Zarraga kundër Simone Pelz (22 dhjetor 2010)

Tema 4: Këndvështrimi psikologjik mbi rolin e avokatit në përdorimin e programeve të drejtësisë restauruese

Objektivi i modulit: Të kuptojmë rolin dhe qasjen e avokatit në zbatimin e programeve të drejtësisë restauruese.

Rezultatet e pritshme të modulit në lidhje me pjesëmarrësit janë:

- Të njihen me karakteristikat e të miturve në pozita të ndryshme në sistemin e drejtësisë: kur ata hyjnë në konflikt me ligjin, si dhe kur janë viktima apo dëshmitarë;
- Të marrin disa informacione specifike mbi drejtësinë restauruese në çështjet ku përfshihen fëmijët;
- Të marrin disa njohuri specifike mbi marrëdhënien avokat-i mitur;
- Të njihen me rolin e psikologut sipas KDPM dhe ndërveprimin me fëmijët në sistemin gjyqësor. Rëndësia e vlerësimit individual në proceset me të mitur;
- Të njohin dhe vlerësojnë rolin e aktorëve të tjerë të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë për të mitur si psikologut, ndërmjetësit, punonjësit të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, etj dhe rëndësinë e ndërveprimit me ta.

Kohëzgjatja: 1 ditë

Lista e materialeve, burimet: prezantim teorik, ushtrime, studim rasti, materiale reference të rekomanduara për një njohuri më të thelluar.

Metodologjia:

Kapitulli është i përbërë nga 4 sesione, ku secili është i organizuar si një sesion që përmban tre metodat e mëposhtme të trajtimit:

- A** Prezantim teorik;
- B** Diskutime në grup;
- C** Ushtrime – trajtim rasti.

Gjithashtu, në fund të kapitullit janë vendosur disa referenca, të cilat përveç se kanë shërbyer për hartimin e modulit, mund të konsultohen nga pjesëmarrësit për një njohuri më të thelluar për secilën çështje.

Mjete për vlerësimin: Pyetësor vlerësimi si për trajnimin ashtu edhe për njohuritë, do të përdoret në fund të trajtimit të këtij kapitulli.

Sesioni 1. Karakteristikat e të miturve në pozita të ndryshme në sistemin e drejtësisë

Në përfundim të nënkapitullit të parë, është me një rëndësi të veçantë që pjesëmarrësit të njihen me:

1 Karakteristikat e të miturve në pozita të ndryshme në sistemin e drejtësisë:

- a** Si hyjnë fëmijët në konflikt me ligjin. Fëmijët e dyshuar për kryerjen e një veprë penale;
- b** Fëmijët viktimë dhe dëshmitarë.

A Prezantim teorik

Fëmijët në konflikt me ligjin – si të dyshuar për kryerjen e një veprë penale

Si hyjnë fëmijët në konflikt me ligjin?

Fëmijët janë më të rrezikuar që të hyjnë në kontakt me ligjin kur ata jetojnë në periudha ndryshimesh sociale dhe rrethana të paqëndrueshme. Lidhjet e tyre me familjen dhe shkollën dobësohen dhe fëmijët e kërkojnë ndjenjën e lidhjes dhe përkatësisë sociale edhe duke u bashkuar me grupe të rinjsh me sjellje devijante. Në grupe të tilla, shpesh, këta të mitur kanë më shumë gjasa të veprojnë edhe nën efektin e konsumimit të alkoolit apo lëndëve narkotike. Këto grupe spontane shpesh tërheqin edhe vëmendjen e të rriturve që synojnë t'i përfshijnë ata në aktivitete kriminale.

Pavarësisht krimeve të kryera në moshë të mitur, një numër i konsiderueshëm i adoleshentëve, vijojnë të kenë një jetë normale dhe në përputhje me ligjin pasi kalojnë adoleshencën. Janë disa faktorë që në ndryshim nga të rriturit, e rrisin mundësinë e fëmijëve për të qenë në kontakt me sistemin e drejtësisë, siç janë: mungesa e pjekurisë, prirja për të pranuar një nivel të lartë rreziku dhe ndjeshmëria ndaj ndikimit të moshatarëve, ashtu edhe kufizime në zhvillimin konjitiv, probleme të shëndetit mendor dhe viktimizimi. Këta faktorë të kombinuar me aftësinë unike të të miturve për t'u rehabilituar, bëjnë që të kërkohen ndërhyrje intensive e të specializuara për trajtimin e tyre nga sistemi i drejtësisë për të mitur.

Pjesa më e madhe e veprave penale të kryera nga të miturit nuk janë serioze apo shumë të dëmshme për komunitetin. Është e rëndësishme të kuptojmë se shumica e fëmijëve do të kryejnë gabime dhe do të testojnë normat sociale dhe autoritetet, pasi kjo është një pjesë e natyrshme e rritjes. Në raste të tilla duhet pasur një qasje që e aftëson fëmijën të vlerësojë normat dhe vlerat shoqërore.

Fëmijët që vijnë nga rrethana të vështira sociale kanë më shumë akses në alkool apo droga si një mënyrë për

t'u përballur me këto vështirësi. Në rrethana të tilla, ata mund të shfrytëzohen nga të rriturit. Pamundësia për t'u përfshirë në arsim, kualifikime profesionale ose punësim, krijon mungesën e shpresës, e cila nga ana tjetër, rrit mundësinë për t'u sjellë në kundërshtim me normat sociale. Lëvizjet e popullsisë nga një qytet në tjetrin apo kthimi nga emigracioni i bën adoleshentët të përballojnë me vështirësi realitetin e ri dhe izolimin social.

Sa i përket fëmijëve në rrezik për të hyrë në konflikt me ligjin, historia e tyre familjare dhe sjellja aktuale i bën profesionistët të gjykojnë mbi kriminalitetin e tyre në të ardhmen.

Zakonisht, karakteristika kryesore e këtyre fëmijëve është vulnerabiliteti i tyre. Ata mund të shfaqin sjellje që duken të frikshme, armiqësore ose vetë-shkatërruese. Sjellje të tilla mund të nxisin reagime dhe emocione negative edhe tek profesionistët. Ndaj çdo profesionist në kontakt me fëmijët duhet të njohë këto karakteristika kur punon me një fëmijë të tillë dhe përballlet me këto sjellje. Një mënyrë që ndihmon në këto raste, është të kuptojmë origjinën e sjelljes dhe cilat masa mund të merren për ta korrigjuar atë. Identifikimi i faktorëve mbrojtës dhe atyre rrezikues, është i rëndësishëm në procesin e vlerësimit të fëmijës.

Ndikimi që ka tek fëmijët kontakti me sistemin e drejtësisë në raport me pozitën që kanë fëmijët (shkelës, dëshmitar apo viktimë)

Fëmijët mund të mos arrijnë të marrin pjesë në mënyrë të përshtatshme në procesin penal për shkak të një numri arsyesh si, prirja për t'u sugjestionuar, të rënë dakord për të qenë në rregull me të tjerët (prindërit, kujdestarët, prokurorin), aftësi të kufizuara vëmendjeje dhe niveli i ulët i funksionimit konjitiv.

Ndonëse fëmijët mund të jenë në gjendje të dallojnë të mirën nga e keqja, kjo nuk garanton se ata gjithashtu, janë në gjendje të vlerësojnë rëndësinë e veprimeve të tyre.³⁷ Fëmijët bien më shpejt në kontakt me sistemin e drejtësisë krahasuar me të rriturit, pasi ata kanë më pak eksperiencë, veprojnë në grup, kryejnë vepra në publik, si dhe pranë vendbanimit të tyre. Faza e adoleshencës ndikon në mënyrën se si individit e percepton procesin penal. Fëmijët para moshës 14 vjeç e perceptojnë veten si llogaridhënës vetëm ndaj ambientit të tyre të afërt: prindër, mësues, sesa në shoqërinë më të gjerë. Të kuptuarit më i plotë kërkon aftësi për të menduar në terma abstrakte që fitohet pas moshës 14 vjeç. Deri atëherë, fëmijët kanë më pak gjasë të perceptojnë procedurat ligjore, apo të vlerësojnë plotësisht vendin e tyre në një sistem më të gjerë social.

Fëmijët në risk kanë gjasa të vijnë nga një e kaluar me probleme dhe të kenë përjetuar forma të ndryshme të abuzimit, përfshirë neglizhencën apo abuzimin emocional, fizik apo edhe seksual. Prandaj, është e rëndësishme që çdo profesionist në kontakt me fëmijët në sistemin e drejtësisë të jetë i vëmendshëm për të identifikuar elemente të tilla dhe për t'i referuar ata në shërbimet përkatëse të specializuara të mbrojtjes së fëmijëve.

³⁷ Urbas, G 2000, 'The Age of Criminal Responsibility', Trends and Issues in Crime and Criminal Justice, no. 181, Australian Institute of Criminology, Canberra. Available at: http://www.aic.gov.au/media_library/publications/tandi_pdf/tandi181.pdf and Arthur, R 2012, 'Rethinking the Criminal Responsibility of Young People in England and Wales', European Journal of Crime, Criminal Law and Criminal Justice, Koninklijke Brill NV, Leiden, pp. 13-29

ACE (*Adverse Childhood Experiences*) nënkupton Përvojat Negative të Fëmijërisë. Është një term që përdoret për të përshkruar të gjitha llojet e abuzimeve, neglizhencave dhe përvojave të tjera potencialisht traumatike që ndodhin tek njerëzit nën moshën 18 vjeç. Këto eksperiencë janë veçanërisht të lidhura me sjelljet keqbërëse. Fëmija shkelës i ligjit mund të jetë një fëmijë në risk dhe që ka përjetuar një seri vështirësish në jetën e tij personale dhe familjare. Në përgjigje të ngjarjeve të ndryshme, fëmijët mund të manifestojnë sjellje riskuese që kanë pasoja afatgjata në shëndetin e tyre dhe mund të çojnë në probleme disiplinore në shkollë ose në kontaktin me sistemin e drejtësisë.

Ndërkohë, sjellja e fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale duhet referuar pranë Njesisë së Mbrojtjes e Fëmijëve në mënyrë që të kryhen ndërhyrje të përshtatshme për ta në rrugë civile, të cilat janë në interesin më të lartë të fëmijës.

Fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të një veprë penale

Nga ana tjetër, përvojat e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të një veprë penale, mund të kenë pasoja negative në rezultatet në shkollë, marrëdhëniet familjare dhe sociale, aftësinë për të komunikuar dhe sjelljen në përgjithësi. Pjesëmarrja e tyre në procesin gjyqësor mund të krijojë probleme të reja. Në praktikë, duhet arritur një balancë midis interesave të ndryshme siç është e drejta e fëmijës për të marrë pjesë në procese që lidhen direkt me të, dhe të drejtave të tjera të njeriut si e drejta e personit të akuzuar në një çështje penale. Prandaj, duhen krijuar kushte të përshtatshme për të lehtësuar pjesëmarrjen e fëmijës viktimë apo dëshmitar në një proces penal.

Një fëmijë pavarësisht moshës, duhet respektuar si dëshmitar dhe dëshmia e tij nuk duhet konsideruar e pavlefshme vetëm duke u bazuar në faktorin moshë. Niveli i aftësisë për të kuptuar nuk duhet matur vetëm me moshën biologjike, duke qenë se fëmijët arrijnë pjekurinë sa i përket aspekteve të ndryshme të zhvillimit, në faza të ndryshme. Sidoqoftë, e drejta për t'u dëgjuar është një e drejtë e fëmijës, jo një detyrë për fëmijën.³⁸

Të qenit viktimë apo dëshmitar në një vepër penale mund të ketë pasoja serioze për zhvillimin fizik, emocional dhe psikologjik të një fëmije, si dhe në marrëdhëniet e tij me të tjerët. Mënyra jokorrekte e intervistimit të fëmijëve jo vetëm krijon stres tek fëmija, por mund çojë në përsëritje të procesit, që nga ana tjetër rezultojnë në viktimizimin e dytë të tij.

Është e rëndësishme të kuptohet se fëmijët e përjetojnë dëmin e pësuar në mënyra të ndryshme. Kjo sepse nga personi në person ndryshon niveli i aftësive për t'u përshtatur, niveli i mbështetjes që ata marrin nga mjedisi përreth dhe vlerësimi i dëmit të shkaktuar nga akti në atë që ata e konsiderojnë të rëndësishme në jetën e tyre. Për këtë arsye, e njëjta vepër dëmton njerëz të ndryshëm në nivele të ndryshme. Nevojat dhe dëshirat e viktimës nuk duhen marrë të mirëqena bazuar në supozimin se ai është i rrezikuar. Nevojat dhe

dëshirat e viktimës duhen kuptuar bazuar në një vlerësim individual.

Vepra penale dëmton viktimën, por ajo krijon nevoja psiko-sociale si për viktimën, ashtu edhe për autorin të cilat mund të trajtohen më së miri nga drejtësia restauruese.

Ndërsa ndërhyrjet e drejtësisë restauruese mund të kenë përfitime pozitive për të riun shkelës të ligjit, është e rëndësishme të kuptohet se kjo qasje nuk duhet të shihet vetëm si një mjet rehabilitimi për shkelësin, por ajo duhet të fokusohet edhe në të drejtat, nevojat dhe dëshirat e viktimës.³⁹ Deklarata e parimeve bazë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit (1985) e përkufizon viktimën si personi i cili individualisht ose në grup, ka pësuar dëm, që përfshin dëmtim fizik, mendor, vuajtje emocionale, humbje ekonomike, ose dëmtim thelbësor të të drejtave, përmes veprimeve ose mosveprimeve të kundërligjshme. Një person mund të konsiderohet viktimë sipas kësaj deklarate, pavarësisht nëse autori ndalohet, arrestohet, dënohet apo pajtohet me viktimën.

Gjendja emocionale dhe sjellja e viktimës dhe dëshmitarit duhet të jenë shumë të rëndësishme për të gjithë profesionistët e përfshirë në proces. Ato nuk janë një element shtesë në proces, por thelbi i tij.

Pse nuk flasin fëmijët?

Fëmijët nuk flasin shpesh për krimet e pësuara. Ka shumë arsye pse fëmijët duan të qëndrojnë të heshtur:

- Ata nuk e kuptojnë nganjëherë rëndësinë e veprës së kryer ndaj tyre;
- Ata kanë shpesh frikë nga pasojat e rrëfimit për personat e tjerë dhe për veten e tyre nga autori;
- Disa fëmijë kanë krijuar idenë se askush nuk do t'i besojë ata, ose sepse mendojnë se e meritonin atë që u ndodhi dhe nuk duhen ndihmuar;
- Fëmijët shpesh besojnë se mund të kërcënohen dhe ndëshkohen nëse flasin rreth abuzimit dhe shfrytëzimit;
- Ose sepse autori është një i afërm i tyre, duke e bërë më të vështirë të rrëfihen për eksperiencën e tyre.

Arsyet e heshtjes së fëmijëve varen nga disa faktorë individualë dhe rrethanorë. Kjo nuk do të thotë se ju duhet të diagnostikoni problemet e fëmijëve, por se duhet të jeni vigjilentë për t'i referuar këto probleme tek shërbimet e duhura.

Trajtimi me dashamirësi dhe respekt për dinjitetin është një parim shumë i rëndësishëm në trajtimin e fëmijëve në sistemin e drejtësisë, sidomos për fëmijët viktima dhe dëshmitarë.

E drejta e fëmijëve për t'u trajtuar me dinjitet duhet kuptuar si e drejtë për t'u trajtuar si qenie njerëzore me të drejta të plota, jo si marrës pasivë të kujdesit të të rriturve. Kjo as nuk nënkupton se fëmijët duhen trajtuar si

³⁹ European research on restorative juvenile justice, A European Model for Restorative Justice with Children and Young People Protecting Rights, Restoring Respect and Strengthening Relationships.

të rritur, ose si të *“rritur të vegjël”*. Profesionistët duhet të trajtojnë çdo fëmijë viktimë dhe dëshmitar në çdo fazë të procesit, në përputhje me të drejtat individuale, nevojat e veçanta, dëshirat apo ndjenjat, si dhe në respekt të plotë të gjinisë, aftësive të kufizuara dhe integritetit moral.

Avokati duhet të kuptojë se fëmija viktimë apo dëshmitar mund të mos jetë në gjendje, në një moment të caktuar të zhvillimit, të kuptojë dhe të ritregojë ngjarjet që kanë ndodhur ose të kuptojë pasojat e plota të krimit.

Viktimizimi i parë dhe i dytë

Në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur ka një kapitull të dedikuar për të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve. Stresi që fëmijët përjetojnë si rezultat direkt i krimit është viktimizimi i parë. **Ndërsa viktimizimi i dytë i referohet viktimizimit që ndodh jo si rezultat i veprës penale, por për shkak të përgjigjes së institucioneve dhe individëve ndaj viktimës. Viktimizimi i dytë i institucionalizuar është më i dukshëm në sistemin e drejtësisë penale. Kjo vjen nga sjellja e papërshtatshme e një oficeri policie, prokurori, gjyqtari, etj.**

Në mënyrë më të padukshme, i gjithë procesi hetimor riviktimizon viktimën, përmes vendimit për të mos proceduar autorin, apo për të mos dhënë dënim me burgim. Riviktimizimi i dytë në thelb, ndodh për shkak të vështirësisë për të vendosur në balancë të drejtat e viktimës dhe të drejtat e autorit të dyshuar. Më rëndom, kjo ndodh kur të gjitha palët në proces nuk marrin në konsideratë pikëpamjen e viktimës.

Ndonëse këtë përgjegjësi e kanë më shumë prokurorët dhe gjyqtarët, edhe avokatët duhet të vënë në dukje rëndësinë që kanë pasojat që sjell riviktimizimi i dytë në jetën e fëmijës dhe zhvillimin e tij.

Fëmijët dëshmitarë

E drejta për t’u trajtuar me dinjitet zbatohet njësoj edhe tek fëmijët dëshmitarë. Shpesh besohet se fëmijët që janë dëshmitarë të një veprë, nuk vuajnë aq shumë sa fëmijët viktima. Pa dashur të krahasojmë këto dy grupe dhe përjetimet e tyre, duhet vënë në dukje se edhe dëshmitarët mund të vuajnë shumë nga ajo që kanë parë apo dëgjuar. Krimi mund të ketë ndikuar shumë në jetën e tyre. Sidomos kjo ndodh kur krimi kryhet në ambientin e tyre të afërt, apo është dhunë seksuale ndaj një të afërmi (motër, vëlla, etj.) nga një tjetër anëtar i familjes, dhe pasojat mund të jenë afatgjata. Prandaj, e njëjta vëmendje duhet treguar edhe për fëmijët dëshmitarë bazuar në nevojat e tyre dhe situatën specifike.

B Diskutim në grup: Në fund të pjesës teorike, diskutimi në grup bëhet mbi bazën e informacionit të dhënë, eksperiencat e pjesëmarrësve dhe si ndikon viktimizimi në pjesëmarrjen e fëmijës në proces.

C Trajtim rasti:

Fëmija 8 vjeç A.Z. u intervistua për një situatë të dyshuar të abuzimit fizik nga një i rritur. Oficeri i policisë për shkak të situatës delikate, pasi u konsultua, vendosi të kryente pyetjen e fëmijës në ambientet e një OJF duke qenë se komisariati ku ai punonte, nuk kishte dhomë të përshtatshme për intervistimin e fëmijës. Fëmija u pyet në prani të një psikologu në ambientet e OJF dhe të avokatit që ofronte ndihmë juridike falas. Si pasojë e rrëfimit të detajuar të fëmijës, i cili zgjati në kohë për shkak të pushimeve dhe ndërprerjeve, si pasojë e gjendjes së rënduar emocionale të fëmijës, u arrit që të merrej i plotë rrëfimi i fëmijës. I dyshuari u shpall në kërkim, pasi nuk u gjend nga forcat e policisë. Identifikimi i tij u bë i mundur pas 10 muajsh. Pasi u kaluan të gjitha fazat, gjykimi i të pandehurit vijoi me seancën e pyetjes së fëmijës.

Pyetja e fëmijës u krye në sallën e gjyqit për arsye teknike (në pamundësi të funksionimit të pajisjeve audio-vizive në një dhomë tjetër) dhe fëmija u gjend mes disa palëve (prokurorit, avokatit të të pandehurit, gjyqtarëve) ndonëse u shmang prania e të pandehurit. Megjithatë, palët nuk kishin konsultuar më parë pyetjet. Ndonëse gjyqtari u mundua të ishte sensitiv dhe miqësor me fëmijën, duke zbatuar disa teknika miqësore të intervistimit, ndërhyrje të shumta bëheshin nga secila palë, duke "bombarduar" fëmijën me një seri pyetjesh, që e shpërqendruan dhe ndikuan negativisht në gjendjen emocionale të fëmijës. Pavarësisht sugjerimit të psikologut për shtyrje apo ndërprerje procesi dhe ndonëse u krye një pushim i shkurtër, seanca vijoi duke qenë se palët ishin dakord me vijimin dhe përfundimin sa më parë të procesit të pyetjes. Fëmija u bllokua dhe nuk arriti të jepte një dëshmi të plotë. Dëshmia e tij ishte shumë e zbehtë dhe jo e qartë në raport me rrëfimin e detajuar që kishte dhënë para oficerit të policisë.

Vijohet me diskutimin mbi rastin:

- Cilët janë elementët që çuan në dështimin e procesit?
- Çfarë mund të ishte bërë ndryshe në gjithë procesin?
- Po roli i avokatit të viktimës, cili mund të kishte qenë?

Sesioni 2. Këndvështrimi psikologjik mbi drejtësinë restauruese

A Prezantim teorik

Pse duhet që avokatët të kenë njohuri mbi drejtësinë restauruese?

Qëllimi i avokatëve është t'i shërbejnë klientëve të tyre, sidomos kategorive në nevojë,⁴⁰ duke i dëgjuar dhe duke bashkëpunuar me profesionistë të tjerë drejt programeve që adresojnë jo vetëm çështjet e drejtësisë, por edhe interesat e nevojat e klientëve.⁴¹ Në pamje të parë, drejtësia restauruese në perceptimin e avokatëve duket më shumë një fushë e shërbimeve sociale, por në fakt, duke qenë se klientët vijnë tek ata për t'u këshilluar, ata duhet të dinë si të trajtojnë problemet me të cilat përballlet klienti. Aftësitë restauruese nevojiten në të gjitha nivelet e punës me klientin. Edhe gjatë procesit të ndërmjetësimit, avokati mund të ofrojë këshilla ligjore, pasi kjo nuk është detyrë e ndërmjetësit. Avokati mund të jetë burim informacioni në këtë proces duke informuar palët për opsionet më të mira.

Sa më serioz të jetë konflikti, aq më e nevojshme do të jetë ndihma e avokatit. Edhe nëse zgjidhet ndërmjetësimi, përsëri mund të ketë nevojë për ndihmën e avokatit⁴² lidhur me:

- *Dhënien e informacionit mbi të drejtat ligjore të fëmijës;*
- *Këshillimin mbi situatën konkrete;*
- *Rishikimin e marrëveshjes së arritur me anë të ndërmjetësimit.*

Avokatët janë një pikënisje e mirë për referimin e shkelësve të ligjit në programet e drejtësisë restauruese. Avokati ka rolin e tij duke i shpjeguar të miturit përfitimet që ai merr nga pjesëmarrja në këto programe. Ai mund të ndihmojë procesin duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të të miturit.⁴³ Drejtësia restauruese është një qasje që i ofron viktimës, shkelësit dhe komunitetit një rrugë alternative të drejtësisë. Ajo promovon pjesëmarrjen e sigurtë të viktimës në zgjidhjen e situatës dhe u ofron njerëzve, të cilët e pranojnë përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar prej veprimeve të tyre, një mundësi për llogaridhënie ndaj atyre që kanë dëmtuar. Drejtësia restauruese bazohet në njohurinë se sjellja kriminale jo vetëm shkel ligjin, por dëmton edhe viktimat dhe komunitetin.⁴⁴ Manuali i UNODC, "Handbook on Restorative Justice Programmes, i publikuar në vitin 2020, përcakton se avokatët janë një prej aktorëve kryesorë në procesin e referimit të fëmijëve në drejtësinë restauruese: avokatët mund të ndihmojnë duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të

⁴⁰ WHY TEACH RESTORATIVE JUSTICE? Janine Geske, Marquette Law Review, <http://scholarship.law.marquette.edu/mulr>, 2005

⁴¹ Joseph D. Kearney, Message from the Dean, <http://lae.marquette.edu/cgi-bin/site.pl?2130&pageID=1222>.

⁴² <https://www.peoples-law.org/should-i-look-attorney-or-mediator>

⁴³ Handbook on Restorative Justice Programmes, United Nations Office on Drugs and Crime, 2006

⁴⁴ Handbook on RESTORATIVE JUSTICE PROGRAMMES SECOND EDITION, UNODC, 2020.

autorit të veprës penale dhe vlefshmërinë e të drejtës për apelim. Avokatët mund të luajnë rol në rastet e fëmijëve, duke siguruar që fëmijët të pranojnë të marrin pjesë në një proces të drejtësisë restauruese bazuar në vullnetin e tyre të lirë dhe informacionin e plotë.

Disa pyetje mbi drejtësinë restauruese⁴⁵

A mund të përdoren programet e drejtësisë restauruese për të dënuarit e mitur që kanë kryer vepra të rënda penale?

Programet e drejtësisë restauruese duhet të ofrojnë zgjidhje fleksibël që marrin parasysh rrethanat e çdo fëmije dhe kërkesat e çdo rasti. Programe të caktuara të drejtësisë restauruese mund të aplikohen, edhe nëse çështja ka hyrë në sistemin formal të procedimit penal, madje edhe nëse i mituri është në burg.⁴⁶

A është drejtësia restauruese e detyrueshme?

Një nga elementët më karakteristikë të drejtësisë restauruese është vullneti i lirë, pasi para se të ndodhë çdo lloj përbaljeje midis palëve, nevojitet një kohë e caktuar për përgatitjen e tyre. Një përgatitje e tillë është po aq e rëndësishme sa vetë procesi. Ky është momenti kur palët mund të shprehin motivimin e tyre për të takuar tjetrin, mund të shprehin pritshmëritë e tyre për takimin dhe të kuptojnë nëse një takim i tillë ka përfitim për ata vetë.

Gjatë fazës përgatitore, moderatorët /ndërmjetësit duhet të vlerësojnë nëse kjo eksperiencë do të ketë përfitime për të dy palët dhe nëse është e nevojshme, diskutohen edhe dyshimet që palët mund të kenë me njëri-tjetrin. Pra, drejtësia restauruese nuk është e detyrueshme, edhe pse kërkon pjesëmarrje aktive të palëve. Drejtësia restauruese mund të përdoret në çdo lloj konflikti dhe jo vetëm në çështjet penale.

Në cilën fazë të procesit mund të ndodhë drejtësia restauruese?

Drejtësia restauruese mund të përdoret në çdo fazë të procesit. Në praktikë, legjislacioni dhe politikat ndryshojnë në vende të ndryshme. Në parim, drejtësia restauruese mund të ofrohet në ato raste që nuk janë në fokusin e procesit penal (me anë të vetë-referimit) dhe po ashtu, gjatë akuzës, hetimit, gjykimit, dënimit, burgimit dhe integritit përmes referimeve nga të gjithë aktorët. Pra, edhe nëse palët mund të mos e ndiejnë veten të gatshëm kur kjo mundësi u ofrohet në një fazë të hershme, gjithmonë ekziston mundësia që të përfshihen në një fazë të mëvonshme.

⁴⁵ <https://childhub.org/sq/online-biblioteka-o-djecijoj-zastiti/drejtësia-restauruese-konceptet-kryesore-dhe-pyetjet-me>

⁴⁶ Promoting restorative justice. The Special Representative of the Secretary-General on Violence against Children for children, Publication produced by the Office of the SRSG on Violence against Children in 2013

Pse mund të dojë një palë të marrë pjesë në një proces të drejtësisë restauruese?

Motivimi më i shpeshtë e i zakonshëm është mundësia që i jepet personit për të treguar anën e tij të historisë, të dëgjohet, të shprehë ndjenjat, të informohet më mirë për ngjarjen, të përfshihet në mënyrë aktive në riparimin e dëmit. Autori i veprës në bazë vullnetare, po ashtu, ka mundësinë të marrë përgjegjësi, të shprehë pendesë, dhe të ndërmarrë veprime për riparimin e dëmit. Viktima ka mundësi të ndjehet më e sigurtë duke marrë përgjigjet për pyetjet që ka dhe të fuqizohet më shumë. Të dy palët mund të riparojnë marrëdhënien me komunitetin e tyre më të gjerë, pasi të kenë riparuar ndjenjat e tyre të sigurisë dhe kontrollit.

Kush paguan për procesin?

Në çështjet penale me të mitur, mbështetja financiare duhet të vijë nga shteti, sidomos për të miturit të cilët i marrin falas të gjitha shërbimet.

Ku ndodh takimi restaurues?

Në zona neutrale, zyra OJF, zyra ndërmjetësi, etj.

Sa mund të zgjasë takimi ndërmjetësues?

Nuk ka limite kohore për këtë. Rastet fillojnë nga dy minuta deri në një ditë të plotë apo orë të ndryshme në ditë të ndryshme. Nuk ka një kohë ideale për fillimin e saj dhe as për kohëzgjatjen. Prosesi i takon atyre që janë prekur nga dëmi, prandaj, është në perceptimin e tyre sa kohë duhet për riparimin e tij. Megjithatë, nëse ndërmjetësimi është propozuar nga prokurori/gjyqtari (bazuar në KDPM) dhe pranuar nga palët, atëherë çështja penale pezullohet për 45 ditë, për të dhënë këtë kohë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim. (neni 65, pika 7 e KDPM).

A ka një ndjekje të mëtejshme të procesit?

Ndërmjetësi duhet të bëjë një vlerësim të mëtejshëm se si po ndjehen palët, pa përcaktuar një kohë ekzakte. Nëse një nga palët nuk i përmbahet premtimeve të bëra në marrëveshje, p.sh. autori, atëherë ndërmjetësi flet me të dhe ia komunikon viktimës arsyet dhe shikojnë mundësinë e ribërjes së takimit. Po ashtu, nëse ndërmjetësi e ka detyrim, ai raporton në organet përkatëse.

Për sa i përket mbikëqyrjes së përmbushjes së masës së shmangies nga ndjekja penale, ajo kryhet nga Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me shërbimin e ndërmjetësimit.⁴⁷ Kur çështja është referuar për ndërmjetësim nga gjykata ose institucionet e tjera përkatëse, ndërmjetësi, në përfundim të procedurës së

ndërmjetësimet, ose në afatin e përcaktuar prej tyre, i njofton ato për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes, duke dërguar edhe aktet përkatëse..

Pse është e rëndësishme të flitet rreth mbrojtjes së fëmijës viktimë në drejtësinë restauruese?

Fëmija viktimë ka të drejtat e plota të çdo viktime, dhe të drejtën t'i ushtrojë ato. Kjo aplikohet edhe në drejtësi, duke mbajtur parasysh se eksperiencia e drejtësisë është personale dhe nuk mund të aplikohet në një mënyrë standarde. Fëmijët shpesh kërkojnë mbështetje të veçantë dhe mbrojtje për të shmangur rrezikun e viktimizimit të dytë. Për këtë arsye, drejtësia restauruese duhet të ofrojë një shërbim të individualizuar, duke marrë parasysh nevojat e njerëzve, llojin e krimit dhe pasojat e tij. Po ashtu, duhet ofruar një program i ndërthurur me disiplina dhe shërbime të tjera (arsim, shëndetësi, etj.) për t'u fokusuar tek mjedisi social i fëmijës. Fëmijët viktimë kanë marrë më shumë të drejta sidomos me Direktivën e 2012 të Bashkimit Evropian. Kjo direktivë i referohet gjithashtu, drejtësisë restauruese.

A është e sigurtë drejtësia restauruese për fëmijët?

Ajo është konsideruar e sigurtë dhe një prioritet nga Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijëve. Por për të qenë e tillë, duhen respektuar udhëzuesit. Së pari, palët janë të lira ta nisnin kur të duan procesin e po ashtu, ta ndërpresin. Së dyti, shërbimi duhet ofruar nga ndërmjetës të trajnuar për fëmijët, sidomos për çështje delikate. Së treti, duhet pasur një qasje fleksibël sipas nevojave të palëve, duke marrë parasysh moshën, pjekurinë, nevojat dhe shqetësimet. Megjithatë, kur flasim për fëmijën, ka një shqetësim për riskun e disbalancës së pushteteve, prandaj, prindërit ose/dhe profesionistët e tjerë (psikologu) duhet të përfshihen në proces që në fazën përgatitore.

Në cilat vepra mund të praktikohet drejtësia restauruese?

Përveç kufizimeve që vendosen për shmangien, praktikat e tjera mund të përdoren në çdo fazë të procesit deri tek veprat më komplekse. Përcaktues nuk është vetëm tipi i veprës, por edhe përshtatshmëria dhe vullneti i palëve për t'u angazhuar në proces. Megjithatë, drejtësia restauruese nuk mund të përdoret në çdo rast, dhe duhet mbajtur parasysh në këto kushte, siguria dhe parandalimi i riviktimizimit të dytë.

Profesionistët po zbulojnë se drejtësia restauruese mund të jetë me përfitim edhe në situata që përfshijnë krime më serioze, nëse jo si një alternativë ndaj sistemit të drejtësisë penale, atëherë si plotësuese e saj. Sidoqoftë, siguria dhe masat për sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave duhet të jenë thelbësore.⁴⁸ E njëjta konsideratë tregohet edhe kur janë të përfshirë fëmijët, që të mbizotërojnë interesi i tyre më i lartë.

⁴⁸ Handbook on Restorative Justice Programmes, Second Edition, UNODC, 2020.

A mund të përdoret në shkolla?

Ajo mund të përdoret në shkolla për të parandaluar e zgjidhur konfliktet, por gjithashtu, për të krijuar një ndjenjë më të fortë solidariteti e përgjegjësie brenda komunitetit të shkollës. Kjo është shumë e rëndësishme për të edukuar fëmijët për të perceptuar normalitetin e konflikteve si një mundësi për të mësuar dhe jo si një kërcënim. Metoda të ndryshme mund të përdoren. Është e rëndësishme që fëmijët dhe adoleshentët të mësojnë rreth ekzistencës së kësaj mënyre për t'u përballur me konfliktet dhe për të shprehur emocionet, duke qenë se ata mund të bëjnë ndryshime në shoqëri si krijimi i lidhjeve sociale, solidariteti, përgjegjshmëria dhe përfshirja.

A munden palët të ndalin procesit?

Të dy palët mund ta ndalojnë procesin kurdo që duan, ndërkohë që ndërmjetësi duhet të krijojë një ambient të sigurtë që ata të shprehin arsyet e tyre për ta bërë këtë. Ai gjatë procesit duhet të sigurohet herë pas here që palët po ndjehen mirë dhe kanë vullnetin për të vazhduar.

Cili është roli i prindërve dhe mbështetësve të tjerë në drejtësinë restauruese?

Në varësi të metodës së drejtësisë restauruese, prindërit mund të jenë të pranishëm gjatë takimeve ku palët janë përballë njëri-tjetrit. Roli i tyre është të mbështesin fëmijët. Në konfliktet midis prindërve dhe fëmijëve, persona të tjerë të besueshëm mund të përfshihen në proces, kjo me qëllim interesin më të lartë të fëmijës dhe dëshirën e fëmijës për mbështetje.

Kujdes: nga intervistat e bëra në një kërkim shkencor⁴⁹ është gjetur se prindërit mund të influencojnë procesin e ndërmjetësimi, dhe mund të jenë një pengesë për shprehjen e zërit të fëmijës bazuar në perceptimet e tij, pavarësisht mbështetjes që ata ofrojnë. Edhe Gal në 2011 ka zbuluar se prindërit, shpesh flasin në emër të fëmijëve, duke penguar shprehjen e perceptimit të vetë fëmijëve, sa që disa praktika të drejtësisë restauruese kanë pasur më shumë efekte pozitive tek të rriturit sesa tek fëmijët. Këtu përjashtohen rastet kur veprat janë kryer nga anëtarë të familjes, pasi në këto raste ndërmjetësimi ka pasur efekte pozitive. Sidoqoftë, pavarësisht moshës, fëmijët nuk duhen privuar nga e drejta për të marrë pjesë në këto procese.

Çfarë është faza e përgatitjes?

Faza e përgatitjes së fëmijës për këtë proces është thelbësore, duke qenë se është një moment i identifikimit të nevojave të veçanta si dhe i mbështetjes së tyre me mjetet e nevojshme për të kapërcyer situata të vështira. Një fazë e tillë lejon ndërmjetësin të vendosë nëse fëmija është i përshtatshëm për këtë proces apo

nëse procesi mund ta ritraumatizojë atë. Këtu është thelbësore që zhvillimi i fëmijës të merret në konsideratë, sidomos në termat e sjelljes.

Konsiderata të veçanta kur punojmë me fëmijë viktime dhe të dyshuar në programet e drejtësisë restauruese

Për fëmijët viktime, çdo formë e dhunës ose neglizhimit duhet trajtuar në aspektet më të rëndësishme si më poshtë:

- Mbrojtja;
- E drejta për t'u dëmshpërblyer për dëmin e shkaktuar;
- Ofrimi i asistencës për dëmshpërblimin dhe integrimin;
- Ofrimi i një mjedisi që promovon shëndetin, vetë-respektin dhe dinjitetin e fëmijës;
- Parandalimi i riviktimizimit;
- Vëmendja ndaj disbalancës së pushteteve;
- Përdorimi i vlerësimit individual të riskut, kur është e mundur;
- Vëmendja ndaj masave ligjore mbrojtëse sipas rastit, bazuar në të drejtat e fëmijës;
- Rëndësia e trajnimit për të gjitha këto aspekte, për profesionistët që punojnë me fëmijët.

Të drejtat që lidhen me fëmijët autorë:

- Gjykimi i drejtë dhe qasja e bazuar në nevojat e fëmijës;
- Interesi më i lartë i fëmijës, të mësuarit nga gabimet;
- Moshë minimale e përgjegjësisë penale;
- Shmangia si masë e parë;
- Burgimi si masë e fundit (dhe për periudha të shkurtra);
- Fokusi në restaurim dhe në riintegrim;
- Kujdesi për mbrojtjen e viktimës.

Konsiderata të vlefshme për fëmijët viktime dhe shkelës:

- Vlerësimi i rolit të prindit;
- Procese miqësore me fëmijët dhe pjesëmarrja;
- Marrja në konsideratë e aftësive zhvillimore të fëmijës;
- Marrja në konsideratë e diferencave gjinore.

Janë katër emocione kryesore, në shumicën e historive të dëmit dhe efekteve të tij:

- Zemërimi;
- Frika;
- Ankthi; dhe
- Turpi.

Zemërimi ose frika tek viktima mund të çojë në dëshirën për hakmarrje ose mbrojtje. Ankthi ose turpi tek autori mund të çojnë në një strategji të fitimit të simpatisë dhe shpëtimit nga pasojat e veprimeve të tyre ose shmangie të përgjegjësisë dhe një përpjekje për të fajësuar të tjerët për dëmin. Asnjëra nga këto strategji nuk riparon dëmin, ndikimin e tij dhe as palët me njëra-tjetrën. Dialogu është një mënyrë për t'u informuar mbi mënyrën si njerëzit e kanë kuptuar një ngjarje apo një çështje dhe përgjigjen e tyre ndaj saj.

Zemërimi është një përgjigje emocionale e natyrshme ndaj një padrejtësie dhe shpesh nënkupton nevojën për drejtësi. Po ashtu, frika tregon nevojën për siguri. Ankthi është shpesh një përgjigje ndaj ndjenjës se ju keni humbur kontrollin mbi jetën tuaj. Turpi përfaqëson në shumë raste nevojën për rritimin e respektit.

Përgjigja restauruese ndaj dëmit

Drejtësia, siguria, kontrolli ose autonomia dhe respekti janë të gjitha nevoja që mund të përmbushen në mënyrë më efektive nga një proces i drejtësisë restauruese sesa nga proceset më formale por më pak të personalizuar.

Duke identifikuar këto nevoja, ato mund të eksplorojnë duke i bërë palët të vlerësojnë se nëse ato do të takohen me palën tjetër, cilat pyetje dhe kërkesa do të donin t'i bënin. Kjo mund t'i bëjë ata të kuptojnë se historia stresante, që po dominon jetën e tyre, mund të përfundojë me bërjen e këtij takimi/takimeve. Me anë të këtij procesi angazhimi, secila palë nuk është më pasive, por bëhet një pjesëmarrëse aktive në procesin e drejtësisë.

Është shumë e rëndësishme, që moderatorët të mos tentojnë të bindin palët për të marrë pjesë dhe as nuk duhet t'i motivojnë ata. Ajo çfarë ata duhet të bëjnë, është të identifikojnë motivimin e secilës palë për të marrë pjesë.

Përveç një shpjegimi hyrës në fillim të takimit, moderatori në fillim duhet të identifikojë edhe nevojat apo kërkesat e palëve e më pas të japë detaje për procesin. Vetëm atëherë është e mundur që ai të përshkruajë sesi procesi restorativ mund të jetë i rëndësishëm për individin dhe ta aftësojë atë të marrë pjesë në këtë takim.

B Diskutim në grup: Në fund të pjesës teorike, bëhet diskutimi në grup bazuar mbi informacionin e dhënë, eksperiencat e pjesëmarrësve në rastet e përfshirjes së fëmijëve në masat e drejtësisë restauruese që prej fillimit të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

C Trajtim rasti:

Rasti 1:

Historia e fëmijëve

Danieli dhe Erjoni janë miq. Danieli është 16 vjeç dhe Erioni është 14 vjeç. Ata të dy kalojnë kohën duke larë makina dhe duke shëtitur me shokë në komunitetin e tyre deri në orët e vona.

Danieli ka më shumë vetëbesim, është agresiv dhe më guximtar se Erioni. Ai ndonjëherë ushtron bullizëm tek të tjerët, tek fëmijë në moshë më të vogël. Ai ka pasur një episod largimi nga shtëpia për të ikur nga dhuna që ushtron babai i tij. Ai ka një marrëdhënie të vështirë me familjen e tij. Ai ka mungesë besimi dhe respekti për të rriturit, sidomos me figurat autoritare. Ai është arrestuar disa herë për vjedhje. Më parë, ai dëshironte të bëhej elektrikist, por me kalimin e kohës nuk mendon më për këtë gjë. Familja e tij jeton në gjendje ekonomike të vështirë.

Erioni është po ashtu, nga periferia. Ai erdhi me familjen rreth 2 vjet më parë për të siguruar një jetë më të mirë. Prindërit e tij punojnë me orare të gjata dhe ai ka pak komunikim me ta. Ai është i ndrojtur, por me sens të mirë humori. Ai e shikon si model Danielin për shkak të tipit të tij. Atij nuk i pëlqen fakti se Danieli është agresiv me vajzat, por nuk i thotë gjë. Ai priret të bëjë atë që thotë Danieli dhe përpiqet ta ndjekë në çdo gjë.

Ngjarja:

Një ditë Danieli e merr me vete duke i thënë se do bëjnë një vjedhje në një dyqan rrobash. Pronari i kapi ata në dyqan. Gjatë përleshjes, Danieli nxori një thikë dhe e plagosi lehtë pronarin. Policia u njoftua. Danieli flet, ndërsa Erioni qëndron i heshtur.

Reflektime:

- 1 Çfarë mendoni për secilin rast nëse do të thirrshet si avokat?
- 2 Si mendoni se krimi ndikon këta dy fëmijë dhe familjet e tyre?
- 3 Cilët aktorë luajnë rol në këtë rast?
- 4 Çfarë duhet të keni parasysh kur punoni me këta fëmijë?
- 5 Cilat praktika të drejtësisë restauruese do të ishin të mundshme?

6 Kush duhet t'ia shpjegojë përgjegjësinë e tyre ndaj ligjit?

7 Cilët profesionistë do të angazhoheshin në këtë rast?

8 Ndaj cilit ndjeni më shumë simpati?

9 Kush ka pasur më shumë mundësi në jetë?

10 Kush ka më shumë përgjegjësi për veprimet e tij?

Rasti 2

Albani u referua në një proces të konferencës restauruese pasi kishte kryer vjedhje të shumëfishtë prone. Albani dhe nëna e tij shprehën shqetësimin sepse ata njihnin disa nga viktimat. Pas ndërmjetësimit familjar, Albani kuptoi se frika e tij, se viktimat do të ishin hakmarrës dhe të ashpër me të ishte e tepruar.

Vepra

Albani, është 16 vjeç, ai ka kryer disa vjedhje prone. Veprat e kryera prej tij në bashkëpunim me shokë të tjerë, kanë ndodhur në disa episode të ndryshme. Episodi i parë ishte në një dyqan pijesh, ai u identifikua nga pronari ndonëse mbante maskë. Të tjerat ndodhën në tre biznese ku vodhi disa sende. Albani u arrestua nga policia, u paraqit në gjykatë dhe iu dha një masë e drejtësisë restauruese. Para kësaj vepre, ai kishte përfituar një herë nga shmangja për shkak të një vepre tjetër. Masa e dhënë përfshinte pjesëmarrjen në drejtësinë restauruese, më konkretisht në një ndërmjetësim familjar. Katër viktima ishin të pranishme. Albani dhe nëna e tij ishin shumë nervozë ditën e parë, sepse i njihnin viktimat dhe për më tepër mendonin se ata do të ishin agresivë ndaj tyre. Moderatorin i siguroi se kjo do të ishte një procedurë e sigurtë. Albani shfaqti pendim dhe foli hapur për historinë. U bë edhe një paraqitje e pasojave të shkaktuara nga krimi jo vetëm tek viktimat, por edhe tek komuniteti.

Rezultatet

Ndërmjetësimi familjar përfundoi me Albanin që u kërkoi falje viktimave, dhe gjithashtu ndërmori disa hapa për riparimin e dëmit: si puna vullnetare, letër faljeje, rikthimi në shkollë, ndihma në familje. Një nga viktimat u shpreh se u lehtësua duke folur me autorin. Të gjithë i kërkuan Albanit marrjen e përgjegjësisë për këto veprime.

Reflektime:

- Si u ndikua komuniteti nga vepra?
- Cili do të ishte roli juaj?
- A është i mjaftueshëm vetëm ky proces i ndërmjetësimit familjar? Cilat veprime duhen kryer për referimin në shërbime të tjera?

Sesioni 3. Komunikimi avokat – i mitur

A Prezantim teorik

Specializimi i avokateve për të mitur

Avokatët që punojnë me fëmijët nuk është e nevojshme të jenë ekspertë psikologë,⁵⁰ por ata duhet të kërkojnë ndihmën e psikologëve sa herë që kjo është e nevojshme. Sidoqoftë, në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin është thelbësore që ata të kenë disa njohuri dhe të kuptojnë fazat zhvillimore dhe karakteristikat psikologjike të fëmijëve dhe adoleshentëve, ashtu sikurse u trajtua në temën e parë. Kjo njohuri i ndihmon ata të ndërveprojnë me klientët e tyre të rinj në mënyrë më efektive, të identifikojnë nevojat e tyre dhe të kuptojnë më mirë sjelljen e tyre. Mbrojtësit e fëmijëve kanë ndaj tyre të njëjtat detyrime dhe ndjekin të njëjtat parime etike sikurse ndaj klientëve të rritur, si besnikëria dhe konfidencialiteti. Megjithatë, për shkak se fëmijët kanë disa specifika unike, të cilat ndikojnë në natyrën e përfaqësimit, është i domosdoshëm trajnimi dhe specializimi i avokatëve.

Ndonëse adoleshenti në vendimmarrjen e tij mund të jetë i kufizuar për shkak të papjekurisë zhvillimore, këto kufizime kanë gjasa të reduktohen nëse atij i krijohet mundësia për këshillim dhe për t'u përfshirë në të menduarin e lirë. Të miturit marrin vendime më të mira kur informohen siç duhet, kur nuk vendosen nën stres dhe nën presionin e moshatarëve apo figurave autoritare.

Proceset ligjore dhe procedurat gjyqësore mund të jenë shumë komplekse që të kuptohen edhe nga të rriturit. Prandaj, avokatët duhet të jenë të ndërgjegjshëm se si stadet zhvillimore të adoleshencës dhe cilësi të tjera si papjekuria, ndikojnë klientin e ri, mënyrën e të kuptuarit, arsyetimin dhe vendimmarrjen e tij. Për këtë arsye, avokati duhet të dijë të udhëzojë klientin e ri mbi konceptet e vështira ligjore dhe ekstraligjore që shfaqen gjatë përfaqësimit, në mënyrë që klienti të mund të marrë pjesë në mënyrë domethënëse në mbrojtjen e tij. Në këtë detyrë, avokati mund të ndihmohet nga psikologu asistues.

• **Kujdes: kur klienti fëmijë është viktimë e traumës:**

Në disa raste, ju mund të keni klientë që kanë përjetuar trauma. Trauma mund të ndikojë aspektet bazike të marrëdhënies avokat – klient. Historia e traumës mund të vështirësojë vendosjen e besimit dhe përfshirjen e klientit në çështje. Po ashtu, trauma mund të ndikojë zhvillimin konjitiv e psiko-social të fëmijës, mënyrën si mendon, si e përpunon informacionin dhe si komunikon me të tjerët. Pra, për rrjedhojë ajo ndikon procesin e intervistimit dhe shpjegimet për çështjen. Këta të rinj kanë nevojë për marrëdhënie të reja besimi dhe pozitiviteti për të sfiduar besimet negative që ata mund të kenë krijuar rreth marrëdhënieve ndërpersonale.

⁵⁰ The Impact of National Standards on Juvenile Defence Practice, American bar association, June 2013.

Gjithsesi, për avokatët, në këto raste, është e këshillueshme të konsultojnë burime të tjera të specializuara të profesionistëve të shëndetit mendor që punojnë direkt me klientët fëmijë për të kuptuar më mirë eksperiencat e klientit me traumën.⁵¹

Avokati që punon me të miturit duhet të mbajë në vëmendje këto katër çështje kryesore:

- Të kuptuarit e zhvillimit në adoleshencë nga perspektiva ligjore dhe psikologjike;
- Çështjet e komunikimit, konsultimit dhe konfidencialitetit;
- Çështje që lidhen me marrëdhënien prind – fëmijë;
- Çështje që lidhen me objektivat e përfaqësimit.

1. Të kuptuarit e zhvillimit në adoleshencë nga perspektiva ligjore dhe psikologjike

Duke iu referuar këtij moduli dhe kërkesave që duhet të plotësojë një avokat për fëmijët, rezulton e nevojshme që avokati të marrë njohuri specifike rreth zhvillimit të të miturit për shkak të karakteristikave unike të klientit të tij fëmijë. Së pari, kjo e lejon avokatin të krijojë pritshmëri realiste rreth klientit të tij dhe marrëdhënies me të. Së dyti, kjo njohuri i jep avokatit një mundësi për të kuptuar vështirësitë e fëmijës në procesin e pyetjeve, intervistimit, perceptimit të realitetit dhe mënyrës së shprehjes së tij. Gjithashtu, kjo jep mundësi për të përcaktuar vlerën që i duhet dhënë dëshmisë së fëmijës kur kërkohet një gjë e tillë. Pa këto njohuri, avokati nuk mund të komunikojë në mënyrë efektive me klientin dhe nuk mund të mbrojë interesat e tij. Pavarësisht kësaj, në këtë detyrë, ai do të mbështetet edhe nga komunikimi me ekspertë të tjerë.

2. Çështjet e komunikimit, konsultimit dhe konfidencialitetit

Marrëdhënia me të miturin do të bazohet tek komunikimi. Hapi i parë është takimi dhe vendosja e këtij komunikimi, pavarësisht moshës së fëmijës. Krijimi i besimit është thelbësor në këtë marrëdhënie dhe kjo vendoset vetëm gradualisht, pasi avokati tregon qëndrueshmëri dhe përkushtim në punën e tij. Konfidencialiteti është po ashtu, i rëndësishëm në marrëdhënien me klientin fëmijë. Shpesh është e vështirë për të arritur këto elemente në marrëdhënie, për shkak se këta të mitur janë zakonisht mosbesues ndaj të rriturve. Dilema ka edhe në rastet kur fëmija ndan me avokatin informacione që janë në interesin më të lartë të fëmijës të bëhen të ditura, si p.sh. abuzimi nga prindërit. Rregulli i përgjithshëm është se, avokati duhet të marrë pëlqimin e fëmijës për ndarjen e informacionit, megjithatë risku i dëmtimit dhe abuzimit të fëmijës është një situatë e veçanta në të cilën avokati mund të vendosë ta ndajë informacionin, kur ai vlerëson se fëmija është në rrezik.

3. Çështje që lidhen me marrëdhënien prind – fëmijë

Konfuzioni social rreth vlerës së thënieve të fëmijës dhe raportit me prindërit, nuk duhet të bëjë që fëmijët të mbeten konfuzë edhe në raport me marrëdhënien me avokatin. Të fuqizosh fëmijët nënkupton se avokatët duhet të mësojnë si të dëgjojnë dhe t'i shohin ata për atë çfarë janë: *individë unikë që rriten në një shoqëri që priret të zhvlerësojë mendimin e tyre*. Duke i trajtuar fëmijët si klientë, avokati nevojitet të jetë i vetëdijshëm se i sheh fëmijët nga botëkuptimi i një të rrituri dhe kjo e pengon t'i shohë fëmijët si burim informacioni.⁵² Një avokat në çdo rast, duhet të përpiqet të krijojë një marrëdhënie pozitive, bashkëpunuese dhe mbështetëse me prindërit e fëmijës, duke mbajtur gjithmonë në vëmendje se klienti i tij është fëmija dhe jo prindi. Pavarësisht moshës së fëmijës, interesi më i lartë dhe opinioni i fëmijës duhet të jenë konsiderata më e rëndësishme. Avokati në çdo rast, duhet të përpiqet t'i shpjegojë fëmijës këndvështrimin e tij në rast se kanë mospërputhje.

Në shumë raste, prindërit duhet të lejojnë që avokati të flasë vetëm me fëmijën duke respektuar privatësinë e tij. Avokati duhet të jetë i përgatitur për mundësinë që klienti fëmijë mund të manipulohet nga të rriturit, prindër apo të tjerë.⁵³ Në rast se kontradiktat bëhen të pazgjidshme, e sidomos kur avokati është zgjedhur dhe paguar privatisht nga prindërit, atëherë një avokat tjetër i pavarur nga i pari, mund të zgjidhet për të përfaqësuar fëmijën. Nëse marrëdhënia vazhdon, avokati duhet të sigurohet se pagesa nuk ndikon në gjykimin e tij profesional dhe se ai vijon të mbrojë informacionin konfidencial për fëmijën.⁵⁴ Shpesh prindërit kanë interesa që bien në kundërshtim me ato të fëmijës. Prindërit shpesh flasin në emër të fëmijës. Edhe vetë avokatët shpesh flasin me prindin më shumë se me fëmijën, sepse mendojnë se prindi është i rritur dhe kupton më mirë, se fëmija mund të ketë ndonjë vështirësi për të folur, se ndjehen më komodë kur flasin me një të rritur, pasi informacioni është kompleks për fëmijën apo fëmija ndjehet më vulnerabël, ose gjithashtu, është nën presionin e faktorit kohë e kufizuar dhe para, pasi të flasësh me fëmijën kërkon më shumë dedikim dhe energji në terma kohe.

4. Çështje që lidhen me objektivat e përfaqësimit

Një tjetër çështje që ngrihet kur avokati përfaqëson fëmijën, është se kush i përcakton objektivat e përfaqësimit. Avokatët e fëmijëve kanë dilema kur këndvështrimi i tyre për interesin më të lartë të fëmijës bie në kundërshtim me dëshirat e fëmijës lidhur me objektivat e përfaqësimit.

Në një situatë të tillë, avokatët përballen me dilemën nëse duhet të përfaqësojnë dëshirat e fëmijës apo interesin më të lartë të fëmijës. Përgjigja është komplekse, dhe varion për shkak të shumë elementeve si juridiksioni, tipi i procedimit, detyra që i është dhënë avokatit dhe pjekuria e fëmijës.

Një zgjidhje e dilemës për avokatët është që të përdorin rolin e tyre si këshillues për të bindur klientin dhe për

⁵² Voices Lost and Found: Training Ethical Lawyers for Children William A. Kell Cornell Law School

⁵³ Guidelines on child-friendly legal aid Unicef Ecaro, October 2018

⁵⁴ Rights & Duties: An Overview of the Attorney Child Client Relationship Marvin R. Ventrell Attorney, Executive Director of the National Association of Counsel for Children

të sjellë në të njëjtin drejtim dëshirat me interesin më të mirë. Pjesë e punës së avokatit, si kur përfaqëson të rritur ashtu edhe kur përfaqëson fëmijë, është të arsyetojë me klientin, t'i shpjegojë pse klienti po merr një vendim të gabuar dhe t'i parashtrijë të gjitha alternativat duke ia shpjeguar ato. Kjo gjë zbatohet edhe për fëmijët. Nëse avokati ka vendosur një marrëdhënie besimi dhe punon në mënyrë të vazhdueshme me fëmijën, këto konflikte kanë gjasa të zbehen.

Avokatët duhet të përdorin aftësitë e tyre komunikuese dhe këshilluese për t'i ndihmuar klientët të zgjedhin rrugën më të përshtatshme, edhe pse nuk mund të vendosin për rezultatin. Për të zgjidhur këtë dilemë, është e nevojshme gjithashtu, që avokatët të qartësojnë që në fillim detyrën që kanë ndërmarrë.⁵⁵ Një vendim i bazuar në të kuptuarit gjithëpërfshirës të fëmijës dhe të situatës së tij, kërkon vlerësime dhe ndërhyrje nga profesionistë të trajnuar të disiplinave të ndryshme, si psikologë, punonjës socialë, psikiatër, edukatorë, avokatë, etj. Në rastin kur fëmija i nënshtrohet drejtësisë penale, atëherë këto shërbime ndihmojnë gjykatën në procesin e vendimmarrjes për interesin më të lartë të fëmijës.⁵⁶ Fëmija i përfshirë në sistemin e drejtësisë do të takojë gjatë procesit penal shumë profesionistë të ndryshëm. Avokatët nuk mundën që të promovojnë të vetëm të drejtat e fëmijës, prandaj duhet të bashkëpunojnë me një seri profesionistësh të tjerë të parashikuar edhe nga KDPM siç janë: oficerët e policisë, prokurorët, gjyqtarët, përkthyesit, punonjësit socialë, psikologët, specialistët e Shërbimit të Provës, NJMF, etj. Për këtë, avokati duhet të dijë si funksionon sistemi dhe të ndërveprojë në mënyrë efektive me secilin prej tyre dhe t'ia shpjegojë edhe fëmijës këtë gjë. Duke qenë se avokati mund të jetë një nga personat e parë që fëmija kontakton pasi hyn në kontakt me sistemin e drejtësisë, ai duhet t'i shpjegojë fëmijës rolin e secilit aktor të përfshirë. Po ashtu, bazuar në faktin se tashmë fëmija në konflikt me ligjin nuk trajtohet vetëm nga sistemi i drejtësisë, por edhe nga strukturat e shërbimeve sociale (Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës) ai duhet të jetë në dijeni të rolit të tyre dhe shërbimeve që ofrohen në komunitetin ku ai operon.

Komunikimi me klientin fëmijë

1 Aspekte praktike

- a Jini të vetëdijshëm për kohën, stresin dhe lodhjen që ndikon në aftësinë e fëmijës për të marrë pjesë;
- b Shpjegojini fëmijës se është në rregull nëse ata nuk dinë përgjigjen e pyetjes;
- c Bëni kujdes me gjuhën e përdorur dhe tonin e zërit;
- d Mbani parasysh se fëmijët nuk mund të dëshmojnë me të njëjtën saktësi si të rriturit;
- e Sigurohuni që në seancë të ketë sa më pak njerëz.

⁵⁵ Rights & Duties: An Overview of the Attorney Child Client Relationship Marvin R. Ventrell Attorney, Executive Director of the National Association of Counsel for Children.

⁵⁶ Guidelines on children in contact with the justice system, Adopted by the Council of the IAYFJM London, October 21st, 2016

Orientime për sallën e gjyqit

Salla e gjyqit është një ambient aspak familjar për fëmijët. Shumë vende rekomandojnë që fëmija të vijë fillimisht e të shohë një sallë gjyqi të zbrazur për t'u ambientuar me mjedisin para zhvillimit të seancës, në mënyrë që të eksplorojnë ambientin e të njihen me të.

2. Si të komunikojmë?:

- a) merrni kohë të krijoni marrëdhënien;
- b) dëgjoni klientin dhe angazhohuni në dialog;
- c) respektoni individualitetin e tij;
- d) jeni të vetëdijshëm se disa klientë mund ta shohin avokatin më shumë si një të rritur që i mbron sesa vërtet si avokat;
- e) siguroni konfidencialitetin.

Është OK nëse fëmijët thonë “është OK” apo “nuk më kujtohet”.

Është e papërshtatshme:

- a) të mungoni vazhdimisht në takime ose të jeni me nxitim;
- b) të mbani një sjellje jomiqësore dhe jo fort të interesuar;
- c) të përqendroheni vetëm tek ajo që ka ndodhur, dhe jo edhe si ndjehet fëmija.

Të dëgjuarit – metoda për të treguar se ju po i dëgjoni:

- Joverbale: shprehja e fytyrës, kontakti me sy, gjuha e trupit;
- Verbale: tinguj pozitiv (mmm, aha, etj.), toni i zërit, pyetje të hapura e të mbyllura, perifrime, përmbledhje, reagime, etj.

Faktorët që ndikojnë në mjedisin miqësor

Mjedisi fizik

- Dhoma është e ajrosur dhe e rehatshme;
- Ka ngjyra dhe postera;
- Karrige në masë të përshtatshme;
- Fëmija lejohet të ulet me kë dëshiron;
- Ambienti është i sigurtë dhe dhoma është private, nuk ka hyrje e dalje.

Masa

- Fëmijës mund t'i jepen fletëpalosje;
- I jepet mundësia të bëjë pyetje;
- I ofrohet ujë apo pije freskuese.

Mbështetja

- Fëmija ndihmohet nga prindi mbështetës;
- Të rriturit vishen në mënyrë të përshtatshme;
- Komunikim me ndjeshmëri për fëmijën.

Logjistika

- Informohet më parë për vendin dhe kohën;
- Nëse takimi do të zgjasë, sigurohen pushime;
- Pritja minimizohet;
- Kufizohet komunikimi i fëmijës me njerëz jo miqësorë.

Vendosja e besimit

Vendosja e besimit me klientin fëmijë është një çështje themelore. Fëmija mund të jetë konfuz në takimin e parë me ju dhe shpesh edhe gjeste të vogla shpërfillëse nga ana juaj mund të ndikojnë në besimin që ai do të krijojë ndaj jush. Gjithashtu, tregoni edhe interes ndaj tyre për t'i njohur si persona.

Dhënia e përshtypjes se jeni i ngarkuar, se keni shumë punë e nuk keni kohë, se kjo është një çështje si shumë të tjera, ndikon negativisht në besimin e fëmijës tek ju. Biseda fillon me tema neutrale, lërinini edhe t'iu bëjnë pyetje e më pas, ju i bëni atyre pyetje, fillimisht të hapura.

Më specifikisht lidhur me vendosjen e besimit merrni parasysh:

1 *Jepini fëmijëve më shumë kohë dhe hapësirë për t'iu njohur dhe besuar.* Fëmija mund të dojë të ndajë informacion me ju që në takimin e parë, por merrni parasysh faktin se ju jeni një i panjohur për të dhe do të ishte më mirë të fillonit me ndarjen e disa informacioneve bazë, duke mos shkëmbyer apo kërkuar informacione të mëtejshme. Pranoni se kjo qasje do të kërkojë kohë, por do të rezultojë më shumë produktive për çështjen në terma afatgjatë. Është më e lehtë të filloni duke shpjeguar rolin tuaj dhe si punoni e si do të bashkëpunoni me të gjatë procesit ligjor. Kjo do të ofrojë siguri për fëmijën se ju jeni aty për të përfaqësuar fëmijën dhe jo pjesë e një sistemi armiqësor.

2 *Shmangni supozimet rreth fëmijës duke u bazuar në raste të ngjashme me të cilat keni punuar. Trajtojini si individë që kanë një histori personale për të treguar. Jepini fëmijës më shumë mundësi të flasë lirisht dhe në përgjithësi, rreth shqetësimeve, frikërave dhe dëshirave dhe shprehjes së emocioneve. Kjo sigurisht nuk ju ndihmon menjëherë duke ju dhënë rezultat direkt.*

3 *Avokatët mund të nënvlerësojnë ndikimin e gjesteve të vogla verbale e joverbale në marrëdhënien me fëmijën. Ofrimi i një filxhani çaj, toni i butë i zërit, qëndrimi i ngrohtë, interesimi për çfarë ndodh me jetën e fëmijës jashtë procesit ligjor, janë të gjitha detaje që ndikojnë pozitivisht në marrëdhënien me fëmijën dhe në vendosjen e besimit.*

Elementet kyçe në dëgjimin e fëmijëve

1 *Bëjini të qartë të gjithë të interesuarve se cili është klienti tuaj. Nëse klienti juaj është fëmija, ju dhe të rriturit duhet të jeni të vetëdijshëm për këtë në çdo kohë. Detyrimet tuaja profesionale janë të qarta në kuptimin se ju merrni në çdo kohë udhëzime nga klienti juaj. Edhe nëse kjo merr më shumë kohë dhe kërkon qasje më kreative.*

2 *Bëjeni të qartë se të rriturit që e shoqërojnë janë aty për të luajtur një rol mbështetës. Ata mund ta mbështesin fëmijën emocionalisht, të plotësojnë boshllëqe informacioni që fëmija nuk do ose nuk mundet t'i ofrojë, dhe të sigurojnë që fëmija kupton tërësisht procesin dhe këshillimin.*

3 *Rregulloni dhomën para takimit. Vendosni fillimisht fëmijën në pozicionin kryesor dhe uleni të rriturin tjetër në krah të tij.*

4 *Drejtohuni fëmijës kur flisni, jo të rriturit. Duhet në radhë të parë të mbani kontakt me sy me fëmijën, jo me të rriturin.*

5 *Në raste të caktuara, mund t'i kërkonti të rriturit të dalë nga dhoma që të keni mundësinë të merrni udhëzime direkt dhe më çlirët nga fëmija.*

Në rastet kur fëmija refuzon të flasë, mbani në vëmendje se e drejta e pjesëmarrjes është e drejtë dhe jo detyrim. Ajo mund të vijë nga mungesa e dëshirës, vullnetit ose paaftësia për t'u shprehur verbalisht, nga mbindjeshmëria, etj. Konsiderata parësore do të jetë interesi më i lartë i fëmijës, mirëqenia e tij emocionale. Kur fëmija nuk mundet për cilëndo arsye, të japë udhëzime për çështjen, sigurohuni që ai po merr

informacion për çdo detaj të çështjes, nëse keni vështirësi për ta bërë direkt këtë në gjuhën e fëmijës, atëherë bëjeni përmes një profesionisti.⁵⁷

Diskutim në grup: Në fund të pjesës teorike, bëhet diskutimi në grup bazuar mbi informacionin e dhënë, eksperiencat e pjesëmarrësve në rastet e sfidave në komunikimin me adoleshentët, konfidencialitetin dhe marrëdhënien me prindërit.

B Trajtim rasti:

Gerit është një djalë 15 vjeç. Ai e la shkollën 12 vjeç si pasojë e pamundësive ekonomike. Babai i ka vdekur, ndërsa nëna nuk ka një punësim të rregullt. Ai ka dy motra më të vogla. Gerit i është dashur të punojë në të zeze menjëherë pasi la shkollën, megjithatë jo gjithmonë arrin të gjejë punë dhe jo gjithmonë familja ka ushqim të mjaftueshëm. Një ditë, Gerit i kërkon e ëma të shkojë në dyqan për të marrë disa ushqime. Ai blen ushqimet që ajo e porositi, por gjithashtu vodhi edhe dy ushqime të tjera. Geri u ndalua dhe u dërgua në polici. Ai është i tronditur dhe qëndron i heshtur e nuk jep shumë shpjegime.

- Si ndikon krimi këtë familje?
- Kush duhet të luajë rol në këtë rast?
- Si do të vendosnit marrëdhënie me familjen?
- Cilat janë çështjet më të rëndësishme në rastin e tij? Si do të ndanit informacione me fëmijën? Si do të vendosnit marrëdhënie?
- Cilat janë mundësitë për shmangie?
- Kush duhet t'i shpjegojë çfarë do të ndodhë dhe si do t'i trajtoni ndjenjat e tij në këtë rast

⁵⁷ Komenti i Përgjithshëm Nr. 14 i Komitetit mbi të Drejtat e Fëmijëve (paragrafi 32): "... koncepti i interesit më të lartë të fëmijës është fleksibël dhe i ndryshueshëm. Ai duhet përshtatur dhe përkufizuar në baza individuale, sipas situatës specifike të fëmijës, duke marrë në konsideratë kontekstin, situatat dhe nevojat personale. Për vendime individuale, interesi më i lartë i fëmijës duhet vlerësuar dhe përcaktuar duke pasur parasysh rrethanat specifike të fëmijës. Udhëzuesi për drejtësinë miqësore me fëmijës (parimet bazë) në vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës ose fëmijëve të përfshirë: (a) të shprehin këndvështrimet dhe opinionet e tyre; (b) të gjitha të drejtat e tjera të fëmijës, si e drejta për dinjitet, liri dhe trajtim të barabartë, duhen respektuar në çdo kohë; (c) një qasje gjithëpërfshirëse duhet përdorur nga autoritetet në mënyrë që të merren parasysh të gjitha interesat duke përfshirë atë psikologjik dhe mirëqenien fizike dhe ligjore, interesin social dhe ekonomik të fëmijës.

Udhëzuesi për drejtësinë miqësore me fëmijës (parimet bazë) A (1) (1) E drejta e të gjithë fëmijëve për t'u informuar mbi të drejtat e tyre, për t'iu ofruar mënyrat e përshtatshme për të pasur akses në drejtësi dhe për t'u konsultuar dhe dëgjuar në proceset ku janë të përfshirë ose që ndikojnë mbi ta, duhet respektuar. Kjo përfshin që mendimet të fëmijës t'i jepet pesha e duhur, duke marrë parasysh pjekurinë e tyre dhe çdo vështirësi komunikimi që ata mund të kenë për të marrë pjesë në mënyrën e duhur. (2) Fëmijët duhen marrë në konsideratë dhe trajtuar si mbajtës të plotë të të drejtave dhe duhet të kenë të drejtën t'i ushtrojnë të gjitha të drejtat e tyre në një mënyrë që merr parasysh aftësinë e tyre për të formuar mendimet e tyre dhe rrethanat e çështjes.

Sesioni 4. Qasja shumëdisiplinore në drejtësinë miqësore për të mitur

Këndvështrimi psikologjik mbi rolin e shërbimeve sociale dhe psikologjike në drejtësinë për të mitur

A Prezantim teorik

Një tjetër risi që solli Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur është që sistemi i drejtësisë për të mitur të shikohet në mënyrë integrale dhe shumëdisiplinore. Shërbimet sociale, arsimore, policia e shtetit, shërbimi i provës e prokuroria, duhet të bashkëpunojnë jo vetëm në parandalimin, por edhe në përcaktimin e masave restauruese më të përshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin, viktimë apo dëshmitarë dhe sidomos për rehabilitimin e tyre. Sa herë që një fëmijë apo adoleshent, qoftë ai/ajo viktimë apo shkelës i ligjit, vjen në sistemin e drejtësisë, është shumë e rëndësishme që të ketë procedura të përshkruara mirë, të cilat zbatohen kur çdo profesionist luan rolin e tij/saj.

Gjithashtu, rezultate pozitive arrihen vetëm kur një fëmijë apo adoleshent viktimë, vëren se profesionistët e përfshirë në sistemin e drejtësisë e trajtojnë atë me respekt, i njohin dëmin që i është shkaktuar dhe kërkojnë zgjidhjen më të mirë të mundshme për ta kthyer viktimën në rrugën e një zhvillimi të harmonishëm. E njëjta gjë është e vlefshme edhe për të rinjtë në konflikt me ligjin.

Roli i Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës

Bashkëpunimi me shërbimet sociale dhe veçanërisht me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës, i jep avokatit më shumë informacion rreth klientit fëmijë, të cilin ai po mbron.

Kur avokati bashkëpunon me NJMF, klienti ka më shumë gjasa të marrë shërbimet e duhura sociale, që i lejojnë edhe gjykatës të marrë masa më të lehta për fëmijën. Një qasje shumëdisiplinore në procedimet e drejtësisë për të mitur çon në parandalimin e kryerjes së veprave penale në moshë të rritur.

Bazuar në KDPM, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës përfshihet në disa faza të procedimit penal ku merr pjesë i mituri mbi 14 vjeç. Kështu, duke iu referuar tipologjisë së veprimeve dhe përgjegjësive, roli i NJMF mund të ndahet në tre faza: I. Gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale; II. Gjatë ekzekutimit të dënimit/masës penale; dhe III. Riintegrimin të të miturit.

Gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale, roli i NJMF është **orientues dhe këshillues** për disa profesionistë. *Më specifikisht: Gjatë kryerjes së vlerësimit*, punonjësi i NJMF informon dhe këshillon ekspertin e caktuar nga prokuroria/gjykata për kryerjen e vlerësimit. Po ashtu, avokati mund të konsultohet

me PMF për marrjen e të dhënave mbi mjedisin social-ekonomik, arsimimin e fëmijës e të dhëna të tjera të veçanta që mund t'i shërbejnë atij për mbrojtjen e klientit të mitur.

Aktorë të tjerë që mund të përfshijnë NJMF në një proces konsultimi janë: *Prokuroria, gjykata apo ndërmjetësit për proceset e shmangies/ndërmjetësimit*. Nëse palët japin pëlqimin, NJMF mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit, dhe po ashtu, edhe në shmangie. NJMF mund të ndihmojë procesin duke i ofruar prokurorit/gjyqtarit/ndërmjetësit/prindit/të miturit mendimin e saj në këtë proces.

Gjithashtu PMF përfshihet në koordinimin e veprimeve për zbatimin e disa masave që jepen me shmangien (VKM 207, datë 10.04.2019). Ndërsa gjatë ekzekutimit të dënimit/masës penale, PMF përfshihet po ashtu, në hartimin dhe sigurimin e përmbushjes së planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit. Sërish, avokati duke përfaqësuar të miturin mund të jetë pjesë e konsultimeve lidhur me përmbajtjen e planit të rishoqërizimit. Avokati duhet t'i shpjegojë fëmijës në një mënyrë të përshtatshme për moshën, dënimin apo masën alternative të drejtësisë restauruese që ka dhënë gjykata, dhe po ashtu, edhe të drejtën e apelit.

Gjatë riintegrit të të miturit, KDPM ka parashikuar se PMF duhet të sigurohet që pas daljes nga institucioni, të miturit t'i ofrohet siguri, si elementi kyç, e shoqëruar edhe me plotësimin e nevojave bazë jetësore: strehim, veshje, etj, dhe po ashtu, ofrimi i shërbimeve të specializuara. PMF në këtë moment, falë angazhimit në fazën e mëparshme, e referon të miturin në shërbime të specializuara që ndryshojnë sipas nevojave të rastit, dhe po ashtu, edhe për t'u përfshirë në aktivitete të ndryshme.

Roli i psikologut sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur

Bazuar në KDPM, funksioni i psikologut ndahet në dy role bazuar në detyrat që i ngarkohen.

Për herë të parë, Kodi diferencon:

a) Rolin e psikologut si asistues i të miturit gjatë procesit: ky psikolog është në funksion të sigurimit të mirëqenies emocionale dhe mbështetjes së të miturit.

b) Rolin e psikologut si ekspert vlerësues në drejtësinë penale për të mitur Ndërsa psikologët në kontekste të tjera, punojnë në shërbim të klientit, me qëllim përmirësimin e mirëqenies së tij (*të miturit në konflikt me ligjin*), psikologu ligjor vlerësues është në shërbim të gjyqtarit, prokurorit, avokatit apo institucionit i cili kërkon një vlerësim prej tij.

Psikologu ligjor asiston institucionet e drejtësisë teksa ata do të marrin vendime rreth të miturve të përfshirë në sistemin e drejtësisë përmes të dhënave për funksionimin fizik, konjitiv, të sjelljes dhe atë emocional.⁵⁸

a) Roli i psikologut si asistues i të miturit gjatë procesit

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përcakton parimin e pjesëmarrjes së detyrueshme të psikologut gjatë të gjithë procedimit penal.

Kur thirret psikologu për të asistuar të miturin?

Kreu II "Parime të drejtësisë penale për të mitur", neni 18, parashikon se:

- *Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme.*
- *Psikologu garanton, mbështetjen psikologjike të të miturit dhe vlerëson thëniet e tij, në përputhje me zhvillimin mendor.*

Prania e psikologut synon që të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi.

Prania e psikologut është e detyrueshme në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha;

Në këtë kuptim, psikologu asistues është pjesëmarrës gjatë gjithë procesit, ku i mituri merr pjesë dhe është në shërbimin e tij. Avokati mund të bashkëpunojë me psikologun asistues në: komunikimin me të miturin dhe shpjegimin në një gjuhë të përshtatshme për të, të koncepteve dhe termave të ndryshme rreth procesit ligjor, konsultimin me psikologun lidhur me gjendjen emocionale të të miturit gjatë procesit, dhe po ashtu, lidhur me çështje që kanë të bëjnë me intervistimin e të miturit.

Kur thërret një psikolog asistues, kini parasysh që:

- Në veprimet që do të kryhen me të miturin gjatë procesit hetimor, të sigurohet prania e të njëjtit psikolog asistues gjatë gjithë procesit të drejtësisë penale për të mitur, por vetëm nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit;
- Psikologu asistues nuk mund të thirret për të marrë rolin e ekspertit, duke përgatitur vlerësim psikologjik për të njëjtin të mitur;

- Ndihma psikologjike është një e drejtë që i mituri e gëzon në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale për të mitur (bazuar në Nenin 19 më konkretisht pika a);
- Psikologu asistues do të ofrojë ndihmë pa pagesë për të miturin gjatë gjithë procesit penal (Neni 20) dhe pagesa e tij mbulohet nga shteti;
- Psikologu asistues do të jetë i pranishëm në çdo fazë që do të intervistohet i mituri viktimë/dëshmitar apo në çdo komunikim me të;
- Psikologu asistues është një nga personat me anë të të cilëve mund të bëhet njoftimi i të miturit viktimë apo dëshmitar, në rast konflikti interesi me përfaqësuesin e vet ligjor, ose kur për shkak të moshës shumë të mitur nuk mund të bëhet njoftimi i drejtpërdrejtë i të miturit (Neni 38/2);
- Psikologu asistues mund të marrë pjesë gjatë seancave të komunikimit me të miturin edhe në procesin e ndërmjetësimit (Neni 64/4), por më parë do të merret pëlqimi i palëve të përfshira.

Cili është roli i psikologut asistues në procesin hetimor?

Psikologu asistues do të thërritet me qëllim që ai të mbështesë të miturin psikologjikisht dhe emocionalisht gjatë gjithë procesit të marrjes në pyetje, intervistimit apo veprimeve të tjera procedurale.

Pjesëmarrja në një proces gjyqësor sidomos prezenca në një sallë gjyqi është një fakt stresues për një fëmijë. Pyetja e fëmijës në një sallë gjyqi e po ashtu edhe në zyrë, apo ambientet e policisë shoqërohet me ankth, konfuzion, frikë e shqetësim për një fëmijë, sidomos për ata, të cilët nuk kanë një informacion të qartë për një proces hetimor apo gjyqësor dhe vijnë aty për herë të parë. Pra, nëse fëmijët nuk përgatiten paraprakisht, ata mund të mos e kuptojnë procesin. Psikologu mund të ndihmojë që atyre t'u shpjegohet:

- Çfarë është një zyrë gjyqtari, prokurori apo komisariati?
- Cilët njerëz ndodhen aty dhe cili është roli i tyre?
- Parapërgatitja nuk e ndihmon fëmijën vetëm nga ana psikologjike, por gjithashtu e ndihmon atë të japë një informacion më të saktë përpara gjykatës.

Sigurohuni që përmes psikologut të miturit t'i jenë shpjeguar detaje të nevojshme mbi pjesëmarrjen e tij në proces, si: Çfarë ndodh në një sallë gjyqi? Cilët janë palët? Cili është roli i gjyqtarit, prokurorit, avokatit?

• Faza përgatitore

Kini parasysh t'i jepni psikologut mundësinë që të krijojë një njohje paraprake me të miturin duke u takuar vetëm me të, në një mjedis të përshtatshëm ose të përshtatur për të miturin. Sado e kufizuar të jetë koha juaj

për të mundësuar këtë fazë përgatitore, ky hap nuk duhet anashkaluar, madje edhe në seancat e masës së sigurisë, ku në përgjithësi kjo fazë kapërcehet për shkak të emergjencës së gjykimit.

Kjo do të shërbejë që psikologu të marrë informacionin bazë për të miturin, që lidhet me të dhënat mbi historinë e tij familjare, shkollimin, komunitetin, probleme të mundshme të shëndetit, historikun e problemeve të mëparshme me ligjin, nivelin e zhvillimit dhe gjendjen e tij emocionale. Kjo fazë paraprake i shërben psikologut për të kuptuar nëse i mituri është në gjendjen e duhur për të përballuar procesin e intervistës, por gjithashtu, krijon një njohje paraprake që shërben për vendosjen e besimit.

Në këtë fazë, psikologu i referon avokatit, prokurorit apo gjykatës, elemente të caktuara që lidhen me gjendjen e të miturit, që e bëjnë të mundur apo të vështirë vijimin e procesit. Referimet në shërbime të tjera mbështetëse janë thelbësore në këtë fazë, sidomos nëse nuk janë kryer më parë. Mundësia e shtyrjes së intervistës apo seancës është gjithashtu, një alternativë në këtë moment, sidomos në rastet kur i mituri është viktimë e një veprë penale, kur ngarkesa emocionale është më e madhe dhe procesi mund të zgjasë përtej parashikimeve.

Si do të përgatitet i mituri për intervistë/apo marrjen në pyetje?

Nuk është e domosdoshme që ky proces të kërkojë shumë kohë. Informacioni bazë në lidhje me qëllimin e intervistës, rolin e secilit pjesëmarrës në dhomën e intervistës, vendin, kohëzgjatjen mesatare, strukturën e intervistës, i duhet dhënë të miturit që në fillim. Po ashtu, psikologu do të sqarojë çdo pyetje apo paqartësi që i mituri ka në lidhje me procesin.

Në këtë fazë ka rëndësi:

- Të sigurohemi që vendi të jetë i përshtatshëm për pyetjen e një të mituri, e po ashtu, të mos ketë persona të tjerë që hyjnë dhe dalin nga dhoma;
- Të konsultohet psikologu për marrjen në pyetje nga avokati/prokurori/gjyqtari duke diskutuar mbi listën e pyetjeve që keni planifikuar t'i drejtoni të miturit përpara intervistës apo marrjes në pyetje të tij, pasi kështu do të lehtësohet dhënia e dëshmisë dhe do të eliminohet frika apo ndrojtja.

Intervistimi/Marrja në pyetje

Ju, palët dhe gjykata do të keni mundësi të konsultoni me psikologun pyetjet tuaja paraprakisht, por nëse nuk e keni bërë këtë paraprakisht apo nëse dalin gjatë intervistës pyetje të pakonsultuara më parë, kini parasysh:

- Mos bëni pyetje me zgjedhje të detyruara, mos bëni pyetje të shumëfishta, mos bëni pyetje sugjestionuese. Shmangni ato lloj pyetjesh që dëmtojnë ndërveprimin me të miturin dhe ndikojnë negativisht në gjendjen emocionale të tij/saj;
- Psikologu mund të ndërhyjë gjatë procesit për të lehtësuar komunikimin mes autoritetit përkatës që drejton seancën dhe fëmijës, në çdo rast kur fëmija ka vështirësi për të kuptuar pyetjet e palëve ose gjykatës;
- Psikologu mund të sugjerojë momente të ndryshme gjatë intervistës kur duhen bërë pushime;
- Në mënyrë të veçantë, kur fëmijët janë në pozitën e viktimës, ata mund të përjetojnë një gjendje emocionale të tillë, që vështirëson rrëfimin dhe kjo mund të bëjë që të ketë bllokime dhe pushime të shpeshta, duke bërë që intervista të zgjasë përtej parashikimeve.

b) Roli i psikologut si ekspert vlerësues në drejtësinë penale për të mitur

Direktiva (BE) 2016/800 nuk specifikon ndonjë rol të veçantë për avokatin në raport me kryerjen e vlerësimit individual. Sidoqoftë, derisa rezultatet e këtij vlerësimi kanë potencialin për të qenë në thelb të pasojave të procesit dhe vendimit, avokatët duhet të kenë mundësinë të përfshihen në të. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që vlerësimi kryhet në mënyrën më të mirë të mundshme dhe reflekton nevojat dhe karakteristikat individuale.⁵⁹

Për rrjedhojë, sa herë kryhet vlerësimi i të miturit, avokati duhet:

- Të verifikojë që vlerësimi po kryhet në mënyrën e duhur;
- Të sigurojë që vlerësimi merret parasysh në masat dhe veprimet që do merren ndaj të miturit, përfshirë edhe në vendim;
- Të dijë kur dhe si të përdorë të dhënat e vlerësimit;
- Të sigurohet se një psikolog i licencuar dhe i përfshirë në listën e ekspertëve ka qenë pjesë e vlerësimit.

Psikologu vlerësues në ndryshim nga asistuesi nuk qëndron gjatë gjithë procesit në ndihmë të të miturit. Ai përfshihet në proces për t'i ardhur në ndihmë institucionit që e kërkon vlerësimin, për ta ndihmuar në vendimmarrje.⁵⁹

Çfarë njohurish bazë duhet të ketë avokati lidhur me rolin e psikologut vlerësues dhe detyrat e tij

II. Kur thirret në procedim një psikolog si ekspert vlerësues?

Prokurori mund të thërrasë një ekspert apo një grup ekspertësh në varësi të të dhënave që i duhet të marrë, për të kryer vlerësimin individual psikologjik të të miturit, që fokusohet në vlerësimin e rrethanave individuale, shëndetësore, familjare, sociale dhe mjedisore të të miturit, në mënyrë që të kuptojë personalitetin, përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë së tij, (neni 22).

Prokurori kërkon në mënyrë të detyrueshme këtë raport kur:

- Përcaktohet masa alternative e shmangies (neni 47/4/a);
- Caktohet lloji i dënimit (neni 47/4/a, b);
- I mituri nuk përmbush masat alternative të shmangies (rivlerësim psikologjik, neni 72/3).

Kush thirret për kryerjen e vlerësimit? Neni 47(KDPM): 1. Ekspert apo grup ekspertësh, ose 2. Specialisti i shërbimit të provës.

Kodi ka përcaktuar pyetjet referuese që i jepen psikologut në përgatitjen e këtij raporti vlerësimi, të cilat janë:

- Të përshkruajë rrezikun e kryerjes së veprës penale, karakteristikat e personalitetit të të miturit, të sjelljes dhe të nevojave të tij, përfshirë edhe nevojat e veçanta;
- Të rekomandojë masat e duhura për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e tij në shoqëri.

Për t'u mbajtur në vëmendje në lidhje me psikologun vlerësues

- Para se të nisë vlerësimi, i mituri duhet të informohet për qëllimin, natyrën dhe implikimet e mundshme të vlerësimit;
- Në varësi të fazës kur kërkohet vlerësimi, si dhe të faktit nëse ka pasur vlerësime të mëparshme, këto vlerësime i vihen në dispozicion psikologut, së bashku me çdo dokument tjetër shkresor për t'u mbajtur parasysh gjatë realizimit të vlerësimit;
- Nëse do të jetë e nevojshme, duhen bërë të mundura kontaktet midis psikologut dhe Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës. Jepini kohën e nevojshme ekspertit për kryerjen e vlerësimit;
- Psikologu duhet të ketë udhëzime të qarta se cilat janë çështjet ku duhet të fokusohet vlerësimi në mënyrë që ai t'u përmbahet këtyre pyetjeve. Megjithatë, gjatë vlerësimit, psikologu mund të paraqesë edhe të dhëna për çështje të tjera që nuk janë përfshirë në kërkesë si p.sh. abuzime me

fëmijën, etj. Nëse ai i ka identifikuar gjatë procedurës së vlerësimit dhe vlerëson se është në interesin më të lartë të fëmijës, këto të dhëna reflektohen në raportin e vlerësimit;

- Asnjë test psikologjik, asnjë procedurë, nuk ofron siguri që një individ i caktuar të ketë kryer ose jo një sjellje të caktuar. Shpesh vlerësimet psikologjike janë keqpërdorur e keqinterpretuar në vlerësimet ligjore;
- Në varësi të rastit, ju apo gjykata mund të keni pyetje të tjera, përveç atyre që ka parashikuar shprehimisht neni 47 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Raportimi i psikologut si ekspert në çështjet penale

Procesi i vlerësimit psikologjik finalizohet nëpërmjet raportit psikologjik me shkrim. Raporti duhet të përmbledhë procesin e vlerësimit duke bërë transparente:

- Cilat janë pyetjet e prokurorit, gjyqtarit apo avokatit?
- Cila është procedura e ndjekur?
- Cilat të dhëna janë mbledhur?
- Si ndikojnë ato te konkluzionet e vlerësuesit? (të përdoren referenca konkrete për të mbështetur konkluzionet, duke treguar se si janë arritur ato).

Psikologët janë të trajnuar që ta formulojnë raportin në mënyrë të tillë që t'i sigurojë kërkuesit informacionin që i duhet. Ata e dinë se gjuha e raportit duhet të jetë e thjeshtë dhe pa përdorim të terminologjisë që mund ta kuptojë vetëm një psikolog. Po ashtu, psikologët janë të përgatitur se për të mbështetur konkluzionet e tyre, ata duhet të përdorin referenca, fakte dhe ilustrime duke treguar se si janë arritur ato konkluzione.

Çfarë duhet të përmbajë raporti i vlerësimit psikologjik në çështjet penale?

Formati i raportit të vlerësimit psikologjik, në çështjet penale ku përfshihen të miturit, duhet të përmbajë të paktën:

- Të dhënat bazë për të miturin (gjeneralitetet);
- Pyetjet e ngritura, si dhe kush e kërkoi vlerësimin;
- Duhet të përmendet fakti se vlerësimi nuk është konfidencial, në kushtet kur ky vlerësim do të ndahet me prokurorin, avokatin dhe gjykatën;
- Metodologjia – përshkrimi i të gjitha burimeve të përdorura;
- Historia personale e të miturit;

- Dokumentacioni i dosjes;
- Burime të treta informacioni;
- Të dhëna nga vëzhgimi i të miturit, qëndrimi gjatë vlerësimit, gjendja mendore, funksionimi i tij i përgjithshëm, aspekte të ndryshme të zhvillimit etj;
- Të dhëna nga vëzhgime dhe teste, apo instrumente të tjera të përdorura, duke paraqitur edhe kufizimet e tyre (nëse përdoren, kërkoni certifikime për instrumentet e përdorur). Nëse ai evidenton elemente për të cilat nevojiten vlerësime të tjera (p.sh. vlerësimi nga një psikiatër) psikologu e reflekton këtë gjetje në rekomandimet e aktit të tij;
- Konkluzione dhe rekomandime.

Ndërkohë, në disa raste, psikologut mund t'i kërkohet të vlerësojë fëmijën viktimë të abuzimit seksual, fizik apo emocional. Faktorët, të cilët mund të influencojnë vlerën e informacionit të sjellë nga fëmija si rrëfim në një proces, përfshijnë:⁶⁰

- Moshën e fëmijës;
- Nivelin e zhvillimit konjitiv, social dhe emocional;
- Rikonstruktimin verbal të ngjarjes;
- Detajet (kujtesa për ngjarjen);
- Informacioni rreth ngjarjes i marrë nga njerëzit e tjerë (presioni potencial nga familja apo të tjerë);
- Raporti i vendosur me psikologun;
- Stili i intervistës dhe struktura e pyetjeve;
- Faktorët e personalitetit.

Kërkesa për dëmshpërblim në rastet e të miturve

KDPM në nenin 34, pika e, dhe po ashtu në nenin 58 pika 2, i referohet mundësisë së viktimës fëmijë për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar.

Padia në lidhje me dëmin fizik dhe psikologjik që vjen si pasojë e sjelljeve me dashje ose nga pakujdesia të dikujt, parashtron nevojën e mbledhjes së fakteve që do ta mbështesin ose refuzojnë padinë. Në këto kushte, avokati mund të kërkojë një ekspertim psikologjik nga një psikolog i specializuar.

Kontributi kryesor i psikologut në këto çështje, konsiston në ofrimin e opinioneve në gjykatë në lidhje me natyrën, shkaqet dhe pasojat e dëmit fizik dhe psikologjik.

⁶⁰ The Child Interview. Practice Guidelines, Maria Keller-Hamela Nobody's Children Foundation

Për të përcaktuar nëse pala paditëse është dëmtuar psikologjikisht nga dëmi i përjetuar, psikologut ligjor mund t'i nevojitet: Të eksplorojë funksionimin psikologjik të paditësit, Të përcaktojë nëse paditësi duhet t'i nënshtrohet ndonjë trajtimi të shëndetit mendor në mënyrë që të rehabilitohet nga dëmi. *Duke qenë se shumë faktorë të tjerë mund të ndikojnë në funksionimin psikologjik të individit është e rëndësishme të theksohet se ekspertiza psikologjike përbën vetëm një element mbështetës në identifikimin e simptomave psikologjike të të dëmtuarit, por e ka të vështirë të përcaktojë ose faktojë binomin shkak (ngjarja dëmtuese) – pasojë (dëmi psikologjik).*

Çështje etike lidhur me psikologun

Kini parasysh që në punën e tij, psikologu udhëhiqet nga Kodi i Etikës dhe Deontologjisë së Psikologëve në Republikën e Shqipërisë.⁶¹ Në këtë kuptim, është me rëndësi t'i referohemi kapitujve që lidhen me parimet dhe kompetencat, dhe në rastet që lidhen specifikisht me funksionin e psikologut të trajtuar në këtë modul, Kreut 9: Vlerësimi, ku përcaktohen në detaje modalitetet e punës, të cilave psikologu i përmbahet në këto raste.

Gjithashtu, sipas këtij Kodi, në nenin 3.10, përkthehen rastet kur psikologu merr miratimin e informuar nga klienti për kryerjen e këtij vlerësimi. Por vini re se në shkronjën “c” të tij reflektohet specifika për rastet e vlerësimeve që janë në fokus të këtij moduli. Më konkretisht:

(c) Kur shërbimet psikologjike janë të urdhëruara nga gjykata ose janë të mandatuara nga organe të tjera ligjzbatuese, psikologu informon individin për natyrën e shërbimit të parashikuar dhe për çdo kufizim të konfidencialitetit, përpara se të procedohet.

B Diskutim në grup: Në fund të pjesës teorike, diskutimi në grup bëhet bazuar në informacionin e dhënë, eksperiencat e pjesëmarrësve në rastet e marrëdhënieve me psikologun apo punonjësin e mbrojtjes së fëmijëve që prej miratimit të KDPM. Sfidat dhe çështje që lidhen kryesisht me hartimin e vlerësimeve individuale të të miturve.

C Trajtim rasti:

Arbri është një djalë 16 vjeç, fëmijë i dy prindërve të divorcuar për shkak të dhunës në familje. Familja e tij ka edhe probleme ekonomike. Në moshën 12 vjeç, Arbri hyri për herë të parë në konflikt me ligjin, duke vjedhur një makinë së bashku me shokët e tij, më të rritur në moshë. Pak ditë pasi mbushi 16 vjeç, Arbri goditi me thikë një të njohur të tij në shkollë pas një konflikti të çastit. Një polic që ishte aty pranë e arrestoi menjëherë për plagosje të rëndë me dashje ndaj shokut të shkollës. Në përfundim të gjykimit, Arbri u dënua me 2 vite burg.

Pyetje:

- 1 Cilët aktorë u përfshinë në çdo fazë që prej hetimit e deri në zbatimin e vendimit?
- 2 Cili do të ishte bashkëpunimi dhe marrëdhënia që do të kishit me secilin nga këta aktorë?
- 3 Cili ishte roli i psikologut asistues dhe vlerësues gjatë këtij procesi?

Burime të tjera informacioni mund të gjeni në:

- Psikologu dhe punonjësi social në drejtësinë për të mitur, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, Klodian Gega dhe Naureda Hasani
- Udhëzues për avokatë mbi normat standarde të trajtimit të fëmijëve në sistemin e drejtësisë, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara përgatitur nga: Av. Rezarta Abdiu, LL.M. Psig. Klodian Gega, MSC
- Urbas, G 2000, 'The Age of Criminal Responsibility', Trends and Issues in Crime and Criminal Justice, no. 181, Australian Institute of Criminology, Canberra. Available at: http://www.aic.gov.au/media_library/publications/tandi_pdf/tandi181.pdf and Arthur, R 2012, 'Rethinking the Criminal Responsibility of Young People in England and Wales', European Journal of Crime, Criminal Law and Criminal Justice, Koninklijke Brill NV, Leiden, pp. 13-29
- Justice for Children Diversion and Alternative Measures Workshop Report January 2009, Prepared by Child Protection Section UNICEF Afghanistan
- Protecting children's rights in criminal justice systems -a training manual and reference point for professionals and policymakers, Penal Reform International.
- Restorative Justice: Psychological Needs of Offenders and Implications for Safety & Security, Festus C. Obi, Texas Southern University, Ifeoma E. Okoye, Virginia State University, Andrew I. E. Eöh, Texas Southern University, and Ihekwoaba Declan Onwudiwe, Texas Southern University.
- Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice, Council of Europe, October 2011.
- Comment- on the draft general comment no. 24 (201x), replacing general comment no. 10 (2007) on children's rights in juvenile justice of the committee on the rights of the child (crc/c/gc/24), European Forum for restorative Justice
- Confronting Developmental Barriers to the Empowerment of Child Clients, Emily Bus
- Balanced and Restorative Justice Project, august 1997.
- Guidelines for Child Protection Mediation, 2012 Association of Family and Conciliation Courts

- Guidelines on child-friendly legal aid UNICEF Ecaro, October 2018;
- Handbook on Restorative justice programmes, United Nations Office on Drugs and Crime, Vienna;
- Guidelines for child's lawyer practicing in the Yukon, Office of the Public Guardian and Trustee.
- Performance guidelines for juvenile offense representation, November 16, 2017, Washington State Bar association.
- Justice in Matters Involving Children in Conflict with the Law, United Nations Office on Drugs and Crime, Vienna, 2013
- The little book of restorative justice, Howard Zehr and Ali Gohar;
- Manual in handling cases of children at risk and children in conflict with the law, Women and Children Protection Centre Camp Crame, Quezon City, Philippines 2016
- You're My What? -The Problem of Children's Misperceptions of Their Lawyers' Roles, University of Chicago Law School Chicago Unbound;
- The role of the youth lawyer in the juvenile justice system in the Netherlands, National report, September 2016-February 2017, Defence for Children International The Netherlands
- The role of education in juvenile justice in Eastern Europe and the former Soviet Union, Barbara Henkes, 2000.
- The Child Interview. Practice Guidelines, Maria Keller-Hamela Nobody's Children Foundation,
- Trial Defence Guidelines: Representing a Child Client Facing a Possible Life Sentence, Issued by the Campaign for the Fair Sentencing of Youth March 2015, Heather Renwick Litigation Counsel Principal Author.
- Evaluation of Youth in the Juvenile Justice System Randy Borum University of South Florida, wborum@usf.edu Randy Otto University of South, 2004.
- Vanfraechem, I., Bolivar, D. & Aertsen, I., (eds.), Victims and Restorative Justice. London: Routledge, 2015

- Guidelines on children in contact with the justice system, Adopted by the Council of the IAYFJM London, October 21st, 2016
- Promoting restorative justice The Special Representative of the Secretary-General on Violence against Children for children, Publication produced by the Office of the SRSG on Violence against Children in 2013
- The Impact of National Standards on Juvenile Defence Practice, American bar association, June 2013.
- Establishing a Trauma-Informed Lawyer-Client Relationship (Part One) Talia Kraemer and Eliza Patten
- Evaluation of Youth in the Juvenile Justice System Randy Borum University of South Florida, rborum@usf.edu Randy Otto University of South Florida, otto@fmhi.usf.edu
- Practical guide for lawyers, Defence for children international (dci) – Belgium,2018
- Rights & Duties: An Overview of the Attorney Child Client Relationship Marvin R. Ventrell Attorney, Executive Director of the National Association of Counsel for Children
- Training Programme on the Treatment of Child Victims and Child Witnesses of Crime for Law Enforcement Officials, UNODC and UNICEF, 2015
- Handbook on RESTORATIVE JUSTICE PROGRAMMES SECOND EDITION, UNODC, 2020.
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, 2018.
- Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Psikologëve në Republikën e Shqipërisë, maj 2017. <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2019/10/Kodi-i-Eikes-dhe-Deontologjise-1-1.pdf>

